Rruga e Arbërit

www.rrugaearberit.com GAZETË E PAVARUR. NR. 5 (200) QERSHOR - GUSHT 2023. ÇMIMI: 50 LEKË. 0,5 €

BIG market
PESHKOPI MAQELLARË
Plot oferta dhe surpriza...

TURIZËM

10 rekomandime për të kaluar 10 ditë në Dibër të Madhe

Nga **FITIM DIKA** — Faqe 12

PROFIL

Ruzhdi Bulku, modeli i qytetarisë dibrane

Nga **OSMAN XHILI** — Faqe 5

VENDLINDJA

Koçaj - fshati i vendosur mbi një qytet misterioz

Nga **ADRIATIK BALLA** — Faqe 14

BOTIME

"Po Demokracisë, Jo Demokraturës", libri i ri publicistik

Nga **PROF. HAJRI SHEHU** — Faqe 17

Brandimi i bimëve mjekësorë të Dibrës, një mundësi e mirë për të rritur të ardhurat dhe për të siguruar vazhdimësi

Kultivuesit e bimëve mjekësore në Dibër ndeshen me vështirësi

— Faqe 6-7

REPORTAZH / NJË DITË ME NAZMI DRIZIN, KRYETARIN E SHOQATËS PËR MBROJTJEN E PELLGUT TË DRINIT TË ZI



"Është krim t'i lëmë tokat pa punuar"

"Nuk po shoh të rinjtë t'i kthehen tokës. Sikur kjo të ndodhte një ditë e më parë, nuk ka qeveri që ndërton Skavicën".

Nga **BUJAR KAROSHI** — Faqe 4-5



Liri Rasha, këngëtarja me zërin unik

— Faqe 18

ANALIZË



Qeveria shqiptare dështon të mbrojë qasjen e komuniteteve lokale ndaj tokës dhe natyrës

Rezervuari i madh do të ndikojë, sipas bashkisë, deri në 15,138 hektarë tokë, kryesisht tokë bujqësore dhe pyje, por edhe 41 fshatra. Me disa mijëra njerëz të zhvendosur, Skavica mund të ketë pasojat më të mëdha sociale nga çdo digë e ndërtuar në Evropë në shekullin e 21-të. — Faqe 8

KY ËSHTË NUMRI I 200-TË I GAZETËS. Muaj pas muaji kemi ardhur midis jush, duke u përpjekur të sjellim më të mirat nga Dibra: historinë, kulturën, artin dhe gjithçka që ka të bëjë me aktualitetin, problematikat e përditshme që ndeshemi.

Disa çështje jetike për komunitetin, jo vetëm në Dibër, por kudo ku ndodhen dibranët, jemi përpjekur t'i mbajmë të hapura dhe t'i pasurojmë vazhdimisht me lajme, analiza, opinione...

Ne jemi te numri i 200-të, pasi kemi pasur mbështetjen e lexuesve dhe bashkëpunëtorëve. Janë me qindra ata që kanë shkruar në gazetë, duke kontribuar me shkrime origjinale dhe serioze, që i kanë dhënë asaj një natyrë studimore, shkencore, ku botohen vlera.

Deri këtu kemi arritur edhe falë mbështetjes së financuesve të saj, sidomos z. Musa Riçku, të cilët, çdo muaj, kanë hequr nga buxhetet e tyre të biznesit apo të familjes për të mbështetur një media të lirë.

Gjatë punës sonë jemi përpjekur maksimalisht të respektojmë çdo kontribut, sado i vogël të jetë, duke respektuar të drejtën e autorit. Ne kemi ardhur në vatrat tuaja, duke e bërë gazetën muaj pas muaji, një mik të familjes suaj.

Të gjitha këto kanë ardhur deri këtu falë sakrificave të bashkëpunëtorëve dhe financuesve, të kontributorëve dhe lexuesve.

200

Gazeta ka shërbyer si lobim për ndërtimin e Rrugës së Arbrit - nga e cila mori edhe emrin, dhe ndërsa tani rruga është duke përfunduar, është detyra dhe përgjegjësia jonë, e komunitetit dibran, që kjo gazetë të bëhet më e mirë, më përfaqësuese, të bëhet një gazetë e të gjithë dibranëve, pa ngjyra politike. Ndaj është detyra e të gjithëve që ta mbështesim, ta ndihmojmë me shkrime, me kontribute autoriale dhe financiare, për ta bërë një zë serioz të komunitetit dibran nga Dibra në Tiranë e kudo që janë në botë.

Të gjithë ata që na ndjekin çdo muaj, që kanë paguar për të pasur gazetën, i kemi konsideruar dhe do të vazhdojmë t'i konsiderojmë kontribuues të përpjekjes sonë për vazhdimësinë e botimit të gazetës "Rruga e Arbrit", duke marrë përsipër gjithashtu që të përcjellim më së shumti shqetësimet e tyre.

Ne mbetemi të përkushtuar për të sjellë gjithmonë të renë te lexuesi, për të sjellë shkrime ekskluzive, serioze, trajtime të çështjeve në mënyrë të pavarur dhe të saktë, rubrika nga personalitete dhe studiues të letërsisë e kulturës, që do ta bëjnë gazetën më të mirë, numër pas numri.

"Rruga e Arbërit" është një gazetë e lirë! Dhe liria e saj vjen vetëm nga mbështetja juaj! ***- Faleminderit!***

Gazeta “Rruga e Arbërit” është një media e lirë dhe e hapur.
Çdo kontribut me shkrime, abonime ose donacione është i mirëpritur!
Bëj pajtimin tënd me **PayPal** përmes emailit <rrugaearberit@gmail.com>
Një pajtim vjetor kushton: Në Shqipëri: 600 lekë. Në Europë: 10 Euro.
Në SHBA dhe vende të tjera: 15 USD.
Pajtimi në Europë dhe SHBA është vetëm në versionin PDF.

Posta e Rruga e Arbërit

Gazetë e pavarur. Nr. 5 (200).
Qershor - Gusht 2023
Gazeta doli nga shtypi, 24 gusht 2023.
Gjendet në treg deri në fund muajit shtator 2023.

Redaksia e gazetës falënderon lexuesit dhe bashkëpunëtoret e saj për mesazhet dhe shkrimet e sjella për botim.

Kujtojmë bashkëpunëtorët, të cilët duan që shkrimet e tyre të botohen patjetër në numrin e radhës, të konfirmojnë më parë sjelljen e materialit në numrat e telefonit të redaksisë ose emailin e gazetës.

Shkrimet refuzohen për botim vetëm në rast se merrni përgjigje me email. Për çdo rast tjetër shkrimet priten për botim në numrat e radhës.

Shkrimet në redaksi për numrin e radhës priten deri më **datë 20** të muajit, përveç rasteve të bashkëpunëtorëve të rregullt.

Gjithashtu, ju **kujtojmë bashkëpunëtorëve se shkrimet deri në dy faqe daktilografike kanë përparësi botimi.**

GJITHASHTU, KUJTOJMË SE ÇDO SHKRIM I BOTUAR NË NJË MEDIA TJETËR APO RRJETE SOCIALE NUK KA PËRPARËSI BOTIMI.

JU LUTEMI, SHKRIMET QË VIJNË PËRMES EMAIL-it, TË KENË PATJETËR ZANOREN “ë”.

Ju falënderojmë që jeni pjesë e gazetës!

BOTUES:
Musa Riçku
Bujar Karoshi
Shaqir Skarra

Editor i faqes online: Agim Deva

Kontribuan për këtë numër:
Xhafer MARTINI
Osman XHILI
Adriatik BALLA
Hajri SHEHU
Bajram XHAFA
Urim BAJRAMI
Gazmend AGAJ
Mevlud BUCI
Fitim DIKA
Dritan KURTI
Demir OSMANI
Zabit LLESHI

KËRKOHEN KORRESPONDENTË NË PESHKOPI DHE DIBËR TË MADHE

Të interesuarit për korrespondentë/menaxherë duhet të kenë pasion gazetarinë. Përbën avantazh përvoja në shtypin e shkruar ose në qoftë se kanë mbaruar studimet për gazetari dhe letërsi / marketing. Të jenë të angazhuar për punën në grup dhe të jenë të pavarur politikisht gjatë kohës që bashkëpunojnë me gazetën.
Të interesuarit të shkruajnë email
në adresën <rrugaearberit@gmail.com>
ose të telefonojnë në numrin 069 20 68 603.

Arkivi i gazetës është PA pagesë në faqen e internetit **www.rrugaearberit.com.**
Falënderojmë z. **AGIM DEVA** për kontributin e vazhdueshëm për mirëmbajtjen e faqes së gazetës në internet dhe arkivin online.
Pajtimet në gazetë mund t’i bëni në çdo kohë duke komunikuar në adresat e redaksisë.
Bëj pajtimin tënd me **PayPal** përmes emailit
<rrugaearberit@gmail.com>
Një pajtim vjetor kushton: Në Shqipëri: 600 lekë. Në Europë: 10 Euro. Në SHBA dhe vende të tjera: 15 USD.
Pajtimi në Europë dhe SHBA është vetëm në versionin PDF.
Për kontribute për gazetën mund të kontaktoni redaksinë ose mund t’i bëni ato përmes numrit të llogarisë më poshtë:
Raiffeisen Bank
Rruga e Arberit / NIPT: K82019002S
Nr. llog. në lekë: 0010036640
IBAN: AL44 2021 1219 0000 0000 1003 6640

Adresa e gazetës:
Rr. “Zenel Baboçi”,
Pall. “Ferar”, Tiranë
Tel. +355 4 22 33 283
+355 69 20 68 603
E-mail: rrugaearberit@gmail.com

Opinionet dhe komentet e botuara nuk shprehin domosdoshmërisht qëndrimin e redaksisë
Çdo shkrim apo foto e botuar i nënshtrohet ligjit për respektimin e të drejtave të autorit. Ndalohet riprodhimi, fotokopjimi, shpërndarja apo ribotimi pa lejen e autorit të shkrimit apo redaksisë.

SHKURT



Përkujtohet Ploja e Madhe

Çidhën, 20 gusht 2023 - Më 20 gusht 2023, në Çidhën u përkujtua masakra e madhe e vitit 1466. Sulltan Mehmeti i dytë, pas humbi betejën për marrjen e Krujës, u ndërmorri një ekspeditë ndëshkimore ndaj popullsise së pafajshme, duke vrarë mbi tetë mijë banorë të pafajshëm.

Në veprimtarinë e zhvilluar në Çidhën morën pjesë përfaqësues të Prefekturës së Dibrës, Bashkisë së Dibrës, si dhe nga shoqatat e krahinës dhe banorë të zonës.

Gjatë fjalës së rastit, Ali Hoxha, - historian, tha se “studiues të besueshëm tregojnë se Çidhna ka qenë dikur një qytet i zhvilluar, me shumë banore dhe ka pasë zejtarë e tregtarë të shumtë’.

Mustafa Tola, kryetar i shoqatës “ Çidhna dhe Kastriotet”, tha në fjalën e tij se “vlerat dhe kontributet e kësaj treve janë të mëdha. Këtu kanë qënë disa prej sheshbetejave të Skënderbeut. Këtu zë fill kryengritja e madha kundër turqve e më vonë ndaj sebve. Jo rastesisht, këtu pranë u mbajt Kuvendi i Arasit me 1920 dhe me 1921 u bë në krahun tjeter beteja e Lan Lurës”.

Në këtë veprimtari përshëndeti edhe deputeti i Dibrës, Lavdrim Krashi, kryetari i “Aleancës për Mbrojtjen e Dibrës”, Zenel Hoxha, nënkryetar i bashkisë Sajmiri Kojnozi dhe përfaqësuesja e Prefekturës, Donika Hyseni.



Maqellara feston “Ditën e Diasporës”

Maqellarë, 17 gusht 2023 - Maqellara festoi me 17 gusht 2023 “Ditën e Diasporës” në mjediset e një restoranti në brigjet e Drinit. Kjo veprimtari është organizuar për herë të tretë këtë vit, dhe një rol në organizimin e saj mori shoqata Lidhja e Intelektualëve Dibranë dhe dega e saj e Maqellarës.

Në këtë veprimtari kishte të ftuar nga të gjitha trevat shqiptare. Kënga, vallja, prezantimet e të rinjve shoqëruan festën gjatë gjithë kohës.

Në këtë veprimtari, të moderuar nga Defrim Methasani, përshëndetën kryetari i LID, Shpëtim Cami, deputeti Lavderim Krashi dhe mjaft personalitete të zonës.

Grupi i valleve të djemve e vajzave ardhur enkas nga Peshkopia, me veshje të bukura popullore u derdhen rrugëve e shesheve duke ekzekutuar vallet gjithe finesë e hijeshi. Një program i bukur artistik do të mbërthente gjatë të pranishmit.

Kjo veprimtari u mbështet nga z. Musa Riçku nga Big Market, Ibrahim Kolari i ardhur nga Amerika dhe Genti Kromilla nga Instituti i Mbrojtjes se Natyrës.

LID, krijohet dega e Peshkopisë

Peshkopi, 5 korrik 2023 - Në Pallatin e Kulturës “Haki Stërmilli” në Peshkopi, nën drejtimin e z. Faris Cibaku dhe nën kujdesin e Kryesisë së Lidhjes së Intelektualëve Dibranë, u themelua dega e shoqatës për qytetin e Peshkopisë. Në takim morën pjesë intelektualë dibranë të të gjitha fushave dhe konfirmuan për t’ju bashkuar kësaj shoqate rreth 38 intelektualë. Takimin e hapi z. Faris Cibaku i cili prezantoi panelin dhe të pranishmit në sallë si dhe objektin e këtij takimi. Pjesëmarrësit u pajisën me statutin e LID dhe plotësuan formularin e anëtarësimit.

Mbi veprimtarinë 17 vjeçare të shoqatës informoi kryetari i LID, z.Shpëtim Cami, i cili ju dha përgjigje edhe disa pyetjeve dhe kërkesave të pjesëmarrësve mbi statutin dhe veprimtarinë e shoqatës. Në takim morën pjesë edhe anëtari i kryesisë, z. Shaqir Skarra si dhe kryetari i Degës së Intelektualëve Maqellarë, z. Osman Xhili. Në përfundim të takimit u zhvilluan zgjedhjet për drejtimin e degës, ku me votim të hapur dhe me konsensus u zgjodh kryetar z. Faris Cibaku, dy nënkryetarët Ylber Daci dhe Dali Horeshka si dhe sekretar Ilir Elezi.



“Dibër ishe, Dibër mbete”

Dibër e Madhe, 18 gusht 2023 - Një maratonë muzikore me pjesmarrje të artistëve dibranë u zhvillua në Dibër të Madhe më 18 gusht 2023. Veprimtaria ishte organizuar nga Shoqërisë Kulturore Artistike e Dibrës së Madhe, nën drejtimin e z. Miçe Duka.

Në këtë veprimtari përshëndetën kryetari i Komunës së Dibrës, Hekuran Duka, deputeti i Dibrës në Parlamentin shqiptar, Lavdrim Krashi, Presidenti i Unionit Artistik të kombit Shqiptar Azgan Haklaj,kryetari I shoqatës “Bashkësia Dibrane”, Bujar Kapexhiu, si dhe morën pjesë edhe përfaqësues të pushtetit vendor, miq dhe të ftuar.

Shoqëria Kulturore Artistike e Dibrës së Madhe ka fituar gjatë këtij viti 18 çmime e trofe në veprimtari të ndryshme artistike dhe këtë sukses e reflektoi edhe në manifestimin e madh kulturor të 18 gushit 2023, në sheshin para Pallatit të Kulturës në Dibër të Madhe, me një repertor të larmishëm, me këngë valle e humor, që mbushi krenari zemrat e mijëra artdashësve.

Një maratonë muzikore që zgjati katër orë me pjesëmarrje të artistëve të spikatur dibranë si: Haxhi Maqellara, Liri Rasha, Vera Laçi, Ingrit Jushi,Behar Mera, Genc Lleshi, Agim Skarra, Qanije Skënderi Muça, Klea Çutra, Evzi Kaja (Xiu) e shumë të tjerë që performuan dhe interpretuan mjeshtërisht këngën, vallen e humorin dibran.

Me nivel të lartë artistik performuan edhe përfaqësuesit e Ansamblit Artistik “Perparim Tomçini”. Vetë emri i kompozitorit të paharruar që mban ky ansambël, vepra madhore që na la Ai si trashëgimi kulturore-artistike që e veshi atë me pavdekësi, i motivoi këta artistë të ishin në nivelin më të lartë. Pjesëmarrësit më këtë spektaklël madhëshor shijuan gjithashtu humorin e aktorëve më në zë, Behar Mera e Genci Lleshi si të ftuar special.

Koncerti i titulluar “Dibër ishe, Dibër mbete” u mbyll nga grupi i valltarave të Ansamblit Artistik “Hazis Ndreu” – “Nderi i Kombit, i njohur për dhjetra trofe e çmime mbarëkombëtare e ndërkombëtare.

Moderator i këtij koncerti ishte Defrim Methasani ndërsa regjisor Llesh Nikolla.

Bashkia Dibër nderon akademikët Sinani dhe Bunguri

Peshkopi, 23 korrik 2023 - Një ceremoni madhështore, festive dhe një bashkëpunim i shkëlqyer midis Bashkisë Dibër dhe Lidhjes së Intelektualëve Dibranë për dhënien e titujve “Qytetar Nderi” katër personaliteteve dibrane, akademikëve Shaban Sinani dhe Adem Bunguri, artistes së mirënjohur Liri Rasha dhe intelektualit Hasan Leka (pas vdekjes).

Një ceremoni e posaçme u mbaj me këtë rast në mjediset e Pallatit të Kulturës, ku ceremonia e vlerësimeve ishte e ndërthur me një koncert artistik nga ansambli “Përparim Tomçini”.


Hapet muzeu i traditës në shkollën e Ploshtanit

Kala e Dodes, 18 gusht 2023 - Në mjediset e shkollë së Ploshtanit në Kala të Dodës u përurua muzeu “Histori, Traditë, Kulturë”, një nismë z. Gani Gjorllaku, në bashkëpunim me Bashkinë e Dibrës. Në mjesidet e shkollës janë vendosur disa stenda që nxjerrin në pah historinë dhe traditën e zonës si dhe është pajisur me objekte të vjetra që tregojnë jetën, veshjet tradicionale dhe kulturëne zonës. Shkolla “Ramadan Gjorllaku” festoi këtë vit 101 vjetorin e saj dhe është hapur nga atdhetari dhe deputeti i Dibrës, Hasan Prishtina.

veprimtari

Ide për biznesin – qeveria britanike mbështet të rinjtë e Dibrës

Po kërkohen partnerë nga institucionet publike dhe private që ofrojnë mbështetje profesionale në fushën e turizmit, agroturizmit, agripërpunimit, ndërtimit dhe teknologjisë së informacionit



A jeni një djalë apo vajze në moshën 17-22 vjeç? Keni ndonjë të njohur në këtë moshë? Keni pasion apo një ide biznesi? Jetoni në territorin e bashkisë Dibër? Atëherë keni një mundësi që dikush t'ju ndihmojë në ëndrrën tuaj.

Projekti "Perspektiva të Reja", i cili zbatohet nga Sëisscontact në bashkëpunim me TAG International dhe që financohet nga Qeveria Britanike nëpërmjet Ambasadës Britanike në Shqipëri, ju fton të bëheni pjesë e një kampi tre-ditor.

"BOOTCAMP PËR IDE BIZNESI" do të zgjasë tre ditë dhe grupi i trajnimit do të përfshijë një numër maksimal prej 25 persona, të rinj që pëlqejnë sipërmarrjen dhe e shohin veten me një të ardhme si sipërmarrës.

Në përfundim të kampit, dy pjesëmarrësit me idetë më të mira do të mbështeten financiarisht nga projekti për realizimin e idesë së tyre të biznesit.

Projekti do të jetë i hapur për adresimin dhe përgjigje ndaj pyetjeve tuaja (ekskluzivisht me email) deri në datë 23 gusht 2023. Aplikantët e interesuar duhet të aplikojnë përpara datës 27 gusht 2023.

Gjithashtu, projekti "Perspektiva të Reja" po kërkon partnerë nga institucione publike apo private si qendra të formimit profesional, kompani private apo universitete, me përvojë në ofrimin e kurseve profesionale në sektorët e mëposhtëm: Turizëm, Agroturizëm, Përpunim agro-ushqimor, Ndërtim dhe TIK.

Nëpërmjet dhënies së bursave të studimit për të rinjtë, projekti dëshiron të zgjerojë mundësitë në profesione në lidhje me sektorët me potencial të lartë zhvillimi në Qarkun e Kukësit dhe Bashkinë Dibër.

Nëpërmjet bashkëpunimit më këto institucione partnere, projekti synon të rrisë numrin e të rinjve që dëshirojnë të hapin mikro-biznesin e tyre, si rezultat i zhvillimit të tyre profesional nga ndjekja e një kursi trajnimi profesional në sektorët e përmendur më sipër.

Për nënshkrimin e bashkëpunimit mes organizatës Perspektiva të Reja dhe Bashkisë së Dibër, ishte në fillim të korrikut në Peshkopi ambasadori Britanik në Shqipëri Alastair King-Smith, i cili mori pjesë në nënshkrimin e marrëveshjes.

"Takimi shënoi shtrirjen e projektit "Perspektiva të Reja" në rajonin e Dibrës, duke vazhduar bashkëpunimin me qytetarët, si pjesë e angazhimit dhe mbështetjes më të gjerë të Mbretërisë së Bashkuar për veriun e Shqipërisë", thuhej në njoftim për shtyp të organizatës.

Takimi konsultues bëri bashkë të gjithë aktorët kryesorë vendas si bizneset, institucionet publike, organizatat dhe rininë, në një diskutim të hapur mbi nevojat prioritare të qytetarëve, ideve të reja dhe mënyrat e bashkëpunimit.

Për më shumë informacion mbi veprimtarinë e projektit Perspektiva të Reja ndiq faqen në Facebook **PerspektivateReja** ose në instagram **perspektiva_te_reja.**

SHKURT

Shpërthim në minierën e Bulqizës, tre minatorë të plagosur

Bulqize, 14 gusht 2023 - Tre minatorë u plagosën në mesditën e datës 14 gusht 2023, pas një shpërthimi gazi në pusin 17 të minierës së Bulqizës. Shpërthimi i gazit ndodhi ndërsa minatorët po punonin në pusin që zotërohet nga Albchrome. Policia bëri me dije se minatorët kanë pësuar djegie trupore. Nëpërmjet një postimi në rrjetin social Facebook, Sindikata e Minatorëve të Bashkuar të Bulqizës, deklaroi se nivelet e thella të Minierës së Bulqizës, janë një "bombë me sahat", duke identifikuar minatorët e plagosur si Rrahim Karaj, Asllan Çakalli dhe Trifon Snalla. "Kjo minierë, në të cilën janë zbuluar rezerva të mëdha të gazit metan, rrezikon çdo moment jetën e qindra minatorëve, ndaj duhet të merren masa urgjente që raste të tilla – që mund të rezultojnë shumë më fatale – të mos përsëriten më." thuhet në deklaratën e SMBB-së. Minatorët e aksidentuar në punë janë transportuar për mjekim të specializuar në Spitalin e Traumës në Tiranës.

Aplikohet për parkun e parë fotovoltaik në Bulqizë

Bulqize, 14 korrik 2023 - Për herë të parë në zonën e Bulqizës është aplikuar pranë Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë për ndërtimin e një impianti fotovoltaik. Bëhet fjalë për një impiant me kapacitet të instaluar 10 MË për t'u zbatuar në zonën e Shupenzës. Referuar të dhënave zyrtare, aplikimi është kryer nga shoqëria "GERTI" SH.P.K zotëruar nga Jeton Dani. "Shoqëria "GERTI" SH.P.K. ka shprehur interesin dhe ka paraqitur pranë Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, aplikimin për ndërtimin e një impianti fotovoltaik me kapacitet të instaluar 10 MË, për prodhimin e energjisë elektrike nga burime të rinovueshme, i cili nuk është objekt koncesioni dhe nuk përfiton nga masat mbështetëse, me vendndodhje në Vlashaj, Njësia Administrative Shupenzë, Bashkia Bulqizë" thuhet në aplikimin e bërë publik nga MIE.

Kërçisht, banorët kundërshtojnë ndërtimin e ujësjellësit

Maqellarë, 14 gusht 2023- Banorët e fshatit Kërçisht i Epërm në Maqellarë I kanë vazhduar protestë, duke bllokuar mjetet e punës së kompanisë që ka fituar tenderin për ndërtimin e një rrjeti ujësjellësi, që shfrytëzon burimet ujore të këtij fshati. Pas disa orë qëndrimi në rrugë, forca të shumta policie, shoqëruan disa prej banorëve, ndërsa forcërisht larguan të tjerët. Disa ditë më parë, Policia dërgoi në Prokurori, thuajse të gjithë kryefamiljarët e fshatit Kërçisht i Epërm, nën akuzën për kundërshtimin e shërbimeve të Policisë Bashkiake dhe punonjësit e ujësjellësit të Dibrës. Banorët prej muajsh protestojnë, duke pretenduar se burimet ujore nuk plotësojnë nevojat e tyre dhe nuk mund të përdoren për ujësjellësin e Maqellarës. Pak javë para zgjedhjeve vendore, punimet ishin ndërprerë; prej ditësh, sipas banorëve, projekti po avancon me justifikimin se po rehabilitohet rruga. Referuar të dhënave në Agjencinë e Prokurimit Publik, tenderi për ndërtimin e rrjetit kryesor të ujësjellësit në Maqellarë do kushtojë 97,834,497 fituar nga kompania "Selami". Autoriteti kontraktues është Agjencia Kombëtare e Ujësjellës Kanalizimeve dhe Infrastrukturës së Mbetjeve./*Bulqizaime.com*

Makineritë e rënda dëmtojnë asfaltin, protestojnë banorët

Bllacë, 24 korrik 2023 - Bllaca është ndër fshatrat më të largët të Bulqizës, ku jetojnë afro 40 familje. Ndër arsyet kryesore për shpopullimin e zonës ishte mungesa e rrugës dhe problemet ekonomike. Pak javë më parë u asfaltua një pjesë e rrugës nga bashkia Bulqizë, me një vlerë prej afro 290 mijë euro. Loti i parë i asfaltimit të rrugës, mbeti afro 1 km larg fshatit. Por pa kaluar pak ditë nga asfaltimi, banorët pretendojnë se rruga po shkatërrohet nga mjetet e tonazhit të rëndë të gurores që ndodhet në këtë zonë. Mermeri i kuq në zonën e Bllacës është e njohur në të gjithë Europën për shkak të cilësisë së lartë. Por gurorja nuk solli asnjë përfitim për banorët, si për punësim por edhe për mirëmbajtjen e rrugës. Kompania që ka në shfrytëzim guroren "PI.OR. QUARRIES" nuk ju përgjigj një kërkese për koment, lidhur me shqetësimin e banorëve. Gjithashtu as institucionet shtetërore nuk kanë bërë asnjë reagim publik për shqetësimin e banorëve të Bllacës. /*Bulqizaime.com*


LIBRI I RI PËR NËNË TEREZËN I AKADEMIKUT TË UNIVERSITETIT TË BIRMINGHAMIT VLERËSOHET ME ÇMIM NDËRKOMBËTAR

Libri i Dr. Gëzim Alpion në gjuhën angleze 'Nënë Tereza: Shenjtorja dhe Kombi i Saj' fiton 'Çmimin e Ekselencës në Botime' për vitin 2023 në SHBA

***

Libri i ri i një eksperti të Universitetit të Birminghamit për Nënë Terezën është vlërsuar në Amerikë me 'Çmimin e Ekselencës në Botime' për vitin 2023 në kategorinë e 'biografisë' nga Shoqata e Botuesve Katolikë, Association of Catholic Publishers (ACP), njofton zyra e shtypit e Universitetit të Birmingamit në Mbretërinë e Bashkuar.

Monografia Mother Teresa: The Saint and Her Nation ('Nënë Tereza: Shenjtorja dhe Kombi i Saj') i Dr Gëzim Alpion, Profesor i Asociuar i Sociologjisë në Universitetin e Birminghamit, ofron një portret të detajuar të misionares shqiptare.



Libri përqëndrohet në rrethanat familjare të Nënë Terezës, kontekstin e saj etnik, kulturor dhe shpirtëror, traumat, sprovat dhe arritjet e saj si individ dhe misionare publike, si dhe besimin e saj të ndërlikuar.

Botuar nga Bloomsbury Academic, libri është vlerësuar gjerësisht nga ekspertë të fushave të ndryshme. Menjehere pas botimit, revista ndërkombëtare katolike The Tablet në Londër i dedikoi librit kopertinën e numrit te gushtit 2020. Ndersa në 2022, revista LIFE në Nju Jork botoi një shkrim të posaçëm për këtë vepër dhe studimet e tjera të Alpion për Nënë Terezën.

Pas botimit të librit, Dr Alpion u ftua të flas për librin në disa vende, ndërsa në SHBA ai zhvilloi ligjerata vitin që kaloi në Universitetet e Harvardit dhe Georgetown.

I specializuar në disa aspekte të sociologjisë si feja, nacionalizmi, fama, mediat dhe autorësia, Alpion është përqëndruar në figurën e Nënë Terezës për më shumë se 20 vjet. Ai konsiderohet si "autori më autoritar në gjuhën angleze" për Shën Terezën e Kalkutës dhe "themeluesi i Studimeve për Nënë Terezën".

Në vitin 2021, Dr Alpion u nderua nga Presidenti i Shqipërisë me 'Medaljen Nënë Tereza' në shenjë mirënjohje për "kontributin e tij të çmuar akademik në studimin e plotë të jetës dhe veprës së Shën Nënë Terezës, si dhe promovimin e saj si përfaqësuese e vlerave të kombit shqiptar".

Në lidhje me vlerësimin e ri dhe jehonën e librit, Dr Alpion tha: "Jam i kënaqur që studimi është pritur kaq mirë. Felenderoj ACP-në për çmimin dhe përgëzoj autorët e tjerë që u vlerësuan."

"Studimi i figurës së Nënë Terezës është një nga pasionet e mija prej dy dekadash. Është mahnitëse që edhe tani kur është shkruar kaq shumë për të, po zbulohen të dhëna të reja, dhe njerëzit vazhdojnë të jenë të lidhur thellë me të si individ dhe me historinë dhe punën e saj."

Në emër të Bloomsbsury Academic në New Delhi, botuesi Chandra Sekhar, u shpreh: "Ne jemi të lumtur për Profesor Gëzim Alpion që u vleresua me çmimin e fundit për librin e tij të rëndësishëm Nënë Tereza: Shenjtorja dhe Kombi i Saj. Jemi vërtet të gëzuar që ai na zgjodhi ne për ta botuar këtë vepër. Ne falenderojmë ACP-në që vleresoi librin dhe nivelin shkencor te Profesor Alpion".

Nënë Tereza: Shenjtorja dhe Kombi i Saj është botuar në gjuhën angleze me kopertinë standarde, speciale dhe si eBook.

Për njoftimin zyrtar shih këtu: https://www.birmingham.ac.uk/.../new-book-on-mother...

Rruga e Arbërit nr. 200

reportazh

Në tokat e **Nazmi Drizit**, kryetarit të Shoqatës për Mbrojtjen e Pellgut të Drinit të Zi



Në foto: Nazmi Drizi duke treguar fushat djerrë. "Nga ish-qendra e fermës deri në Drin të Zi, gjithçka që të zë syri është pothuajse bosh. Tokë e papunuar. Tek-tuk duket ndonjë dorë njeriu që ka rindërtuar diçka, por pamja, që i ngjan djerrinës, është e dhimbshme. Kjo edhe për Nazmiun"

Nazmi Drizi: **Është krim t'i lëmë tokat pa punuar**

Nga **BUJAR KAROSHI**

"Jam 75 vjeç, por punoj sikur jam 20 dhe nuk do të vdes kurrë". Kështu më tha Nazmi Drizi, ndërsa qëndronte në mes të tokës së tij në Zbinec, një tokë rreth Drinit të Zi, në fshatin Kishavec të Dibrës. Nga toka e Nazmiut duket Muhurri, Sina, Arrasi, Laçes, Fushë-Alia, Kuke, Bresti dhe shumë fshatra të tjerë të Dibrës që shtrihen drejt Korabit e Gramës, një pjesë e të cilave qeveria shqiptare ka në plan t'i mbulojë me ujërat e HEC të Skavicës.

Nazmi Drizi është kundër. Ai drejton Shoqatën për Mbrojtjen e Pellgut të Drinit të Zi, themeluar në nëntor 2002, shoqata më e vjetër e ngritur për të mbrojtur hambarin e Dibrës.

"Nuk jam kryetar për të mbrojtur interesat e mia, jam për të mbrojtur interesat e Dibrës. Nëse qeveria do ta mbysë këtë luginë, ky ka për të qenë një gjenocid ndaj tokës, ndaj natyrës, ndaj njeriut", thotë Drizi.

Shoqata për Mbrojtjen e Drinit të Zi ka udhëhequr vazhdimisht protestat kundër Skavicës. Ajo ka organizuar protesta që nga Reçi deri në Gjoricë, por deri më tani duket se protestat kanë rënë në vesh të shurdhët.

"Kjo qeveri nuk dëgjon, sepse kjo qeveri nuk është e popullit. Një qeveri e popullit vjen këtu, ulet rrafsh me popullin dhe shikon me sy çfarë humbet. Kjo fushë që të kap syri, deri në mes të maleve – dhe bën me dorë nga Kastrioti në Sinë, - do të mbulohet. Ky është krim".

Ndërsa në Shqipëri ishte shpallur gjendja e jashtëzakonshme për pandeminë Covid 19, qeveria shqiptare shpalli projektet për ndërtimin e Skavicës përmes kompanisë Bechtel. Nazmiu organizoi një protestë në kodrat e Salbatre në fshatin Laçes, pranë Drinit, për organizimin e së cilës ai mban mbi shpinë një gjobë prej 5 milionë lekësh.

"Ata (qeveria) na thonë se kemi shkelur rregullat e pandemisë. Por për shkeljen e rregullave kam marrë një gjobë, por për shkeljen e të drejtave të njeriut, për krimin mjedisor e social, për zhdukjen e më shumë se 33 fshatrave të Dibrës, për ndarjen e saj në dysh - më keq se në vitin 1912, për gjenocidin që planifikohet të bëhet me popullin e Dibrës kush gjobitet? Kush do të mbajë përgjegjësi?" - pyet Nazmiu.

Në Zbinec, në tokat që dikur hidhnin shtat plepat e gjatë dhe më vonë edhe tokat e reja të bukës, tani po mbulohet nga shelgjet. Thuprat e shelgjeve dikur ishin një burim me lëndë të parë për ndërmarrjen artistike Migjeni në Tiranë. Me thuprat e holla e të bardha dikur furnizohej Europa me mobilje e shporta dekorative dhe materiale të tjera artistike.

"Diku aty, pranë tokës që kam unë, dikur ka qenë një banesë e vogël. Vinin nga udhëheqja për të gjuajtur këtu. Kishte lloj–lloj kafshësh të egra, përfshirë edhe derra, thëllëza e pulëbardha. Tani nuk ka më. Ka filluar vitet e fundit të ketë kafshë të egra, por mungesa e pyjeve nuk i favorizon për të ngritur strofkat e tyre.

Vetëm një masiv plepash duket pak më larg, të cilën edhe atë e ka ruajtur Nazmiu.

"I ka mbjellë babai im ato. I kam amanet për t'i ruajtur, ashtu siç kam amanet për të ruajtur tokën e trashëguar nga të parët"

"Kam 48 dynymë tokë babe, por nuk kam asnjë dokument për to. Nuk i jep qeveria. Nuk kam as unë dhe askush në luginën e Drinit të Zi tapi për tokën e trashëguar nga të parët", tregon Drizi.

Ai ka bindjen se ëndrra për të ndërtuar HEC e Skavicës është ëndërr e çdo qeverie, djathtas e majtas, ndryshe nuk ka si shpjegohet që 30 vite pas rënies së komunizmit, qeveria nuk i pajis banorët me tapitë e tokës.

Ndryshimi i qeverisjes në vitet '90 e ka gjetur Nazmiun si banor të qendrës së Kastriotit, aty ku në atë kohë kishte më shumë se 165 familje. Në atë kohë, në këtë qendër, përveç shtëpive private, qeveria e kohës kishte ndërtuar edhe 7-8 pallate për familjet e punëtorëve të fermës.



Diku mes fushës janë mollët e vjetra të ish-fermës, të cilat Nazmiu i ka ruajtur. Janë ca mollë rranetë, me pak kokrra nëpër të, mbuluar nga myshqet. Mollët duken si të egra. Mes mollëve Nazmiu ka mbjellë grurë.

"Kjo qeveri nuk dëgjon, sepse kjo qeveri nuk është e popullit. Një qeveri e popullit vjen këtu, ulet rrafsh me popullin dhe shikon me sy çfarë humbet. Kjo fushë që të kap syri, deri në mes të maleve – dhe bën me dorë nga Kastrioti në Sinë, - do të mbulohet. Ky është krim".

Nazmiu që nga viti 1978 ka banuar në fermën e Kastriotit. Kjo fermë, me mbi 480 hektarë tokë, ka qenë e njohur për prodhimin e mollëve dhe qershive, një pjesë e së cilës ishte e destinuar për Bllokun e Udhëheqjes dhe për eksport.

Ndërsa na udhëheq në mes shtëpive gjysmë të prishura të ish-fermës, Nazmiu tregon se ka këtu 5 apartamente, të gjitha të braktisura. Bosh. Ai ka në plan që t'i rregullojë dhe t'i përgatisë për të pritur turistët, madje, po mori leje, ta shtojë edhe një kat, por kjo duket më shumë si një dëshirë sesa një realitet.'

Nga ish-qendra e fermës deri në Drin të Zi, gjithçka që të zë syri është pothuajse bosh. Tokë e papunuar. Tek-tuk duket ndonjë dorë njeriu që ka rindërtuar diçka, por pamja, që i ngjan djerrinës, është e dhimbshme. Kjo edhe për Nazmiun.

"Është gjynah, - thotë ai. - Të kesh gjithë këtë tokë nën ujë, që dikur njihej në Europë dhe sot ta degdisësh në këtë farë feje; ndërsa fëmijët tanë punojnë tokat e botës...".

E ndjen pezmin, merakun.

Diku mes fushës janë mollët e vjetra të ish-fermës, të cilat Nazmiu i ka ruajtur. Janë ca mollë rranetë, me pak kokrra nëpër të, mbuluar nga myshqet. Mollët duken si të egra. Mes mollëve Nazmiu ka mbjellë grurë. Një ditë më parë kishte futur autokombajnën ta korrë, por e kishte ndaluar.

"Do edhe pak ditë – thotë Nazmiu, ndërsa na tregon grurin e korrur anës rrugës.

Parcelat e grurit herë-herë duken si fusha të mbjellë me ferra. Shirat e këtij viti kanë favorizuar bimët e egra mes fushës, por duket edhe dora e punës së bujkut. Ka pasur nevojë për plehërim e pastrim nga barërat e këqija, por kush do ta bëjë?

"Kanë ikur fëmijët, - thotë Nazmiu. Kanë ikur dhe na kanë lënë vetëm".

Pas viteve '90 Nazmiu ka drejtuar komisionin e ndarjes së tokave të ish-fermës, prej së cilës ka marrë 22 hektarë tokë. "Vetëm këtë tokë kam me letra, asnjë metër të tokës së babait tim nuk kam asnjë letër nga shteti që të më njohë pronësinë".

Ai tregon se në Fushën e Kastriotit dikur



Pamje nga ish-ferma e Kastriotit. Godina në sfond është pronë e Nazmi Drizit, me perspektivë për ndërtimin e një bujtine



Gruri i korrur në mes të fushës.Barërat e egra kanë bërë që këtë vit prodhimi i grurit të jetë shumë më pak se pritshmëritë.



Nazmi Drizi ka mbjellë 3.5 hektarë misër të bardhë, e gjitha në Kishaves, në një tokë nën ujë.



Një foto pranë rrjedhës së lumit në Topojan, pas një veprimtarie me të rinj, ku u foli atyre për mundësitë që ofron Drini i Zi për sportet ujore dhe rëndësinë e ruajtjes së natyrës përgjatë luginës së Drinit të Zi që kalon mespërmes Dibrës.

Shoqata e tij është në krye të disa organizatave mjedisore që e ka çuar çështjen e Skavicës në Gjykatën Kushtetuese. Gjykata nuk ka marrë akoma një vendim se kur do ta shqyrtojë çështjen, por Nazmiu është i bindur se e drejta, sado që të vonohet, është në anën e popullit të Dibrës.

gjallëronte ekonomia. Ai ka qenë kryeplak i fshatit dhe e di mirë se çfarë është bërë me tokën.

Ai beson se është ngatërruar qëllimisht ligji i famshëm 7501 për tokën dhe ndarja sipas trashëgimisë, duke e futur dokumentacionin për tokën në një qorrsokak, pa zgjidhje.

Ai beson se ndarja e tokës edhe me ligj, edhe me trashëgimi, është një ngatërresë e qëllimshme në Dibër, për të sjellë ngatërresa, për të bërë poshtërsi.

Nazmiu këtë vit ka mbjellë 120 dynym grurë. Një ndihmë të qeverisë për fermerët që mbjellin grurë, e mori vetëm falë ndërhyrjes së kryetarit të Bashkisë së Dibrës, Rahim Spahiu.

"I bëra letrat, por nuk më dhanë ndihmë. U ankova. I shkrova një mesazh kryetarit të Bashkisë. Më priti dhe më tha: Vërtet i ke mbjellë 120 dynym grurë! – Po, - i thashë. Hajdeni dhe mateni, në qoftë se kam mbjellë edhe një metër më pak, nuk e dua ndihmën".

Çuditërisht, pak ditë pas kësaj bisede, më morën në telefon dhe më thanë se "fondi për ju është miratuar".

Nazmiu tregon se ka marrë 360 mijë lekë donacione, shumë e cila nuk ka mbuluar as shpenzimet e plehërimit. Por më mirë pak se hiç. Gjithashtu, ka marrë edhe 660 litra naftë. Nazmiu thotë se këtë vit kishte parashikuar të merrte rreth 40 ton grurë, por në të vërtetë, kur kombajna korri parcelën e fundit, rezultoi të merrte vetëm gjysmën e planifikuar. Ndërsa lajmet për çmimin e grurit nuk janë aspak optimiste.

Përveç grurit, Nazmiu ka mbjellë edhe 3.5 hektarë misër të bardhë dhe 4.5 hektarë bimë mjekësore.

Dibra ka një mundësi të mirë të mbjelljes së bimëve mjekësore.

"Kjo jo vetëm që është mirë për familjet, por është mirë edhe për bimët e egra mjekësore, të cilat po vilen pa kriter dhe rrezikohen të zhduken", thotë ai.

"Këtu ekziston mundësia për të punuar me bimët mjekësore në mënyrë të papame. Nga Drini në Korab mund të kultivohen mbi 2 mijë lloj bimësh", thotë Nazmiu.

Ndërsa na tregon në tokat e mbjella në Zbinec llojet e ndryshme të bimëve mjekësore, mes të cilave 1.1 hektarë tërfil, 0.7 hektarë hithra, 2.5 hektarë mullagë e zezë dhe 0.7 hektarë bar blete. Në tokën e tij bie në sy edhe një parcelë me luledielli, e cila ka filluar të çelë.

"E kam të gjithën të shitur", - thotë ai.

Kur i kërkon të tregojë kulturat bujqësore që ka mbjellë në tokat e tij - të gjitha nën ujë, ai nuk pushon së numëruari: fasule, shalqi, lloje të ndryshme perimesh...

Nazmiu tregon se jeton në shtëpi vetëm me bashkëshorten, Lazen. I ka dhënë Zoti 9 fëmijë, 5 vajza dhe 4 djem. Fëmijët i ka në Greqi dhe Gjermani. Një djalë, të madhin, Urimin, e ka afër shtëpisë në katund, i cili, së bashku me nipin, Halimin - që mban emrin e gjyshit, - merret më së shumti me blegtorinë. Vetëm nga trungu i tij familjar sot janë mbi 70 fëmijë. Është 28 herë gjysh dhe 7 herë stërgjysh. Por në shtëpi ai është vetëm me bashkëshorten. "Burrë e grua për shtëpi jemi të gjithë në katund".

Kishaveci, një fshat që dikur kishte mbi 230 familje - fshati i dytë më i madh i ish-fermës së Kastriotit, pas Brestit, sot është i braktisur - si një shumicë fshatrash në Dibër. Fshati me rreth 50 familje, në shumicën e tyre ka vetëm pleq. Të gjithë pothuajse të vetmuar, me fëmijët në emigracion.

"Këtu janë të mirat e gjithë botës, ndaj u bëj thirrje fëmijëve, të rinjve të kthehen! Të punojnë e ti mbjellin tokat! Pasuria e tyre është këtu!! - bën thirrje ai.

Familja e Nazmi Drizit është një familje e madhe në Kastriot. Të parët e tij kanë zbritur nga Sina rreth 400 vjet më parë. Gjyshi i Nazmiut, Elez Drizi, u arrestua nga austro-hungarezët dhe vdiq në Prizren, atje ku sot ka edhe lapidarin. Babai i tij, Halimi, mbeti jetim që 9-vjeç. Kur rritet, martohet dy herë: me gruan e parë, Hide Voka, lindi katër fëmijë - dy jetuan, ndërsa me gruan e dytë, Xhilkë Laçi, lindi 7 fëmijë, më i vogli prej tyre është Nazmiu.

"Babai im, në kohën e kooperativës, sapo i martonte djemtë, i përcillte".

Me "i përcillte" do të thoshte i nxirrtë në shtëpinë e tyre. Por në fakt, sot kanë ikur të gjithë.

"Unë mbeta me babain. Fëmija i fundit i dy grave. Dhe më duket se mua më peshon më shumë "amaneti i tij", për të ruajtur tokën e blerë me djersë".

Afër shtëpisë Nazmiu ka ndërtuar me buxhetin e tij dhe një rezervuar të vogël artificial. Ujërat që mblidhen gjatë dimrit



Kosheret e bletëve pas shtëpisë së tij në Kishavec. Hapsirat e tokave dhe shumëllojshmëria e luleve në çdo stinë, është një mundësi e mirë për zhvillimin e bletarisë.

"Nuk po shoh të rinjtë t'i kthehen tokës. Sikur kjo të ndodhte një ditë e më parë, nuk ka qeveri që ndërton Skavicën".



përdoren për ujitjen e tokave. Shumica e tyre me vaditje të lirë.

"Nuk kemi fuqi. Jemi të lodhur. Por është krim t'i lëmë tokat pa punuar".

Një shtëpi në fshat nuk ka kuptim pa bagëtitë. Një tufë me dhen po mrizojnë në vathë në këtë vapë qershori, ndërsa ngjitur me shtëpinë, dëgjohet gumëzhitja që vjen nga disa koshere të reja bletësh.

"Bletët i kam vënë për qejfin tim. Bleta gjithmonë më ka mahnitur, më ka tërhequr. Më ka bërë të kuptoj se nuk ka rëndësi sa i vogël je, por e rëndësishme është bashkimi dhe çfarë qëllimi ke në jetë".

Ky është viti i tretë që merret me mbarështrimin e bletëve dhe ka synim të bëjë një park të madh bletësh.

Mes kësaj atmosfere pune që rrethon Nazmiun, nuk përtoj ta ngacmoj rreth punëve të shoqatës për Mbrojten e Luginës së Drinit të Zi. Shpesh kam qenë kritik me të, kur e kam pasur përballë. I kam kërkuar të freskojë shoqatën, të mbledhë rreth vetes të rinj të shkolluar e të pasionuar pas vendit, ekspertë të natyrës, por kur sheh punët e Nazmiut, e kupton se pse kjo nuk ka ndodhur".

"Kush e ka pa hile – bujrum! I ka dyert e shoqatës të hapura. Por kush në emrin tonë kërkon të shesë Dibrën, - jo, kurrë nuk ka për të pasur mbështetjen tonë".

Shoqata e tij është në krye të disa organizatave mjedisore që e ka çuar çështjen e Skavicës në Gjykatën Kushtetuese. Gjykata nuk ka marrë akoma një vendim se kur do ta shqyrtojë çështjen, por Nazmiu është i bindur se e drejta, sado që të vonohet, është në anën e popullit të Dibrës.

"Kam vetëm një peng: Nuk po shoh të rinjtë t'i kthehen tokës. Sikur kjo të ndodhte një ditë e më parë, nuk ka qeveri që ndërton Skavicën".

Të rinjtë kanë ikur dhe Nazmiut i duhet të luftojë me bashkëmoshatarët e tij! Një luftë të vështirë, të pabarabartë dhe të padrejtë. Por ai dhe banorët e Dibrës do ta fitojnë. Sepse Dibra ka mbijetuar në shekuj, edhe tani do të triumfojë!



Nazmi Drizi në mes të tokave të tij në Zbinec, mbjellë me luledielli. Në sfond, pylli i lisave, pronë e familjes së tij.



Rezervuari artificial i ndërtuar sipër shtëpisë së Nazmiut, i gjithi investim i tij. Ujërat e tij vadisin parcelat e mbjella me misër.



Në mes të tokave në Zbinec, ku ka mbjellë lloje të ndryshme bimësh mjekësore: tërfil, hithra, mullagë e zezë, bar blete etj.



Në fermën e z. Dorjan Çenga, njëri nga përfituesit e projektit "Mbështetja e të rinjve fermer në Qarkun Dibër për të rritur të ardhurat e tyre ekonomike nëpërmjet kultivimit të Bimëve Mjekësore Aromatike (GREEN ECONOMY)", i cili financohet nga Bashkimi Europian nëpërmjet Volontari Nel Mondo – RTM Albania. Çenga ka mbjellë më shumë se 2 dynym tokë lule ciani dhe tërfil të kuq. *Foto: SHERM*

Kultivuesit e bimëve mjekësore në Dibër ndeshen me vështirësi

Brandimi i bimëve mjekësorë të Dibrës, një mundësi e mirë për të rritur të ardhurat dhe për të siguruar vazhdimësi

PESHKOPI, 30 QERSHOR 2023 - Dorjan Çenga është njëri nga 6 fermerët ka marrë ndihmën e nevojshme tekniko-financiare për kultivimin e lule cianit dhe tërfilit të kuq. Në një sipërfaqe për më shumë se 2 dynymë tokë, ai po kultivon këto bimë mjekësore në kuadrin e projektit "Mbështetja e të rinjve fermer në Qarkun Dibër për të rritur të ardhurat e tyre ekonomike nëpërmjet kultivimit të Bimëve Mjekësore Aromatike (GREEN ECONOMY)", i cili financohet nga Bashkimi Europian nëpërmjet Volontari Nel Mondo – RTM Albania,

Gjatë një vizite në fermën e Dorjanit, z. Danjel Bica, drejtues i shoqatës "Ekspertët e Rinj Mjedisore" (SHERM) dhe specialistëve të fushës, vënë re një gjendje e shumë e mirë të fidanëve, të cilët premtojnë për një prodhim të mbarë dhe cilësor.

"Qëllimi i këtij projekti është që të forcojë kapacitetet e fermerëve të rinj mbi promovimin dhe përdorimin e qëndrueshëm të burimeve natyrore, në rastin konkret të bimëve mjekësore, duke trajnuar fermerët për teknikat e reja të mbledhjes dhe kultivimit, në mënyrë që të ulet presioni mbi llojet e egra", thotë Bica.

Dorjani, ashtu si edhe 5 fermerët e tjerë në Dibër, që po mbështeten nga i njëjti projekt, ka pasur në vazhdimësi ndihmën e ekspertëve të fushës, që nga pastrimi i parcelës nga barërat e këqij, instalimi e sistemit vaditës e deri te mbledhja, tharja, paketimi e brandimi i produktit, duke sjellë një bashkëpunim të suksesshëm dhe me shumë perspektive.

Bimët mjekësore aromatike që po mbështeten me anë të këtij projekti janë ciani, tërfili i kuq dhe mëllaga.

Danjel Bica thotë se të njëjtën ndihmë që ka marrë Dorjani, kanë marrë edhe Ervis Bojku në Rrashnapojë për mbjelljen 1 dynym cian dhe 1 dynym tërfil të kuq; Mustafa Horeshka në Sohodoll më 3.5 dynym cian; Ardit Ilnica na Maqellarë me 1 dynym cian dhe 0.5 dynym mëllagë; Selam Jashari në Rabdisht me 1.2 dynym tërfil i Kuq dhe Erlind Zhugri në Sllovë me 1 dynym tërfil i kuq.

BRANDIMI I BIMËVE MJEKËSORE: NJË MUNDËSI PËR TREG TË SUKSESSHËM

Në kuadër të brandimit dhe etiketimit të produkteve të bimëve mjekësore, u mbajt në Peshkopi më 28 maj 2023 një takim informues me fermerët.

Brandimi përfshin një serë çështjesh që kanë të bëjnë me vendosjen e markës, krijimin e logos, certifikimin e produkteve, të cilat rrisin mundësinë për një qëndrueshmëri të gjatë në treg dhe të ardhura më të mira për kultivuesit dhe mbledhësit e bimëve mjekësore aromatike.

Për kultivuesit e rinj në Dibër mund të jetë akoma herët për të pasur një brand të tyre, por janë në kohën e duhur për të menduar për këtë.

"Treguesit e deritanishëm na bëjnë të besojmë se bimët mjekësore të kultivuara në Dibër janë një mundësi e mirë për të rritur ekonominë e familjeve dibrane, ndaj edhe brandimi i tyre duhet të jetë në fokusin e punës së fermerëve", thotë Danjel Bica, drejtuesi i SHERM.

Organizata që ai drejton ka kontakuar me një studio grafike në Tiranë për të menduar për këtë. Bujar Karoshi, nga M&B Botime dhe Studio Grafike, zhvilloi më 28 maj në mjediset e qendrës "GARD" në Peshkopi një takim me fermerët e rinj të përzgjedhur në projekt për kultivimin e bimëve mjekësore dhe mbledhës të tjerë të bimëve. Takimi ishte



Një foto gjatë trajnimit mbi domosdoshmërinë e brandimit të bimëve mjekësore aromatike të Dibrës. Foto: SHERM

informues dhe këshillues, për të menduar që tani për një brandim të bimëve mjekësore të kultivuara dhe në gjendje të egër.

"Brandimit i produkteve tuaja, krijimi i logos, emërtimit dhe elementëve të tjerë grafikë, janë shumë të domosdoshëm në paketimin dhe shitjen e bimëve mjekësore", tha ai.

Trajnim u fokusua në elementët që përbëjnë një markim cilësor të produktit, emërtimin e tyre, elementët grafikë për dizenjimin, ngjyrat e përdorura, etj.

Brandimi i një produkti synon jo vetëm identifikimin e prodhuesit dhe produktit, por edhe cilësinë e tij, duke sjellë kështu më shumë qëndrueshmëri në këtë treg të hapur edhe jashtë vendit, por edhe më shumë të ardhura për prodhuesit dhe kultivuesit e bimëve mjekësore.

Eksperti theksoi nevojën për një studim paraprak në këtë fushë, për secilin nga prodhuesit ose të gjithë së bashku, mbi nevojën e identifikimit të tregut dhe klientëve, mbi historikun e bimëve të kultivuara, zgjedhjen e një emri të veçantë, kërkimet për emra të ngjashëm ose dizajni të ngjashëm, shkrimin e një slogani që do ti shkonte përshtat produkteve të mbledhura, përdorimin e ngjyrave etj.

Në trajnim u diskutua edhe për mënyrën e vjeljes së bimëve mjekësore, ambalazhimin apo paketimin e tyre për tregje të ndryshme: për përdorim farmaceutik ose përdorim shtëpiak; marketimin e tyre, elementët që duhet të përmbajë një etiketë si emri, numri rendor i ambalazhit, emërtimi i bimës në latinisht, pesha bruto dhe neto, afatet e skadencës, mënyra e ruajtjes dhe përdorimit etj.

Takimi ishte edhe një shkëmbim përvojash në këtë fushë, duke sjellë në debat edhe problematikat e shfaqura dhe mënyrat e zgjidhjes së tyre.

Një material në PowrPoint iu shpërnda pjesëmarrësve, në të cilin ishin shpjeguar hollësisht arsyeja e krijimit të një Brandi në këtë fushë, krijimi i logove dhe etiketave deri te certifikimi i produkteve si natyrore ose Bio.

Gjithashtu, u shkëmbyen mendime edhe për nevojën e një logoje identifikuese të përbashkët, që të shprehë së më qartë dhe sa më bukur bimët mjekësore aromtike që kultivohen nga lugina e Drinit deri në Korab.



Mustafa Horeshka në Sohodoll duke verifikuar mbjellen e 3.5 dynym tokë me lule ciani. *Foto: SHERM*

NË KOSOVË PËR SHKËMBIM PËRVOJASH

Në kuadrin e shkëmbimit të përvojës, fermerët e rinj zhvilluan një ekspeditë 2-ditore në Kosovë, në fund të muajit qershor, në mjediset e fermës "Agro Shqiponja" në fshatin Tërpezë të komunës së Malishevës dhe takime me shoqatën "Guri i Zi' – Dragash.

Në takimin e organizuar në Prizren, me përfaqësuesit e shoqatës "Guri i Zi – Dragash", fermerët e rinj nga Dibra u njohën me praktikën dhe sfidat e shoqatës dhe fermerëve, të cilët janë mbështetur nga shoqata për kultivimin e llojeve të shartuar



Delegacioni i Bashkimit Europian gjatë një bisede me z. Danjel Bica, drejtuesi i SHERM, mbi rezultatet e projektit me të rinjtë që po kultivojnë bimët mjekësore aromatike në Dibër.

Foto: FB/Rural Albanian Youth

Ky artikull është shkruar në kuadër të projektit "Mbështetja e të rinjëve fermerë në Qarkun Dibër për të rritur të ardhurat e tyre ekonomike nëpërmjet kultivimit të Bimëve Mjeksore Aromatike (GREEN ECONOMY)", zbatuar nga SHERM në partneritet të ngushtë me RTM Albania.

Rural Albanian Youth është financuar nga Delegacioni i Unionit Europian në Shqipëri dhe implementuar nga Volontari nel Mondo RTM, në partneritet me ADAD Malore Fondacioni Partneritet për Zhvillim, AgroPuka, Rrjeti Shqiptar per Zhvillim Rural - ANRD dhe Agia Giovani Imprenditori Agricoli – Agricoltura è Vita Agriagenzia (Cia - Agricoltori Italiani).

të "Pemëve të Imta" (Mjedra), të sjella nga Polonia.

Mjedra është një produkt i kërkuar në treg, me shumë vlera kurative, si dhe prodhon sasi të madhe për njësi sipërfaqe, duke sjellë fitimi të sigurta për kultivuesit.

Gjatë takimit me anëtarët e familjes Krasniqi dhe vizitës në fermën e tyre "Agro Shqiponja", të rinjtë u njohën me vështirësitë dhe përkushtimin që kërkojnë kultivimi i bimëve mjekësore, sfidat dhe mbështetjen e duhur për ta.

"Biznesi kërkon guxim dhe përkushtim, - thotë Shefqet Krasniqi. - Duhet të jeni gjithmonë të ndërgjegjshëm se do keni edhe humbje apo fitime të ulëta, por asnjëherë të mos bëheni pesimistë. Duhet që të jeni gjithmonë të ndershëm në raport me bashkëudhëtarët në biznesin tuaj dhe të respektoni rregullat e tregut".

Këshillat e Krasniqit për kultivuesit e rinj nga Dibra ishte që të punojnë me besim, seriozitet dhe bashkëpunim. Ai shprehu gatishmërinë për të bashkëpunuar me fermerët dibranë, duke u treguar i gatshëm që të udhëtojë për në Peshkopi dhe të shpërndaje të kultivuesit dhe mbledhësit e bimëve mjekësore përvojën e tij.



Danjel Bica, drejtuesi i SHERM, gjatë një trajnimi me fermerët mbi kultivimin e bimëve mjekësore aromatike në Dibër. *Foto: SHERM*

BIMËT DREJT ZHDUKJES: SI TI RUAJMË

Në kuadrin e të njëjtit projekt, SHERM ka organizuar edhe disa takime të tjera me kultivuesit dhe mbledhësit e bimëve mjekësore, me qëllim informimin e tyre mbi rolin e bimëve mjekësore në ekonominë e rajonit dhe nevojën për ti ruajtur ato.

"Ne kemi identifikuar disa lloje bimësh mjekësore që po dëmtohen nga mbledhësit e tyre, por kemi evidentuar dy prej tyre që janë në rrezik zhdukje: boronica dhe aguliçja" - thotë Danjel Bica

Trajnimet e zhvilluara më 27 shkurt dhe 28 mars 2023, kanë synuar të informojnë mbledhësit e këtyre bimëve mbi teknikat e vjeljes, përpunimin e tyre, tharjen, paketimin e deri nxjerrjen në treg.

"Me anë të këtyre kurseve të rinjtë kanë mundësi të shkëmbejnë përvojat mes tyre dhe të shkëmbejnë informacione sa më të hollësishme, në mënyrë që jo vetëm të sigurojnë më shumë të ardhura, por edhe të ruajnë jetëgjatësinë e tyre në natyrë.

Një nga trajnimet e ndjekura me interes, ka qenë ai i "Teknikave të vjeljes dhe përpunimit të Bimëve Mjekësore Aromatike", i zhvilluar gjatë muajit qershor në Peshkopi.

Pjesëmarrësit në këto trajnime bien dakord se për të shtuar vlerën e produkteve në treg, duhet një koordinim mes tyre, që nga paketimi, etiketimi e deri të blerësi fundit, që janë depot e bimëve mjekësore ose qytetarët.

Kultivuesit ndjejnë nevojën e mundësive për blerjen e tharësve të bimëve mjekësore dhe ndoshta edhe ndërhyrjen me mbështetje financiare nga pushteti vendor dhe qendror, për krijimin e kontratave të sigurta dhe afatgjata për shitjet e produkteve të tyre.

Pjesëmarrësit në këto trajnime kanë treguar përvojat e tyre në kultivimin, mbledhjen, tharjen dhe shitjen e bimëve mjekësore dhe shpesh vihet re se përvojat e tyre, sa të ngjashme, por shpeshherë edhe ekstremisht të ndryshme.

Problematikat në këtë sektorë fillojnë që nga mjetet e domosdoshme për vjeljen si kova, krehra, tharëse ekologjike, e deri te ndikimi i transportit, sidomos infrastruktura jo e mirë rrugore, e cila shpesh sjell dëmtim të bimëve gjatë transportit, sidomos për boronicën.

"Boronica e njomë është delikate gjatë transportimit, ndaj shpesh mbledhësit e saj kërkojnë ta shesin atë në gjendje të freskët", thotë Bica.

Ajo që po i kushtohet rëndësi gjatë trajnimeve është fakti që bimët të mos dëmtohen, thotë ai.

"Gjatë vjeljes shumë mbledhës nuk janë vetëdijshëm për gabimet që bëjnë, duke rrezikuar vazhdimësinë e prodhimit në vitet e ardhshme".

"Njëri nga gabimet është vjelja para kohe e luleve apo frutave, - thotë Bica. Një tjetër gabim është edhe fakti që nuk lihet mjaftueshëm për vitin pasardhës ose dëmtohen duke i prerë".

Mungesa e një kontrate të rregullt për shitjen e tyre si dhe mungesa e identifikimit të tyre përmes një emri të produktit pse brandi të tyre, i detyron kultivuesit dhe mbledhësit e bimëve që tu drejtohen pikave të mëdha të grumbullimit, të cilat diktojnë çmimet, shpeshherë të pakënaqshme për fermerët.

DIBRA, SHUMË MUNDËSI PËR KULTIVIMIN E BIMËVE MJEKËSORE DHE AROMATIKE

Dibra ka një reliev kodrinor-malor që varion nga 350 m mbi nivelin e detit në Luginën e Drinit të Zi, deri në lartësinë 2751 m në majën e Korabit. Kjo bën të mundur që ky rajon të dallohet për shumëllojshmërinë e tokave, duke qenë një mundësi shumë e mirë e mbledhjes dhe kultivimit të bimëve mjekësore aromatike.

Bimët mjekësore në Dibër përbëjnë një sektor me rëndësi jetike, duke kontribuar në buxhetin e familjeve që merren me mbledhjen e tyre në 25-30% të të ardhurave. Në zonën e pellgut të Drinit të Zi llogaritet që të ardhurat nga bimët mjekësore të zënë 15-20% dhe në zonën kodrinore malore të zënë 50-60%.

Zyber Gjoni, një nga ekspertët e fushës dhe një nga grumbulluesit më të mëdhenj të bimëve mjekësore në rajon, thotë se "në Dibër grumbullohen rreth 120 lloje bimësh, por llojet që kanë peshën kryesore janë 15-20 bimë. Sipërfaqja nga e cila grumbullohen bimë mjekësore llogaritet të jetë në mbi 30.000 ha, duke përfshirë tokën bujqësore dhe atë pyjore e kullosore".

"Toka dhe kushtet klimatike të Dibrës janë shumë të përshtatshme për kultivimin bimëve mjekësore dhe aromatike. Mundësia për të rritur të ardhurat ekonomike familjare dhe vetëpunësimi, si dhe pasioni për natyrën dhe bimët, i shtyn shumë familje në Dibër të angazhohen në mbledhjen e bimëve mjekësore, nisur edhe nga fakti që Dibra përfaqëson një vend me shumëllojshmëri të lartë të këtyre bimëve në Shqipëri", thotë Gjoni.

Bimët mjekësore dhe aromatike, janë lëndë e parë bazë për industrinë farmaceutike dhe atë kozmetike. Ato janë të domosdoshme edhe për industrinë ushqimore dhe atë kimike. Nisur nga vlerat e gjithanshme ekonomike, ekologjike dhe mjekësore, ato përbëjnë sot dhe në të ardhmen një pasuri natyrore me rëndësi të jashtëzakonshme.

Një nga synimet e projektit që po zbatohet nga SHERM është që të mbështesë zhvillimi e qëndrueshëm, nëpërmjet ruajtjes dhe përmirësimit të florës ekzistuese, shtimit nëpërmjet kultivimit të bimëve mjekësore dhe aromatike, të kërkuara nga eksporti, në përshtatje me kushteve klimatike e tokësore.

Për të siguruar treg të qëndrueshëm dhe me leverdi ekonomike për zonat rurale e bujqësore duhet të orientojmë grumbulluesit dhe fermerët për prodhimin e produkteve të certifikuara të pastra organike (bio).

Kërkesa në rritje për ilaçe bimore ka çuar edhe në rritje të shqetësimeve rreth ndikimit mjedisor, të mbledhjes për qëllime tregtare në shkallë të gjerë të bimëve të egra. Shumë lloje të vlefshme bimësh mjekësore janë bërë të kërcënuara, të rralla apo edhe të rrezikuara për shkak të mbi apo keqshfrytëzimit nga habitati i tyre natyror.



Fermerët e rinj dibranë gjatë një vizite në fermën "Agro Shqiponja" në Malishevë, Kosovë.
Foto: SHERM



Rruga e Arbërit nr. 200

Rezervuari i madh do të ndikojë, sipas bashkisë, deri në 15,138 hektarë tokë, kryesisht tokë bujqësore dhe pyje, por edhe 41 fshatra. Me disa mijëra njerëz të zhvendosur, Skavica mund të ketë pasojat më të mëdha sociale nga çdo digë e ndërtuar në Evropë në shekullin e 21-të.

analizë

Qeveria shqiptare dështon të mbrojë qasjen e komuniteteve lokale ndaj tokës dhe natyrës

Në vend që të rrisë sigurinë e saj energjetike, Shqipëria po u jep përparësi ndërtimit të shumë hidrocentraleve, duke çuar në humbjen e tokës së mijëra familjeve dhe në zhdukjen e mundshme të maces më të rrallë të Evropës. Korporata Financiare e Zhvillimit Ndërkombëtar të SHBA-së, agjencia e financimit të eksporteve të Mbretërisë së Bashkuar dhe banka HSBC ende nuk kanë konfirmuar ndonjë interes për financimin e Skavicës.



Projektet e hidrocentraleve të reja sjellin rreziqe serioze për njerëzit dhe natyrën, të cilat shumë shpesh kanë më shumë rëndësi se përfitimet ekonomike. Në rastin më të keq, sipërfaqe të mëdha toke përmbyten, shumë njerëz duhet të braktisin vendin e tyre, lumenjtë shndërrohen në rezervuarë artificialë, kafshët e egra zhduken dhe vendi mbetet me borxhe të huaja dhe një sistem energjie të cënueshëm nga klima.

Duke marrë parasysh të gjitha këto kritere, diga e planifikuar e Skavicës në Shqipëri është jashtëzakonisht e dëmshme. Megjithatë, sipas qeverisë shqiptare, Korporata Financiare e Zhvillimit Ndërkombëtar të SHBA-së (DFC) po mendon ta financojë atë, edhe pse projekti do të përfshihej në listën e projekteve kategorikisht të ndaluara nga DFC-ja. Në fund të vitit 2022 dhe në fillim të 2023, qeveria pohoi gjithashtu se agjencia e financimit të eksporteve në Mbretërinë e Bashkuar (UKEF) dhe banka HSBC do të jenë të interesuara për financimin e projektit. Asnjë nga këto institucione ende nuk e ka konfirmuar se po e shikon seriozisht projektin.

Shqipëria mbështetet shumë në hidroenergji, e cila përbën 95% të energjisë elektrike të prodhuar në vend. Prodhimi i saj vjetor ka pësuar ulje nga mungesa e ujit për shkak të ndryshimeve klimatike, një problem i cili do të përkeqësohet edhe më shumë në të ardhmen e afërt, sipas Bankës Botërore. Shqipëria duhet të investojë në efiçencën e energjisë, impiantet diellore dhe të erës, si dhe mirëmbajtjen e digave ekzistuese, në vend që të ndërtojë më shumë të tilla.

LUGINA E DIBRËS NËN UJË

Projekti i hidrocentralit të Skavicës përfshin një digë të madhe të ndërtuar në një grykë të pacënuar pranë fshatit Skavicë të bashkisë Kukës. Pasojat më të theksuara do të ishin në bashkinë Dibër. Rezervuari i madh do të ndikojë, sipas bashkisë, deri në 15,138 hektarë tokë, kryesisht tokë bujqësore dhe pyje, por edhe 41 fshatra. Me disa mijëra njerëz të zhvendosur, Skavica mund të ketë pasojat më të mëdha sociale nga çdo digë e ndërtuar në Evropë në shekullin e 21-të.

Deri më tani, nuk ka asnjë informacion zyrtar për projektin dhe vendndodhjen e digës, pasi vlerësimi i ndikimit mjedisor dhe social (VNMS) pritet të përfundojë në gjysmën e dytë të vitit 2023. Por sipas promotorit të projektit, Korporata Elektroenergjetike Shqiptare (KESH), diga do të jetë 147 metra e lartë.

Vendime të marra larg syrit të publikut


Në korrik 2021, në dukje pa asnjë procedurë tenderimi, u nënshkrua një kontratë paraprake mes KESH dhe gjigantit amerikan të ndërtimit Bechtel për fazën e parë të projektit. Kjo kontratë përfshinte: kryerjen e hetimit teknik, ndërtimin e rrugëve të aksesit për ndërtimin e mëtejshëm dhe kryerjen e një vlerësimi të ndikimit mjedisor dhe social. Kësaj i ka paraprirë një ligj i posaçëm i miratuar në parlament (nr. 38/2021), me emrin e kompanisë Bechtel në ligj, duke eliminuar kështu prokurimin dhe konkurrencën e hapur, jo vetëm për fazën e parë, por edhe për fazën e ndërtimit. Tashmë, një ligj i ngjashëm i posaçëm për godinën e Teatrit Kombëtar është cilësuar si antikushtetues nga Gjykata Kushtetuese shqiptare.

Bechtel ka fituar famëkeqësi në Evropën Juglindore për përfshirjen e saj në disa projekte të pasuksesshme dhe/ose të shtrenjta, si në Kosovë, Rumani dhe Maqedoninë e Veriut. Ky fakt rrit rrezikun e korrupsionit të mundshëm dhe dyshimet për vlerën e projektit, si dhe për transparencën e vlerësimit të ardhshëm të ndikimit në mjedis. Nëse marrëveshjet për projektin janë bërë tashmë, pas dyerve të mbyllura, atëherë VNMS-ja është e detyruar të dalë me përgjigjen "e duhur", pavarësisht nga gjetjet e saj aktuale.

Banorët vendas kanë organizuar shumë protesta në Shqipëri dhe SHBA kundër impiantit të planifikuar dhe vendimmarrjes. Në vitin 2020, policia gjobiti dy nga organizatorët e një proteste të tillë, "si një mënyrë", thonë personat në fjalë, "që institucionet të trembin popullin të mos reagojë ndaj vendimeve zyrtare".

MACJA MË E RRALLË NË EVROPË PRANË ZHDUKJES

Përveç pasojave të pashmangshme negative në komunitetet lokale dhe shkeljes së të drejtave të tyre njerëzore, diga do të përmbyste gjithashtu fushat, pyjet dhe kullotat përreth lumit ku shumë specie të kërcënuara në Evropë janë të zakonshme.



Por një nga kafshët është veçanërisht e rrezikuar, në fakt është macja më e rrallë në Evropë. Rrëqebulli i Ballkanit (Lynx lynx balcanicus) ka më pak se 40 individë të mbetur në natyrë. Gryka e Drinit të Zi, e cila ka shkrepa të paarritshme dhe pyje larg fshatrave, është e vetmja zonë ku rrëqebulli mund të kalojë midis Parkut Kombëtar të Mavrovës në Maqedoninë e Veriut dhe malit të Munellës në Shqipëri. Ndërtimi i digës do të izolonte dy popullatat e vetme të qëndrueshme dhe do t'i dënonte ato me zhdukje.

Por një nga kafshët është veçanërisht e rrezikuar, në fakt është macja më e rrallë në Evropë. Rrëqebulli i Ballkanit (Lynx lynx balcanicus) ka më pak se 40 individë të mbetur në natyrë. Gryka e Drinit të Zi, e cila ka shkrepa të paarritshme dhe pyje larg fshatrave, është e vetmja zonë ku rrëqebulli mund të kalojë midis Parkut Kombëtar të Mavrovës në Maqedoninë e Veriut dhe malit të Munellës në Shqipëri. Ndërtimi i digës do të izolonte dy popullatat e vetme të qëndrueshme dhe do t'i dënonte ato me zhdukje.

Diga e Skavicës do të përmbyste gjithashtu pyllin përgjatë Drinit të Zi, i cili përbëhet nga pemë si alderi i zi (Alnus glutinosa), plepi i zi (Populus nigra) dhe shelgjet (Salix sp.). Ky pyll është habitat prioritar sipas Direktivës së BE-së për Habitatet. Mbrojtja e këtij pylli është i nevojshëm për të ruajtur më shumë karbon në tokë, gjë veçanërisht kritike në vendin me shkallën më të lartë të shpyllëzimit në Evropë (që çoi në ndalimin e prerjeve të drurit në 2015).

Është shokuese që Shqipëria ende po e shtyn zhvillimin e hidrocentraleve. Hidroenergjia jo vetëm që nuk do të zgjidhë krizën energjetike të vendit, por do të rrezikojë jo vetëm natyrën dhe kafshët e egra, por edhe dibranët që do të detyrohen të lënë pas shtëpitë e tyre dhe tokat nga të cilat varen. Ndërtimi i hidrocentraleve të rinj në të ardhmen do të bëhet edhe më i vështirë për shkak të cenueshmërisë së klimës, biodiversitetit unik të rajonit dhe rezistencës publike. Nisur nga situata e mësipërme, presim që Korporata Ndërkombëtare Financiare e Zhvillimit të SHBA (DFC) mos të financojë hidrocentralin e Skavicës.

Përktheu nga anglishtja Klovis Karoshi.
Marrë nga www.perangua.com

cyan magenta yelloë black



Foto e kullës në fshatin Fshat, Klos.

Shtatë vite pasi në të gjithë vendin u ngrit një sistem kamerash për të monitoruar kontrabandën në pyje, kullat e monitorimit, që kushtuan 1.2 milionë euro, u vodhën dhe u shitën për skrap. Pas shkrirjes së Inspektoratit që i kishte në administrim, Ministria e Mjedisit ka "harruar" t'ia transferojë këto asete Agjencisë Kombëtare të Pyjeve.

Kushtuan 1.2 milionë euro, kamerat, që do të monitoronin pyjet, shiten për skrap

Nga **DRITAN KURTI**

Banorët e fshatit Fshat në Bashkinë e Klosit u habitën jo pak, kur në vitin 2016 jo shumë larg banesave të tyre u ngrit një kullë e lartë, metalike. E pajisur me panele diellore, me kamera me kënd rrotullimi 360 gradë, kulla do të shërbente si "polic" për të monitoruar kontrabandën e lëndës drusore, që merrej nga pyjet e Gurit të Bardhë dhe të Xibrit.

"Na thanë: "E kemi vendosur në kthesë, për të zbuluar ata që presin dru në male", – tregon Halit Zeneli, një banor i zonës, pa ditur të thotë se cilit institucion i përkisnin punëtorët që bënë instalimet. Por, 7 vite më pas, ndërsa kullës i kanë mbetur vetëm hekurat, kontrabanda e pyjeve vazhdon. Askush nuk e di se ku kanë përfunduar kamerat, panelet diellore e pajisjet e tjera, të vendosura aty.

Halit Zeneli, i cili jeton vetëm pak metra larg kësaj pike monitorimi, thotë se ajo ka funksionuar për rreth dy vite. Më pas nuk është interesuar askush dhe ka rënë pre e grabitjes.

"Dimë që kamerat i morën tre djem të rinj. Ka qenë një kabull, që e furnizonte me energji, por edhe ai është zhdukur. E vetmja që ka mbetur, është kjo kulla prej hekuri, të cilën ne, banorët e fshatit, nuk lejuam që ta merrnin, pasi donin ta çonin për skrap", – shpjegon Zeneli.

Kjo kullë ishte pjesë e sistemit kombëtar të monitorimit të kontrabandës së pyjeve, që u ngrit 7 vite më parë në të gjithë vendin. Në secilën prej këtyre kullave ishin instaluar 7 kamera me rezolucion të lartë, panele diellore për furnizimin me energji, në mënyrë që të funksiononin pa ndërprerje. Ngritja e këtij sistemi kushtoi plot 1.2 milionë euro (128.6 milionë lekë), investim që sot është rrënuar krejtësisht.

Me ambicien për të ndaluar prerjen e paligjshme të pyjeve, Ministria e Mjedisit asokohe largoi nga puna qindra specialistë, që monitoronin në terren pyjet, të cilët u "zëvendësuan" me kamera. Pavarësisht shpenzimeve për ngritjen e tij, ekspertët janë të bindur se, jo vetëm që ky investim nuk ka patur asnjë ndikim pozitiv, por madje ka shtuar kostot.

"Rreth 700 specialistë të pushuar padrejtësisht nga puna, shumica absolute e tyre fituan gjyqet me ministrinë dhe u paguan. Ka specialistë, që vazhdojnë të paguhen edhe sot e kësaj dite prej atij vendimi absurd të ministrisë", – thotë inxhinieri i Pyjeve, Abdulla Diku.

Sipas tij, nëse fondi i shpenzuar për kamerat, për instalimin dhe për mirëmbajtjen e tyre do të ishte përdorur si duhet, "mbase do të ishte pyllëzuar i gjithë baseni i Bovillës dhe Tirana sot do kishte ujë më të pastër e më të sigurt për banorët e saj".

PROJEKTI I DËSHTUAR I KAMERAVE

Në vitin 2016, ish-Inspektorati Shtetëror i Mjedisit, Pyjeve, Ujërave dhe Turizmit (ISHMPUT), i cili në atë kohë menaxhonte të gjitha ekonomitë pyjore të vendit tonë, vendosi që të ndërtojë një sistem monitorimi digjital të rrugëve kryesore në vend, nga ku mendohej se kalonte lënda drusore kontrabandë. Ky vendim erdhi njëkohësisht me vendosjen e moratoriumit 10-vjeçar të prerjes së pyjeve.

Tenderi për "Blerje sistemi elektronik i monitorimit të pyjeve" u hap në shkurt të vitit 2016 dhe fituese u shpall kompania "FASTECH", me vlerën 128,629, 690 lekë, shumë afër fondit limit prej 133,333,503 lekësh.

Në të gjithë vendin u ndërtuan 28 kulla monitorimi, të pajisura me kamera, por ato nuk arritën të kapin asnjë "abuzues". Të dhënat zyrtare tregojnë se rastet e paligjshmërisë së prerjes së pyjeve, të konstatuara, si në rrugë, ashtu edhe në fondet pyjore, kanë qenë thuajse të njëjta me ato të viteve të mëparshme. Sipas të dhënave të siguruara nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, rezulton që në periudhën 2015-2020 të jenë konstatuar 1.528 raste të prerjes së paligjshme të pyjeve me 1.675 autorë. Lënda drusore, e sekuestruar i kalon disa mijëra metra kub. Ndonëse INA MEDIA kërkoi që t`i viheshin në dispozicion të dhënat se sa prej rasteve të shkeljeve ishin konstatuar nga pikat e monitorimit, ky informacion nuk na u vu në dispozicion.

Kulla e monitorimit në fshatin Klos Katund të Bashkisë Klos është zhdukur krejtësisht. Siç edhe dëshmojnë fotot e siguruara nga Investigative Network Albania, kamerat e monitorimit, panelet diellore e madje edhe kulla prej hekuri nuk ekzistojnë më. Në vend ka mbetur vetëm bazamenti prej betoni, ku ishte vendosur kulla. Ajo do të shërbente për të monitoruar prerjen e paligjshme të pyjeve të Martaneshit.

Krejt ndryshe, në fshatin Burgajet të Matit kulla e monitorimit të pyjeve nuk funksionon, por është thuajse e paprekur. Kjo ndoshta për faktin se ndodhet pranë disa banesave dhe ka qenë i vështirë dëmtimi nga të tjerët apo vjedhja e materialeve. Po njësoj, edhe në Fushë Bulqizë kulla e monitorimit, që ndodhet ngjitur me rrugën nacionale, është me të gjitha elementet, por nuk dihet, nëse është në funksion apo jo.

Dy kullat e monitorimit të kontrabandës në pyje, të vendosura pak vite më parë në fshatin Fshat dhe Klos Katund të Bashkisë Klos, të cilat tashmë janë zhdukur, kanë kushtuar 2.6 milionë lekë.

Ndryshimet e shpeshta të inspektorateve, por edhe të vetë mënyrës së administrimit të pyjeve, kanë bërë që këto kulla monitorimi të përfundojnë si mall "pa zot".

Sektori i Administrimit të Pyjeve dhe Kullotave pranë Bashkisë Klos thotë se këto pika monitorimi nuk kanë qenë dhe nuk janë asete të bashkisë, ndërkohë që pranojnë se monitorimi i prerjes së pyjeve është një sfidë e madhe, më së shumti për shkak të mungesave të theksuara të mjeteve të transportit.

"Nuk kemi infrastrukturë për kontrollin e territorit, pasi na mungojnë mjetet e transportit. Në shumicën e rasteve kontrollin e territorit e bëjmë me mjetet tona", – thotë Kapllan Allamani, përgjegjës i sektorit të pyjeve në Bashkinë e Klosit. Sipas tij, zonat më problematike janë ato që kufizohen me Tiranën, Dibrën, Bulqizën dhe Krujën për shkak të largësisë dhe terrenit të vështirë.

Nga ana tjetër, edhe ADZM, Dibër thotë se nuk i ka patur asnjëherë në inventar kamerat e vendosura në territorin e qarkut Dibër. Në një koment për këtë çështje, dhënë për INA MEDIA-n, ky institucion thotë se nuk ka asnjë dijeni për këtë investim dhe se ky sistem nuk ka qenë as në administrim e as në përdorim nga ana e tyre, pasi ishte pjesë e ISHMPUT-së, që kur është ndërtuar.

Nga një vëzhgim i bërë nga INA MEDIA në malin e fshatit Xibër-Murrizë prerja e drurëve të ahut vazhdon. Banorët thonë se kjo është ndikuar edhe nga ndërtimi i bypass-it të Murrizit që është pjesë e Rrugës së Arbrit, rrugë, e cila krijon lehtësi për t'i transportuar drejt Tiranës apo qyteteve të qarkut Dibër.

Bashkia e Klosit pranon se kjo zonë, megjithëse bën pjesë në hartën e zonave të mbrojtura, mbetet më problematikja dhe ka rënë pre e kontrabandës për shkak të punimeve në Rrugën e Arbrit.

"Me hapjen e bypass-it mendojmë se është favorizuar prerja e paligjshme e pemëve në zonën e mbrojtur Linos -Guri i Bardhë-Bizë-Martanesh", – pranon Kapllan Allamani nga Bashkia e Klosit.

"Sa i përket malit të Murrizit, rruga e vjetër nga Qafa e Murrizit-Qaf Qershi-Kroi i Pajnës-Zgurë-Ura e Karthniqit është zonë e mbrojtur në varësi të ADZM, Dibër, por, edhe pse është në varësi të ADZM-së, inspektorët tanë kontrollojnë në mënyrë të vazhdueshme dhe njoftohen për prerje të paligjshme. Pas kësaj ne vëmë në dijeni ADZM-në", – përfundon më tej ai.

Ekspertët e pyjeve thonë se ky ishte një investim i kotë, sa kohë që administratat nuk kanë njerëz dhe specialistë për t`i monitoruar pyjet. Sipas tyre, kontrabandistët ua gjetën zgjidhjen edhe kamerave.

"Edhe sikur të kishin funksionuar kamerat, ato veç do të filmonin dhe do të tregonin faktin, që pyjet janë prerë, por nuk kanë ndihmuar aspak për të parandaluar prerjen. Si për çdo gjë tjetër, edhe kamerave ua gjetën "zgjidhjen" kundërvajtësit. Herë i mbulonin, që të mos filmonin, e herë devijonin një copë rrugë për t`iu shmangur atyre. Në fund, mendoj se kanë fituar kundërvajtësit", – shpjegon Diku.

INVESTIMI PREJ MILIONA EUROSH, "MALL PA ZOT"

Në fund të vitit 2019, inspektoratet iu nënshtruan një reforme totale dhe ISHMPUT u shkri si institucion. Si pasojë, ky investim prej 1.2 milionë eurosh ngeli pa zot, duke sjellë shkatërrimin e tyre.

Ministria e Mjedisit u kujtua se kishte nën administrim edhe një investim të tillë, vetëm pas kërkesës së dërguar nga Investigative Network Albania. 4 vite pas shkrirjes së inspektoratit qendror, ende sot institucionet nuk janë në gjendje të thonë se çfarë ka ndodhur me këto kulla apo, aq më pak, të kenë një inventar të tyre. Për rezultate as që flitet.

Ministria e Mjedisit justifikohet me faktin se ende nuk ka përfunduar procesi i ristrukturimit të institucioneve të tjera, ku u shpërndanë kompetencat e ISHMPUT-së. Megjithatë, ministria thotë në një përgjigje me shkrim, se ky sistem aktualisht është në proces transferimi pranë Agjencisë së Pyjeve, të krijuar rishtazi.

"Në kuadër të procedurave të ndërmarra për të mbyllur të gjitha detyrimet në rastin e shkrirjes/mbylljes së një institucioni, Sistemi Elektronik i Monitorimit të Pyjeve u transferua përkohësisht pranë MMT-së dhe aktualisht është në proces transferimi pranë Agjencisë Kombëtare të Pyjeve, institucion në varësi të MMT-së, i krijuar i ri pas shkrirjes së ISHMPUT", – i tha INA MEDIA-s në fund të muajit maj Ministria e Mjedisit.

Në një përgjigje me shkrim Agjencia Kombëtare e Pyjeve e nxjerr zbuluar Ministrinë e Mjedisit, duke mohuar që t'i ketë kaluar në pronësi, si pasojë nuk ka dijeni se çfarë është bërë me këtë sistem. Vetë Agjencia Kombëtare e Pyjeve u vu në dijeni se do t`i transferohej ky "investim" vetëm pas shkresës së INA MEDIA-s.

"Ky sistem nuk i ka kaluar në përdorim AKP-së. Lidhur me faktin se kush e disponon, është në funksionim apo jo, si dhe për gjendjen fizike dhe teknike të stacioneve të kamerave në territor, duhet të kërkoni informacion në Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit", – thotë Agjencia Kombëtare e Pyjeve.

Mirëpo, AKP sqaron se, Ministria e Mjedisit, në të njëjtën ditë që i ka kthyer përgjigje INA MEDIA-s, i ka adresuar një shkresë edhe Agjencisë Kombëtare të Pyjeve, me lëndë "Kërkesë për fillimin e procedurës së kalimit kapital pa pagesë të Sistemit Elektronik të Monitorimit të Pyjeve", protokolluar me nr. 387 prot., datë 25.05.2023.

Pra, siç duket, Ministria e Mjedisit dhe Turizmit është kujtuar për transferimin e këtij sistemi pranë Agjencisë Kombëtare të Pyjeve, vetëm pas marrjes së kërkesës për informacion nga Investigative Network Albania të datës 28.04.2023 dhe vetëm një ditë para kthimit të përgjigjes së datës 26.05.2023, pra në datën 25.05.2023, Ministria e Turizmit dhe Mjedisit ka nisur procedurën e transferimit të Sistemit Elektronik të Monitorimit të Pyjeve pranë Agjencisë Kombëtare të Pyjeve.

Duke bërë një bilanc të kësaj nisme, që e konsiderojnë politike dhe jo teknike, ekspertët këmbëngulin se ishte një dështim shumëdimensional, që ka sjellë shkatërrimin e fondit pyjor të vendit.

"Kjo është një kosto e jashtëzakonshme, jo vetëm prej lëndës së drurit të prerë, por mbi të gjitha sepse kostot për rigjenerimin e pyjeve të shkatërruara tashmë kanë kaluar në miliarda euro. Prej kësaj nisme duhet të nxjerrim njëherë e mirë mësimet e duhura", – shpjegon inxhinieri i pyjeve, Abdulla Diku. Po sipas inxhinierit Abdulla Diku, sasia e lëndës drusore, që pritet në një vit në vendin tonë, është shumë më e madhe se ajo që krijohet nga natyra.

"Në Shqipëri priten rreth 2.5 milionë m3 lëndë drusore në vit, ndërsa rritja vjetore e pyjeve është rreth 1.4 milionë m3/vit. Pra, presim rreth 1.1 milionë m3 më shumë nga sa është rritja vjetore, natyrore e pyjeve", – shpjegon ai.

Si pasojë e prerjes masive të pyjeve, Shqipëria paraqitet sot si vendi me erozionin më të lartë në Europë (12.5 herë më shumë erozion se mesatarja e vendeve të BE-së).

"Aktualisht nuk kemi specialistë pyjesh në terren, që t`i mbulojnë, t`i kontrollojnë e t`i menaxhojnë zonat pyjore, kështu iu është lënë dorë e lirë kundërvajtësve dhe informalitetit të lartë në këtë sektor (rreth 90% e produkteve drunore, që merren nga pylli, nuk paguhen). Ata pak persona, që paguhen në sektorin e pyjeve, nuk kanë asnjë lidhje me punën dhe profesionin përkatës", – përfundon Diku.

Marrë nga: ina.media

cyan magenta yelloë black

Rruga e Arbërit nr. 200

profil

Ruzhdi Bulku, *modeli i qytetarisë dibrane*

Nga **OSMAN XHILI**

Fisi Bulku është ndër më të vjetrit në qytetin e Peshkopisë. Sipas të dhënave gojore, thuhet se origjina e tyre është nga Macukulli i Burrelit dhe se kanë ardhur këtu që në kohën e Skënderbeut. Fisi Bulku ka pasur dhe një mulli të madh, deri në kohën e komunizmit, që i shërbente qytetit dhe banorëve rreth tij.

Nuk kishte se si, ky fis i vjetër dhe i qytetëruar, të mos nxirrte kuadro të denjë të fushave të ndryshme, si në mësuesi, inxhinieri, ushtarakë e të shumë drejtimeve të tjera.

Njëri prej tyre është Ruzhdi Bulku, i cili ka marrë cilësitë më të mira të kësaj plejade, për ti materializuar në jetë. Edhe nga krahu tjetër i nënë Qamiles, rrënjët janë të shëndosha. Dajat e tij të Çetushit ishin një brez hoxhallarësh të shquar, që do të ndikonin ndjeshëm në karakterin dhe personalitetin e Ruzhdiut.


Jeta e Ruzhdi Bulkut i ngjan një vullkani, që herë pas here nxjerr energji të brendshme. Si nxënës i shkollës "Irfan Hajrullai", ai do të shfaqte talentin e tij në pikturë. Punimet e tij shpesh zinin vend në muret dhe në stendat e shkollës, si më të përzgjedhurat. Zakonisht përdorte teknikën me djegie, që quhet pilografi, duke skalitur figura kombëtare, si Skënderbeu dhe personalitete të tjerë.

Nuk mbeti pa e provuar dhe mjeshtërinë e rrobaqepësit. Nga ekonomia shtëpiake, që kishte bërë në shkollë, pati marrë njohuritë e para dhe më pas i shtoi dhe i përsosi ato. Fantazia e tij krijonte forma dhe modele, që klientët e tij i pëlqenin aq shumë. Ca kohë punoi dhe si dizenjator, që nga ushtria e disa vite të tjera në ndërmarrjen e prodhimeve të ndryshme.

Ruzhdi Bulku gjithmonë fantazonte dhe eksperimentonte. Në vitin 1985 ai bëri një bufe me gdhendje dhe me ornamente të bukura, që për kohën ishte tepër e veçantë. Kaq shumë u vlerësua puna e tij, saqë bëri vend dhe te rubrika e lajmeve në televizionin e kohës. Shkolla e gdhendjes së drurit në Dibër, do të ishte titulli i kësaj rubrike. Nuk mbeti me kaq. Oreksi i tij profesional, sa vinte e rritej. Shtëpinë e tij e ktheu në një repart pune, ku nuk mungonte asgjë. Krijoi një kombinat druri me të gjithë aksesorët e duhur. Bëri një saldatriçe, që do t'i shërbente në punë të ndryshme dhe po ashtu një torno, ku do të kryente disa nga proceset e përpunimit të drurit.

Më interesantja ishte se asnjë prej këtyre elementeve nuk i mori nga shteti, por i krijoi vetë. Gjente hekurishte të pavlera, të hedhura rrugës dhe u jepte formën dhe funksionin që ai dëshironte, siç bën furrtari me brumin e ngjeshur. Një gjë e tillë nuk ishte e lejuar për kohën, por ai kishte një status inovacioni, si një mjeshtër i vërtetë.

Kështu u end Ruzhdiu duarartë në qerthullin e profesioneve të shumta, deri në vitin nëntëdhjetë. Si shumë të tjerë emigroi në Greqi, por një ndjesi e brendshme i thoshte se duhej të bënte më shumë për vendin e tij. U kthye dhe hapi një repart pune në zdrukthëtari. Nuk ishte hera e parë që punonte me drurin, por tashmë synimet ishin më të qarta e më të mëdha. Për gati dhjetë vjet u përkushtua në këtë drejtim, duke punësuar jo vetëm veten, por dhjetë të tjerë. Divane, këndе, dhoma gjumi, bufe e kundrabufe, dolën nga duart e këtij ekipi të talentuar. Ata që kishin porositur njëherë vinin sërish për porosi të reja. Shumë klientë, që takon Ruzhdiu, i thonë se i kanë akoma dhe sot e kësaj dite punët e tij.



Ruzhdi Bulku në mjedisete jashtme të hotel Alpin në hyrje të qendrës balneare të llixhave të Peshkopisë.

HOTELI TEK LLIXHAT

Pas punishtes së tij për përpunimin e drurit, u hapën dhe shumë të tjera, si ajo. Jo se trembej nga konkurrenca, pasi duart e tij nuk njihnin të dytë, porse Ruzhdiu mendoi se duhej të ndryshonte drejtim. Nuk duhej të shkonte larg për objektivin e ri. Banesat e tyre ishin ngjitur me përroin e Llixhave, një biznes që mund të lulëzonte me ndryshimet e reja. Kishte filluar ngritja e disa barakave për të akomoduar pushuesit që vinin për kurim, por hotel privat, akoma nuk figuronte. Ruzhdiu mendoi të investonte pikërisht aty. Kapaciteti i tij ishte deri në 120 vende dhe shumë pranë Llixhave. Ai u ndërtua në një kohë rekord dhe në vitin 2004 hyri në funksion. Gati tetë – nëntë persona janë të punësuar aty me kohë sezonale. Hoteli i tij ishte dhe dallëndyshja e parë e turizmit balnear, duke u bërë promotor dhe nxitës për të tjerët.

"Sot, - tregon Ruzhdiu, - gjërat kanë ecur shumë. Nga 200 pushues, që ishte kapaciteti para viteve nëntëdhjetë, ky numër ka shkuar deri në 3500 dhe 4000 persona ditorë. Janë 35 hotele dhe 100 shtëpi pritëse, që bëjnë të mundur akomodimin e kaq shumë njerëzve. Jo vetëm kaq, por sasi të konsiderueshme qumështi, mishi, frutash dhe perimesh, që kërkohen prej tyre, janë një pasuri e vyer për fermerët e Dibrës. Nuk po llogarisim këtu dhe kafet, restorantet e të tjera biznese që lulëzojnë nga kjo mori vizitorësh të shumtë".

Vijnë në llixhat e Peshkopisë mjaft persona nga Tetova dhe Gostivari dhe pse kanë rrugës dy komplekse balneare në Dibër të Madhe: të Kosovrastit dhe Banjishtit. Ruzhdiu thotë se "ujërat tona termale janë ndër më të mirat në Europë". Më tej, si për të ilustruar këtë konkluzion na tregon:

"Para 20 vjetësh vjen në hotelin tonë një



Kanatet e një bufeje me ornamente të punuara me dru nga mjeshtri Ruzhdi Bulku në vitin 1985.

burrë i moshuar, rreth 80 vjeç, nga Himara. Quhej Thanas Nasho. Kishte ardhur me një makinë "Golf", që andej dhe rruga e kishte lodhur. E pyeta se si i gjeti Llixhat e Dibrës?,

- Nuk kisha nevojë të m'i tregonte dikush, pasi i njoh prej kohësh këta ujëra çudibërës. Kur isha ushtar, në rininë time, vazhdoi ai tregimin, nuk e di për çfarë arsyesh, unë paralizohem. Kur shumë mjekime nuk më dhanë rezultat, më sjellin këtu në Llixha me barrelë. Mjaftuan vetëm pak seanca dhe unë ngrihem në këmbë për të vazhduar jetën time aktive. Ja, sot kam ardhur i vetëm që atje, ndonëse po mbush gati tetë dekada".

Historia e Thanasit nuk është e vetme. Sa veta vijnë këtu me shkop dhe ikin pa pasur nevojën e tij. Mjaft persona me sëmundje reumatizmale, të kockave, të lëkurës, kolitit e gastritit, e shumë të tjera si këto, gjejnë derman në këto Llixha. Janë këto arsyet, që i kanë dhënë këtij vendi e kësaj lugine një emër të bukur e domethënës: "Lugina e shërimit".

Në një nga tavolinat e mjediseve të jashtme të hotelit, tre burra disi në moshë na ftojnë të ulemi e të pimë një kafe me ta. Janë nga Tetova, dy nga fshati Gajre dhe njëri nga Selca. Ata të Gajres quheshin Burhan Halimi dhe Muzafer Ibrahimi dhe vinin rregullisht në hotelin e Ruzhdiut, që prej 20 vitesh. Pastërtia, rregulli dhe respekti i Ruzhdiut për mysafirët i ka bërë këta pushues, që të mos ndërrojnë destinacion, edhe pse ka plot mundësi të tjera.

"Ka dhe shumë gjëra, që mund të bëhen më mirë", - thotë Ruzhdiu.

Ai e ka kokën plot me ide, që shumë thjeshtë e bukur mund të vihen në zbatim. Pak më sipër llixhave gjendet një shesh prej disa hektarësh, ku mund të bëhen mrekulli. Mund të bëhen pishina me tre lloj ujërash, me të nxehtë deri në 42 gradë, me të ftohtë dhe me ujin gjips. Mund të bëhen shatërvane dhe lulishte, pista për motorë e biçikleta, fusha volejbolli, basketbolli. Të gjitha këto, jo vetëm që do ta shtonin ndjeshëm numrin e pushuesve, por do ta kthenin zonën nga një turizëm sezonal, në një turizëm gjithëvjetor. Buraviku dhe Qyteza janë dy monumente natyrore, që kësisoj do të bëheshin më të prekshme e të vizitueshme nga njerëzit.

Ruzhdi Bulku është kthyer në një zë përfaqësues për problemet e shumta që kanë operatorët turistikë të këtij komuniteti. Ata janë kundër privatizimit të Llixhave në dy-tre duar biznesmenësh, duke shkatërruar gjithë këto biznese. Ata ngrenë zërin për rrugën e ngushtë, për modernizimin e këtij aktiviteti, duke i bërë të ngjashme me simotrat e saj në Europë.

Llixhat e Peshkopisë, *nis sezoni i vjeshtës*

Qendra Balneare "Enver Shehu", e njohur ndryshe si Llixhat e Peshkopisë, ka hapur sezonin e vjeshtës për vizitorët. Ka disa lloje sëmundjesh që rekomandohen për kurim në ujërat termale, por kryesoret janë sëmundjet reumatizmale kronike, artrozat, neuritet periferike kronike, gjendjet pas frakturave traumatike, plegjit, hemiplegjit e tetraplegjit, hipertensioni arterial esencial pa insufiqencë kardiake, disa sëmundje të aparatit tretës si gastritet, kolitet, infeksinet kronike urinare, urolitjazat, kolelitiazat, disa sëmundje gjinekologjike si hipoplazit uteri infeksionet kronike të uterusit sterilitetin primar e sekondar, disa sëmndje të lëkurës si ekzema e mykozat e lëkurës etj.



Vetitë mjekuesë të ujit termomineral kanë të bëjnë me përbërjen kimike, hiperterminë natyrale, përmbajtjen e gazrave të tretur, veçanërisht hidrogjen sulfiti në përqendrime mesatare 54 Mg %, radioaktivitetin në nivel kurativ, gjurmët e metaleve të rralla, bakteriet jo patogjene dhe algat.

Vetitë mjekuese të ujit mund të merren me anë të banjove në ujin termomineral që arrin temperaturën afër 40OC duke qëndruar për 10-15 minuta në ditë, nga 10 në 15 ditë rresht. Banjot mund të bëhen dy herë në vit, por jo më shpejt se 6 muaj.

Duke rezervuar në një rrjet shërbimesh hotelerike përreth qendrës balneare, ju do të merrni edhe një orar të fiksuar për seancën e banjove në ujërat termale. Gjatë sezonit të pranverës dhe vjeshtës qendrën e vizitojnë mijëra pushues, kështu që është e nevojshme një rezervim paraprak për pushime tuaja.

Për më shumë informacion ndiq faqen në FB të Llixhave të Peshkopisë ose skano Barkodin:

https://www.facebook.com/profile.php?id=100065133425167

turizëm



Drejt majës së Korabit, destinacioni që nuk duhet humbur

Dikur Franc Nopca dhe Edit Durham vizitonin me muaj të tërë malet e Shqipërisë Veriore, kurse në kujtimet e tyre tregojnë se Ismail Strazimiri ka qenë prej shqiptarëve që me përshkrimin dhe orët që merr udhëtimi, ka qenë më i sakti prej gjithë njohësve të gjeografisë dibrane.

Nga **FITIM DIKA**

Të udhëtosh në Korab është një sfidë më vete, jo vetëm për lartësitë që disponon, por edhe për shumë bukuri të pazbuluara që ekspozon në çdo stinë. Përkundër faktit që është kthyer në 'bozë' ngjitja e Korabit të Madh (2764m) nga Radomira ose Strezimiri, edhe pse në Maqedoni shtegu më natyral i ngjitjes do duhej të ishte nga Zhuzhnja, andaj, ne vendosëm një ngjitje më spektakolare të Korabit: aty ku bukuria shijohet njëherë dhe kap të gjitha pikat më të rëndësishme të saj.

RADOMIRË - FUSHA E KORABIT - FUSHA E PANAIRIT

Në një ditë të nxehte vere, disa ushtarë të UÇK-së, për nder të heroit Tahir Sinani, kishin vendosur që të ngjisin Fushën e Panairit, në vendin ku ata kishin qëndruar me muaj të tërë në atë zonë përgjatë vitit 2001.

Pasi gjerbëm kafen e mëngjesit në Maqellarë të Dibrës, sëbashku nisemi drejt Radomirës, ku një grup tjetër nga Kosova na prisnin për këtë ngjitje që ishte edhe përvjetor njëherësh.

Nga Radomira, që ngjan me fshatrat përrallorë të Zvicrës, kemi ngjitjen e shkurtër, por jo edhe të lehtë drejt Fushës së Korabit. Të ngjall habi që mes maleve aq të thepisura të ndodhet një Fushë e tillë tepër e madhe, që falë thatësirës kishte marrë pamjen e një qilimi të pafundmë ngjyrë kafe. E famshmja këngë "Moj Fusha e Korabit", ia shton vlerën kësaj fushës edhe në aspektin historik e kulturor. Sipas shumë historianëve kjo këngë me vargje vajtuese tregon luftrat që kanë ndodhur në këtë zonë, por disa të tjerë mundohen të thonë se përshkruan vuajtjen e vajzës së dashuruar për bariun që kalon me muaj të tërë në stane duke ruajtur delet.

"S'asht nji ditë a dy – e, oj, mjera un-o, Janë gjashtë muej të zi - e, oj, mjera un-o!"

Nga Fusha e Korabit, që të kujtonte edhe filmat Ëestern, me pak kasolle e stane dhe udhëtime të gjata, nisemi për të ngjitur edhe një kodrinë për të dalë drejt një fushe tjetër,



Fusha e Panairit, e cila është e gjelbër në çdo kohë, falë edhe burimeve ujore që e përshkrojnë mespërmes. Kjo fushë gjendet nën majën e Korabit, 2115m, është 800 metra e gjatë dhe deri në 230 metra e gjerë dhe ka formën e një amfiteatri të madh.

Në këto treva dominon delja e racës rudë, të cilës i kushtohet edhe një këngë e bukur popullore.

Në Fushën e Panairit, që lumenjtë mes fushës zhduken në thellësitë e tokës, ish ushtarët e Tahir Sinanit vendosin një pllakë përkujtimore për komandantin e tyre.

KORABI I MADH, 2764M

Nga Fusha e Panairit, përmes një shtegu të ngurtë nisemi drejt majës së Korabit, që tashmë ngadalë afrohemi drejt piramidës nr. 4, e cila në kohë e komunizmit ndante si Muri i Berlinit Korabin në dysh: pjesën lindore-jugosllave dhe atë perëndimore-shqiptare. Pikërisht, kjo ka mundësuar që Korabi të mos jetë shumë i eksploruar në Lindje dhe Perëndim, por ka persona që njohin vetëm njërën anë të saj.

Pasi tashmë barrierat mes shteteve ballkanike janë më të vogla, nuk përbën asnjë rrezik kalimi ndërkufitar malor. Duke kaluar pak në thellësi të territorit të Maqedonisë së Veriut, ngjitemi drejt Korabit të Madh që është edhe maja më e lartë e trojeve shqiptare, plot 2764m. Te piramida sot është një piramidë metalike, e cila shënon lartësinë e Korabit dhe shërben edhe si një dekor në fotografitë q ëbëjnë turistët që kapin majën. Sipas disa barinjve aty pranë, gjatë një kohë të kthjellët, për ata që bëjnë kamping në majë dhe shikojnë në mëngjes, shikimi nga maja kap deri edhe Durrësin e detin e Adriatik. Por kjo për mua mbetet akoma e paverifikuar, megjithëse që barinjtë janë të bindur për këtë.

UJËVARË PËRROI I THELLË-LLAKQËT E GJIPQVE-LIQENI I GRAMËS

Prej majës më të lartë fillojmë të zbresim drejt një fushe tjetër të pasur me ujë, që tashmë njihet me emrin "Te Kryqi" në Maqedoninë Veriore, pasi deri para pak kohësh aty ishte vendosur një kryq nga ushtarët. Për të pasionuarit me off road, deri aty mund





të shkohet me fuoristradë, megjithatë ne, tashmë me një grup tjetër, marrim majtas për të zbritur teposhtë, në një shteg të dëmtuar falë erozionit dhe që kishte vështirësi të shumta, veçanërisht për ata që kanë problem me lartësitë, për t'u afruar deri të Bjeshkët e Bashkueme ose Bjeshkët e Abezallarëve.

Këtu dukeshin edhe disa kazerma të dikurshme ushtarësh, por ne duhet të ecnim edhe disa qindra metra drejt lindjes për të parë ujëvarën më të lartë të Ballkanit, që mban emrin e toponimit shqiptar Përroi i Thellë.

Nga Përroi i Thellë kthejmë mbrapsht për të ngjitur Bjeshkët e Bashkueme, ku tash përsëri ndodhemi në kufirin mes Shqipërisë dhe Maqedonisë Veriore.

Sëbashku me Pajtim Vranicin dhe Arben Hatellarin vijojmë drejt kreshtës së Korabit, ku arrijmë në Liqenin Izgrevono, liqeni ku lind dielli dhe ku nga aty fillonte të dukej edhe Ujët Kalar, një lum në formë gjarpri që zbukuronte fushën që ndante Majën e Madhe dhe Majën e Hullinit në njërën anë dhe Kabashin e Shkallën e Ribnicës në anën tjetër.

Prej aty përmes shtegut të paecur, por që natyra nuk e kishte prishur, vijuam drejt një Liqeni tjetër, poshtë së cilit ndodhej Llakqet e Gjipqve, ose Ciganski Premin siç e quajnë ndryshe.

Vërtet, për të kaluar më lehtë nga fshatrat e Rekës se Epërme drejt Lumës, do ishte ose nga Llakqet e Gjipqeve ose nga Skërteci, ku banorët kanë shfrytëzuar këto rrugë për tregti ose për rastin më të keq: emigrim. Nga kreshtat e Llakqet e Gjipqve, filloi të duket Perla e Dibrës, Liqeni i Gramës, që tashmë ishte afër.

Zbritja është e lehtë dhe përmes fushave pranë Gramës arrihet lehtë në Liqenin e Zonjave, një liqe afër liqenit të Gramës dhe më i vogël se ai, ku shumë burime lartë mbushin këtë symalor që mendohet se dikur janë larë edhe motrat e Skëndërbeut. Prej aty nisemi drejt Liqenit të Gramës me makinë, që është disa herë më i madh dhe që tashmë, uji i saj merret furnizimin me ujë të qytetit të Peshkopisë.

Kur vizitohet liqeni i Gramës, nuk ka sesi të mos ndalesh në një nga stanet e shumta, për të shijuar produktet natyrale të qumështit, për të vijuar plot freski ditën e nesërme në qytetet urbane ku pret puna.

EPILOG

Thuhet se në botimet e vjetra, për fshatrat e Rekës së Epërme ose Lumës, përmendet edhe legjenda, se anija e Pejgamberit Nuh alejhis selam është ndalë në Malin Korab, që nga rusishtja do të thotë Anije. Si fillim, ai ka parë malin plot me ngjyra të Sharrit, kurse më pas anija është përplasur dyherë në Kërçinin e Madh dhe Kërçinin e Vogël, duke bërë kërrk-kërrk, për t'u ankoruar së fundi në malin e Korabit.

Pavarësisht gojëdhënave, ky shteg mbresëlënës është mirë të vizitohet nga çdo kush që ka përgatitje të mire fizike, por natyrisht edhe guidë të mirë të ndonjë bariu që jeton gjatë verës në Korab dhe mbledh lule në lindje dhe perëndim të saj. Ky shteg mund të quhet edhe 'shtegu Durham-Strazimiri'.

Rruga e Arbërit nr. 200

guidë



10 rekomandime për të kaluar **10 ditë në Dibër të Madhe**

Nga **FITIM DIKA**

Shpesh diaspora e Dibrës e ka të vështirë të vijë në Dibër, veçanërisht kur ata qëndrojnë pas disa dekadash larg vendit të origjinës. Kanë ndryshuar shoqëri, punë, mentalitet dhe shpesh e kanë të vështirë të përshtaten me të renë që sjell koha. Kjo bëhet edhe më e vështirë për fëmijët e dibranëve që kanë lindur në 'vend të huaj'.

Gjithsesi, tani që është koha e ardhjes së frymëmarrjes së qytetit, siç i quajmë ne rëndom vëllezërit në SHBA dhe Europë, po mundohemi të rëndësim dhjetë arsye për të qëndruar së paku dhjetë ditë në Dibër, pasi edhe ata që vinë në vendlindje, shpesh pushimet i kalojnë në qytetet tjera si Strugë ose rivierën e Shqipërisë.

1. LIQENI I DIBRËS

Pasi ke parë farefisin më të afërt, takimi me miqtë do ishte ideale sikur të kalohej në kafeteritë e liqenit të Dibrës: Cami, Drilon, Perla, Dema.

Aty shijon kafja e mëngjesit, por edhe mbrëmja që çdo herë jep freski, qoftë edhe pas një dite zhegu.

Mund të lundroni edhe në liqen ose të kryeni kamping, gjithmonë nëse keni dëshirë shtesë për liqenin.

2. ROSOK, LAZAROPOLE, GARI

Me një veturë modeste, pas mëngjesit dhe kafes në qendër të qytetit, mund të niseni në një udhëtim ditor shumë të këndshëm gjelbëror.

Udhëtoni nga Dibra drejt fshatit Rosok, ku lehtë mund të shikoni ujin me të cilin furnizohet qyteti i origjinës suaj, nga aty mund të niseni me një kthim disa kilometra drejt Lazaropoles, ku gjatë verës ju mirëpret një hotel me furnizime modeste për të kaluar drekën.

Në kthim mund të ndaloni për një darkë më të bollshme në restorantin e Garit, që ndodhet në fund të fshatit ose edhe pranë Urës së Drerit, për të shijuar një peshk te restoranti i hapur kohëve të fundit.

Në këtë udhëtim mund të shijoni larjen





në Lumin e Vogël, që për disa miq tanë ka rezultuar tepër i suksesshëm në shërimin e reumantizmit.

3. MAVROVË, GALICNIK, UJËVARA E DUFIT

Një ditë tjetër mund të udhëtoni pak më gjatë, por edhe me një lartësi mbidetare më të lartë. Nga Dibra niseni drejt Liqenit të Mavrovës, ku kafeteritë buzë liqenit të japin mundësinë për të shijuar mëngjesin/drekën dhe kafen njëkohësisht, kurse më pas drejt gjarpërimit të rrugës me asfalt të niseni drejt Galiçnikut piktoresk, që gjatë verës ka plot restorante që shërbejnë djath cilësor dhe disa ushqime tradicionale maqedonase.

Në Galiçnik mund të ndaloni në kafenë Neda.

Në këtë udhëtim është mirë të ndalohet edhe të Ujëvara e Dufit, që ndodhet në fshatin Rostushë dhe ka një ecje prej 1km + 1km dhe të ofron pamjen e një mjedisi të shkëlqyer.

Në rast se keni veturë 4x4 mund të ktheni nga Galiçniku drejt Selcës dhe më pas drejt Dibrës, ose në rast se dëshironi mund të bëni një shëtitje malore rreth e qark Galiçnikut.

4. FSHATRAT TURQ TË QENDËR ZHUPËS.

Në anën jugore të Dibrës, ndodhen disa fshatra të ndryshëm nga fshatrat tjerë, pasi ata flasin turqisht dhe pranojnë origjinën e lashtë turke.

Nga Dibra përmes rrugës që të dërgon në Strugë, merrni majtas te hidrocentrali i Gllobocicës, pikërisht aty ku një tabelë e shtrembër shkruan për vendodhjen e Shtëpisë Muze të Gjyshërve të Ataturkut.

Në të tatëpjetën gjithmonë me asfalt, shikoni bukuri të rralla natyrore dhe plot çezma me ujë të freskët rrugës. Mund të ndaloni si fillim në fshatin Elga ose direkt në Novak e Koxhaxhik, ku me raste punojnë kafeteritë më bakllava dhe kafe turke. Komunikimi shpesh është i vështirë pasi në të dyja fshatrat mezi flasin gjuhë tjetër përveç turqishtes.

Nga Koxhaxhiku i Ataturkut dhe Kalasë së Sfetigradit, mund të vijoni drejt Qendër Zhupës, ku restoranti Atmir mund t'ju ofrojë një drekë me pleskavica ose stek pule.

Prej aty, nga Ballanca ktheheni në Dibër, ku liqeni i saj ju shoqëron vazhdimisht.

5. BROSHTICËN

Ndonjë ditë tjetër mund të vizitoni fshatin e lartë të Dibrës Broshticë, që përveç një kafe të lodhur në qendër të fshatit, ka edhe plot lëndina ku mund të ndaloni për një piknik në mes të rrugës nga Dibra drejt Broshticës.

Në rast se dëshironi një ngjitje te lehtë malore, mund të parkoni veturën në shkollën e Broshticës dhe të niseni me këmbë drejt Antenave të malit Stogovë.



6. ELEVCËN

Vend i këndshëm për Piknik është edhe fshati i pasur me ujë: Elevca. Po ashtu në këtë fshat mund të kryeni një ngjitje malore drejt "Tabllës" ku shpesh anash rrugëve keni dredhëza të egra ose të shkoni me taksi dhe më pas me këmbë të shkoni nga Elevca drejt Kosovrastit të Epërm.

Sido që të jetë, edhe qëndrimi gjatë gjithë ditës në Elevcë, është një ditë e shfrytëzuar mirë.

7. BANJAT E DIBRËS

Nuk duhet të largohet nga Dibra pa parë burimet termale të Kosovrastit dhe Banjishtit, kurse në Banjisht përveç banjave mund të shijoni edhe një ecejake të lehtë rreth fshatit ose nga Banjishti drejt Ames ose deri te Karaula e dikurshme e ushtrisë.

Banjishti të ofron freski ditore edhe në ditët më të nxehta, pasi restoranti është mes pishave të larta.

Udhëtimi përmes lëndinave nga Banjishti drejt Ames ka dredhëza të egra, aq të dashura për fëmijët dhe të rriturit.

8. DRENOK, MODRIC

Në rast se dëshironi një udhëtim pak më të panjohur, mund të vizitoni edhe fshatrat tjerë të Modricit dhe Drenokut, që vërtet janë të vendosura mes pyllit, por nuk të ofrojnë kushte, pasi kafeteritë dhe restorantet mungojnë.

Këtu mund të bleni disa peshq që kultivohen rreth lumit.

9. MYFTININË E DIBRËS

Pavarësisht historisë së begatë të Dibrës, një muze i kompletuar mungon. Për të parë sesi kanë jetuar gjyshërit tanë mund të vizitoni koleksionin e fotografive të vjetra që ndodhet brenda zyrave të Myftinisë Dibër. Aty mund të gjeni shpesh edhe miq të vjetër, ku hoxhallarët ju mirëpresin në çdo ditë dhe kohë brenda orarit të punës.

10. AVENTURA TË NDRYSHME

Në fund, në rast se keni dëshirë për një aventurë më mbresëlënëse, përmes personave që kanë fuoristrada 4x4 mund të vizitoni shumë vende tjera të begata si:

- Fushë Studen në Gollobërdë
- Cerenecin dhe Fushën e Gjoricës me ndalesë në restorantin Jeton
- Fshatin Sinë të Skënderbeut ose Liqenet e Lurës.
- Llixhat e Peshkopisë me ndalesë te restoranti i Izet Shulkut ose bujtina Nënë Dashuri në hyrje të qytetit ose Hotel Veri në qytet.
- Liqenin e Gramës në Korab
- Ngjitjen e Majës së Korabit 2764 nga Radomiri ose Strezimiri.
- Vizitat e fshatrave të Rekës së Epërme: Vërbjanin, Nistrovën, Krakornicën, rrugën Strezimir-Restelicë.
- Ngjitje Jance-Galicnik
- Rrugën e vjetër nga Gari në Izvor ose nga Gari në Zhitine.
- Rruga nga Spas në Shullan drejt Sollokiqit.

Por edhe për shumë udhëtime tjera të spikatura dhe që s'i gjen as edhe në vendet më të largëta të botës, mund të konsultoheni edhe me persona ose shoqata që njohin shumë mirë vendlindjen e tyrë si:

- Dibra off road 4x4,
- Shoqatën Alpiniste Nivishta ose KBC Dibra
- Pajtim Vranici nga Peshkopia ose Butrint Sela nga Dibra

Shënim: Ky shkrim është bërë gjatë një kërkese të shpejtë të një mikut të artikullshkruesit. Çdo shtim i tij për të mirën e turizmit në Dibër është i mirëpritur.

BUJTINAT MIKPRITËSE



BUJTINA KONAKU I DIBRËS
Vendndodhja: **Tomin** Tel: **0692053492**
E-mail: **aminasalkurti@gmail.com**



NËNA DASHURI AGROTURIZËM
Vendndodhja: **Peshkopi** Tel: **069 937 7337**
E-mail: **nenadashuri@gmail.com**



GUEST HOUSE SABRIU
Vendndodhja: **Rabdisht** Tel: **069 511 4003**
E-mail: **guesthousesabriu@gmail.com**



KULLA HUPI
Vendndodhja: **Dushaj, Bulqize**
Tel: **068 837 3793**
E-mail: **kullahupi5@gmail.com**



BUJTINA ARBRI
Vendndodhja: **Arras, Fushë-Çidhën**
Tel: **068 650 6061**
E-mail: **markuvladimir@yahoo.com**



GUESTHOUSE TERSHANA
Vendndodhja: **Peshkopi** Tel: **0218 20306**
E-mail: **bujtina.tershana@outlook.com**




BUJTINA GOLECI
Vendndodhja: **Rabdisht** Tel: **069 642 9888**
E-mail: **fitimgoleci1@gmail.com**

cyan magenta yelloë black

Rruga e Arbërit nr. 200

vendlindja



Fshati ka burime ujore të konsiderueshme, ndërsa arteria kryesore lumore është përroi i Balgjait, afro 9.2 km i gjatë, që buron nga liqenet akullnajore të sheshit të Balgjait.

Koçaj - fshati i vendosur mbi **një qytet misterioz** të varrosur

Katundi i qefalinjve dhe kampionëve të botës

Nga **ADRIATIK BALLA***

Në gjirin e Bulqizës së Vjetër ndodhet fshati Koçaj, i cili pozicionohet në të majtë të rrjedhjes së Zallit të Bulqizës. Ky fshat ka kufi perëndimor kurrizin e Balgjait, nëpërmjet të cilit ndahet nga pellgu i Matit. Në veri kufizohet me kreshtat magmatike të faqes së Thatinës, qafën e Helmes (ose Helmit) dhe gropat e Ukut pranë Gurit të Vashës, që e ndajnë me zonën e 4 Grykëve në Dibër. Në lindje kufizohet me fshatin Dushaj, në jug ka Fushë-Bulqizën e në jugperëndim kufizohet me fshatin Dragua. Brenda këtyre kufinjve, Koçaj ka një sipërfaqe 23 km katrorë, prej të cilëve 10 km katrorë janë fushorë e luginorë, e 13 km katrorë të tjerë janë malorë mbi 1 mijë metra lartësi. Territori i fshatit shtrihet nga 675 m (pranë shkollës 9-vjeçare) e deri në 2064 m në majën pranë qafës së Allamanit (kujtojmë që maja e Kreshtës 2101 m i përket Vajkalit e ajo e Gurrave të Zeza 2079 m i përket Dragunit). Vetë katundi Koçaj shtrihet nga 680 m në jug e deri në 940 m në veri në lagjen Shytaj.

Është fshat interesant, me reliev fushor, luginor, kodrinor e malor, me ekspozim formash të shumëllojshme, që diktohet nga përbërja litologjike e larmishme (magmatikë, gëlqerorë, flishe dhe natyrisht depozitime kuaternare) dhe tektodinamika e fuqishme. Elementët e tjerë fiziko-gjeografikë janë të ngjashëm me atë të zonës së Bulqizës në tërësi.

RRETH TOPONIMISË SË EMRIT "KOÇAJ"

Për toponimin "Koçaj" jepen dy variante të gojëdhënës, e për respekt të njerëzve po i paraqesim të dy. E para që është më e besueshme lidhet me faktin se Koço ishte djali i dytë i Stefan Dushos, atij që themeloi katundin Dushaj (për të cilin kemi folur, vëllai i parë ishte Çiro ose Qyro), kurse varianti i dytë e lidh këtë toponim me një banor të ardhur nga Korça, ikur nga hasmëritë, që i dha më pas emrin fshatit. Natyrisht, qëndron më fort varianti i parë, e për këtë ka shkruar mirë e bukur autori Ymer Keta në "Bulqiza e Bulqizakët", 2008.

Fshati Koçaj i sotëm shtrihet në dy lagje të mëdha. Së pari në kodër Koçaj, në pjesën lindore, pozicionuar mbi një kodër të përzgjatur JP-VL, që ka qenë bërthamë e këtij katundi, e lagjja tjetër e madhe është Kokërdhaku, një toponim mjaft i vjetër, i vendosur në një kon depozitimi me përmbajtje fluvioglaciale të përroit të Balgjait. Pra blloqet, poplat e zajet që ka sjellë ky përrua e që ka krijuar një kon të fuqishëm depozitimi, jo plotësisht i stabilizuar, mbi të cilin vendoset kjo lagje e që mban një pjesë të rëndësishme të fondit bujqësor të këtij katundi.

Koçaj është fshat i kontradiktave: sa i vjetër aq dhe i ri, sa i pasur aq dhe i varfër, sa i vogël aq dhe i madh, sa rural aq dhe urban.

Vendbanimi i parë e ndër më të vjetrit, prej kohësh që s'mbahen mend, në territorin e këtij fshati dhe pikërisht në pjesën e sipërme të Kokërdhakut, ka qenë qyteti i Xullinit, shqiptuar nga vendasit si Xullajni. Nuk kemi shumë të dhëna për këtë qytet, për shtrirjen dhe madhësinë e tij, nivelin e zhvillimit dhe rolin që kishte ai në prehistori e historinë antike. Natyrisht, nuk ka qenë qytet i madh dhe i njohur, por as këtë nuk e themi dot për sa kohë kanë munguar gërmimet arkeologjike. Shumë fshatarë, kur kanë bërë punimet e tyre në këtë lagje, kanë zbuluar mure të trashë gati 1 m, me qoshe të gdhendura e të latuara që janë tipike për vendbanimet antike, si dhe copëza qeramike, poçe, e deri sende argjendi, e që fatkeqësisht asnjëri nuk ua ka ditur vlerën e nuk kemi të ruajtur



ndonjë objekt. Por rrënojat e këtij qyteti janë ende aty, të varrosura e një ditë ndoshta do të "flasin". Mendohet se qyteti u shkatërrua nga një përmbytje apokaliptike, nga përroi i Balgjait, i cili i fryrë në ekstrem e mbuloi qytetin me depozitimet e tij. Për të përshkruar ndonjë fenomen natyror të frikshëm, vendasit përdorin shpesh shprehjen "po mësojmë si në kohën e Xullajnit". Do të ishte me interes të përgjithshëm të kishim gërmime arkeologjike në këtë vend dhe jam i bindur se do të kishim rezultate surprizuese.

Duke njohur zonën, morfologjinë e relievit dhe cilësitë e pellgut ujëmbledhës të përroit të Balgjait, gjykoj (dhe nuk duhet përjashtuar si mundësi), se shekuj më parë, ndoshta në antikitet, një nga liqenet akullnajore të Balgjait (që në atë kohë kanë qenë me përmasa shumë më të mëdha se sot), të ketë shpërthyer, duke marrë përpara gjithçka gjente dhe të ketë mbuluar qytezën antike. Është një hipotezë, por sa kohë nuk ka gërmime arkeologjike nuk e argumentojmë dot.

Po në këtë lagje, gjatë epokës së artë skënderbejane, kur kryetrimi arbëror fortifikoi mbretërinë e tij (1450-1465), në Kokërdhak u ndërtuan magazina të kohës për grumbullimin e produkteve bujqësore dhe që shërbenin si rezerva në shërbim të ushtrisë. Ky vend ishte zgjedhur me kujdes, pasi ishte i futur thellë dhe i mbrojtur, larg rrugës së karvanëve dhe larg mundësisë që të kapej nga turqit, si dhe për shkak se ndodhej me mundësi evakuimi nëpërmjet qafave malore drejt zonave të tjera.

Qafat janë shumë të rëndësishme për këtë katund, pasi ato e lidhin shpejt dhe sigurt me zona të tjera të Dibrës e të Matit, sikurse janë qafa e Helmes, qafa e Epërme, qafa e Allamanit, qafa e Kllogjit etj.

Majat kryesore malore janë ato të qafës së Allamanit (2064 m), kreshtës në kufi me liqenet e Kacnisë (2019 m), maja e Bataqes (1943.5 m), Maja e Rrumbullit 1941 m) etj.

BURIMET UJORE

Fshati ka burime ujore të konsiderueshme, ndërsa arteria kryesore lumore është përroi i Balgjait, afro 9.2 km i gjatë, që buron nga liqenet akullnajore të sheshit të Balgjait. Në krye të lagjes Kokërdhak bashkohet me përroin e Sheshit të vogël dhe atë të Shytajt, e më në jug merr emrin përroi i Zallit të Thatë, deri sa derdhet në Zallin e Bulqizës, me një prurje mesatare shumëvjeçare, afro 0.4 m3/s, por me luhatje të madhe gjatë stinëve dhe me një karakter torrencial të shprehur për shkak të disniveleve të mëdha të relievit nga grykëderdhja e deri në kreshtat malore (mbi 1200 m). Është meritë e këtij përroi, krahas cilësive tektonike e tipareve të strukturave



Tre kampionët, Ismail, Gjetan dhe Ferit Keta. Foto: Arben Bici.



në përgjithësi, që lugina e Bulqizës në këtë sektor arrin gjerësinë 3 km.

GJEOLOGJIA

Sa i takon gjeologjisë, sektori perëndimor i fshatit që i përket masivit të Balgjait ndërtohet tërësisht nga magmatikët ultrabazikë të Jurës, kurse në lindje të zallit dominojnë gëlqerorët triasikë dhe një brez flishor me drejtim afro veri-jug. Kontakti i tyre është tektonik dhe brezi i shkatërrimit është shfrytëzuar nga rrjedhja ujore që ka krijuar përroin e Shytajve e në vazhdim atë të Zallit të Thatë. Në fund-vitet 80-të të shekullit të kaluar, në masivin magmatik të Balgjait ka punuar Gjeologjia dhe Gjeofizika, sepse ky mal ka rezerva të konsiderueshme kromi, natyrisht jo si në Dhoks.

RESHJET

Sikurse në të gjithë zonën e Bulqizës, bien mesatarisht 1000-1100 mm reshje në vit. Ndërkohë, bora është fenomen i zakonshëm në këto anë dhe trashësia e saj shkon deri në 50 cm e në raste të veçanta 1 m, madje në lartësitë e mëdha të relievit afro 1.5 m.

TOKAT DHE BIMËSIA

Tokat janë aluvionale në Kokërdhak (kryesisht) dhe të kafenjta në Kodër Koçe. Bimësia është e pasur, me dushqe, shkozë e mëllezë deri në 1200 m, një brez ahishtesh i zhvilluar mirë e në areale të veçantë (sikurse është pella e madhe) në gjendje klimaksi, në lartësinë deri në 1700-1800 m. Ky brez ka ndërthurje me pishë, arn dhe bredh në sektorin e Balgjait, e mbi këto lartësi spikasin kullotat alpine me bimësi të familjeve graminore e leguminose. Sektori fushor e kodrinor është i kthyer në tokë bujqësore.

Mjedisi, pavarësisht dëmtimeve jo të pakta në pyje, paraqitet i ruajtur relativisht mirë. Ky mjedis i pastër dhe i vyer çmohet shumë dhe mbrohet me fanatizëm nga banorët e fshatit.

PAK HISTORIK

Koçaj arritën si katund një pjekuri të konsiderueshme aty nga viti 1800, duke marrë edhe prioritetin në Bulqizën e Vjetër. Nga dokumenti arkivor i vitit 1834, ku jepen me emra pleqtë e Bulqizës, nga ky fshat spikasin dy burra me emrat Bajram Fera dhe Fejzë Xhobi. Nga osmanishtja ne dimë që "C" lexohet Xh dhe "b" është zëvendësim i

turizëm

Shumë fshatarë, kur kanë bërë punimet e tyre në këtë lagje, kanë zbuluar mure të trashë gati 1 m, me qoshe të gdhendura e të latuara që janë tipike për vendbanimet antike, si dhe copëza qeramike, poçe, e deri sende argjendi, e që fatkeqësisht asnjëri nuk ua ka ditur vlerën e nuk kemi të ruajtur ndonjë objekt. Por rrënojat e këtij qyteti janë ende aty, të varrosura e një ditë ndoshta do të "flasin".



Hartat topografike japin 9 liqene akullnajore në Sheshin e Balgjait. Gjatë një ekspedite në terren më datë 3 korrik 2021 dhe hasa me ujë vetëm dy prej tyre, njëri mbuluar nga bimësia dhe me vetëm 10-15 cm ujë, e tjetri me thellësi deri në 1 m, i qëndrueshëm dhe me sipërfaqe 0.3 hektarë, e ku në orën 9 të mëngjesit "na përshëndeti" specia karakteristike e liqeneve akullnajore, pra tritoni apin.

"h". E thënë ndryshe, ky anëtar i pleqësisë e ka pasur emrin Fejzë upi. Për emrin tjetër, Bajram Fera, mendimi im është ky: Për vitin kur bëhet fjalë, i parë në këtë fshat ka qenë Bajram Karaj, e nuk e di për ç'arsye është regjistruar Fera. Pra kemi të bëjmë me Bajram Karajin. Ky person ka qenë qefali i Bulqizës, pra një lloj kryeplaku, administrator i zonës. Përplasjet e Teqesë së Madhe me Baba Fejzën e pozicionuan qefaliun në krah të Teqes së Madhe dhe kjo përplasje në ato vite ka qenë e fortë. Babai u plagos dhe u arrestua në betejën e Xixullës në Martanesh. Për ta turpëruar turqit e vunë së prapthi mbi kalë, por gjesti ishte shumë i rëndë. Këtë veprim e përjetoi shumë djaloshi Dalip Karaji, i cili më vonë u bë qefali dhe një nga patriotët më të mëdhenj të zonës, njeri që pati influencë jo vetëm në Bulqizë por në mbarë Dibrën, duke dhënë kontribut në Lidhjen e Prizrenit e më pas në kryengritjet para pavarësisë.

Pra Karaj ishin qefalinjtë e Bulqizës. Nga kjo derë e shkëlqyer kanë dalë mendje të zgjuara, njerëz me kontribute në shoqëri e në sektorë të ndryshëm shtetërorë, si ushtarakë, mësues, inxhinierë, ekonomistë, juristë etj.

Në këtë fshat, janë organizuar edhe kuvende të rëndësishëm, me pjesëmarrje deri në 500 vetë, që ishte shumë për kohën (1832, 1844, 1856 etj), si tek qarri i Damës, Mani i Koxhajve, Mulliri i Bardhë etj, kryesisht organizuar nga Baba Fejze Bulqiza.

Në Vjetarin Statistikor të Teki Selenicës, siç e kemi përmendur edhe në numrat e tjerë, fshatrat e Bulqizës figurojnë si një i vetëm, me emrin Bulqizë, në nënprefekturën e Zerqanit, me 2500 banorë. Por regjistrim më i saktë është ai i vitit 1916 nga austriakët, ku Koçaj përfshiheshin si lagje e fshatit Komaj, e çuditërisht Komaj përkon me një lagje të fshatit Dushaj (Kome quhet edhe sot). Në këtë regjistrim mësojmë se:

Në krahinën e Sheh Hysenajt (sot Zerqani), bënte pjesë edhe fshati Komaj me lagjet Dragonaj (Dragu), Koçaj dhe Kokerlakaj (Kokërdhak). Ky fshat regjistrohet me 116 shtëpi, me 121 familje e një popullsi 647 banorë, prej të cilëve 6 vetë nuk merren me punë fshati (domethënë bënin punë tjetër si ushtarak, tregti ose tjetër).

Në kohën e mbretërisë, Koçaj ishte fshati kryesor në Bulqizë, për shkak të influencës së disa personazheve të rëndësishëm të kohës që punonin oficerë në qeverinë e Zogut.

Ky fshat dha një kontribut të çmuar gjatë LANC-it. Nga ky fshat ishte, ndër të tjerë, dëshmori Asllan Keta, një nga eksponentët kryesorë të etës partizane të Haxhi Lleshit. Po nga ky fshat, Ali Lika, ra në luftime gjatë provokacioneve greke të gushtit 1949 në zonën e Korçës (nuk e di a i njihet statusi Dëshmor i Atdheut).

POPULLSIA

Pas vitit 1945 Koçaj shfaqet si fshat i dallueshëm qartë, me dy lagjet e tij, si pjesë përbërëse e rrethit të Dibrës, e pas vitit 1990 si pjesë e komunës Fushë-Bulqizë të Bashkisë Bulqizë.



Në vitin 2007 katundi Koçaj kishte 197 familje, me gjithsej 709 banorë. Natyrisht, në këtë moment që flasim ky fshat ka humbur gati gjysmën e popullsisë së tij. Dy dekada më parë, në komunë kishte të regjistruar 122 hektarë tokë arë dhe 12 hektarë pemëtore, por të dhënat e komunave duhen marrë me rezervë. Kultivohen misri, gruri, perimet, por edhe frutat si mollë, gështenja, kumbulla etj.

OBJEKTET NATYRORE DHE KULTURORE TË RËNDËSISHME

Qyteti i varrosur i Xullinit, për të cilin duhet të ketë iniciativa për gërmime arkeologjike, disa ndërtesa tip kulle, njëra prej të cilave figuron si monument kulture e që me shumë gjasë është e paraqitur si pullë postare në vitin 1982 (shih pullën ilustruese të këtij shkrimi), liqenet akullnajore në Balgjai, kompleksi i cirqeve po në lartësitë e Balgjait që janë nga më të mëdhenjtë në Shqipëri, Gurra e Ftohtë, Vallja e Shkëmbit, disa teqe, etj. Hartat topografike japin 9 liqene akullnajore në Sheshin e Balgjait. Gjatë një ekspedite në terren më datë 3 korrik 2021 dhe hasa me ujë vetëm dy prej tyre, njëri mbuluar nga bimësia dhe me vetëm 10-15 cm ujë, e tjetri me thellësi deri në 1 m, i qëndrueshëm dhe me sipërfaqe 0.3 hektarë, e ku në orën 9 të mëngjesit "na përshëndeti" specia karakteristike e liqeneve akullnajore, pra tritoni apin (shih foton).



Ajo që nuk kemi mundur deri tani që t'i japim shpjegim, është "Shkëmbi i Kulturës" në anën lindore të fshatit. Nga vjen ky toponim, për më tepër në në një zonë që s'ka shtëpi afër, që nuk kultivohet, e as ka ndonjë shenjë që aty mund të jenë luajtur shfaqje teatrale apo të jenë vënë në skenë këngë e valle. Kjo është një enigmë që kërkon analizë të kujdesshme në të ardhmen.

Lehtësia e arritjes me rrugë automobilistike që në vitet 90-të i ka dhënë këtij fshati përparësi, sikurse afërsia me qendrën e njësisë administrative dhe me shkollën 9-vjeçare dhe të mesme, por problemi i viteve të fundit, ashtu siç po ndodh me shumë zona të vendit, është emigracioni në nivele të larta.

FSHAT ME NJERËZ PUNËTORË E BUJARË

Koçaj është fshat me njerëz punëtorë, bujarë dhe të shkolluar. Nga ky fshat kanë dalë arsimtarë të spikatur ku, për kontributin e tyre në arsimin bazë, dua të veçoj dy burra, Xhemal Karajin dhe Hasan Daxhën. Në fushën e letrave duhet përmendur Aqif Karaj (Qytetar Nderi i Bulqizës), me botimin e tij "Bulqiza, teqe e lapidar", 2007, si dhe "Bulqiza në udhën e historisë", 2009, por edhe autorë të tjerë.

Ky fshat ka nxjerrë agronomë të mirë, veterinerë, mjeshtra të ndërtimit, muzikantë, inxhinierë, profesorë, personalitete të ushtrisë, pilotë, biznesmenë etj.

Koçaj, sikurse të gjithë fshatrat e Bulqizës, ka qenë baza e punëtorisë e minierës së kromit, e vetëm nga ky fshat, kanë humbur jetën dhe kanë vdekur në aksidentet minerare mbi e nëntokë, 15 vetë, pasqyruar emër për emër në librin "Heronjtë e nëntokës" të Ymer Ketës, 2013.

Jo më kot i lashë në fund, tamam si ëmbëlsira, nga ky fshat kemi tre kampiona bote, pikërisht vëllezërit Keta. Ismaili ka dalë tre herë kampion bote në kik-boks, Gjetani, i mbiquajtur "Tajsoni i Bardhë" është kampion i madh, si dhe Feriti, kampion bote në kik-boks më 2021 dhe i pamposhtur deri më tani ne ring. Këta janë kampionë në ring por edhe në jetë, pasi kanë ndihmuar njerëzit në nevojë, por edhe komunitetin bulqizak në tërësi, duke dëshmuar shpirtmadhësi.

** Adriatik BALLA është Doktor i Shkencave Gjeografike*

LIBRA



XHAFER MARTINI

Eseistika e Kadaresë

Botimet M&B
ISBN 978-9928-387-46-2

Libri "Eseistika e Kadaresë" është një vështrim kritik mbi esetë "Legjenda e legjendave", "Kushëriri i engjëjve", "Ra ky mort dhe u pamë" dhe "Ardhja e Migjenit në Letërsinë shqipe"

Çmimi: 800 lekë



MUNIR SHEHU

Në gjurmë të këngës dibrane

Këngë e balada, epikë historike e lirika
Përgatiti për botim: Mirdash Shehu
ISBN: 978-9928-387-33-2

Botimi i këtij libri me balada, epikë historike e lirika popullore të mbledhura nga Munir Shehu, përbën një moment të rëndësishëm për kulturën dhe etnokulturën e Dibrës, por nisur nga ajo se çfarë vetë Dibra përfaqëson në kulturën shqiptare, ky libër është një pasuri me vlerë të veçantë që i shtohet thesarit të kulturës popullore kombëtare. Këngët e botuara në këtë vëllim shoqërohen edhe me një shpjegim, i cili flet shkurtimisht për personazhet dhe kohën kur kanë ndodhur ngjarjet, pra për historinë e këngëve. Autori ishte një mbështetës i mendimit se edhe këngët e popullit duhet të pranohen e të merren si dokumente historike, prandaj paraqitja e tyre me data i shërbente edhe historisë por edhe mbledhësit.

Shumica e këngëve të këtij vëllimi botohen në disa variante, - siç i ka mbledhur autori, si dhe me vijën melodike të shkruar po prej autoit.

Çmimi: 1500 lekë

Vera – stina e zjarreve dhe njeriu pa "Zot"

Nga prof. Bajram XHAFA

Njëherë Sulejmani a.s. (alias Solomoni) e kishte nxjerrë popullin për të bërë duanë e shiut. Atje ishte një milingonë e cila bënte dua dhe lutej në këtë mënyrë: "O All-llahu im! Unë jam një krijesë nga krijesat e Tua. Edhe po të na vadisësh me shiun tend, edhe po të na shkatërrosh me thatësirën tënde, ne përsëri jemi nevojtarë për rriskun tend…".

Pasi e dëgjoi këtë, Sulejmani a.s. iu drejtua popullit duke i thënë: "Kthehuni mbrapsht. Patjetër që juve ju dërgua shi me anë të duasë së dikujt tjetër (milingonës). Të bindur se duaja e tyre para Zotit Xh Sh, ashtu siç u kuptua nga Hazreti Sulejman, është njëllojë e vlefshme sa dhe ajo e milingonës, u kthyen. Dhe ashtu ngjau.

* * *

Një pasdite gushti të 2021, nga Shkodra shkova familjarisht për të pirë një kafe në Velipojë, për t'i bërë "ibadet" votrës sonë familjare. Në kthim për Shkodër, aty në buzëmbrëmje, që nga makina vura re se në kodrat e Velipojës përballë nesh, një vatër tymi, e cila shpejt u shndërrua në zjarr. Pastaj një vatër e dytë e më pas një e tretë. Midis gjelbrimit të dendur të pyllit tre vatra zjarri. Zjarri i sapovënë dukej qartë se ishte dora e njeriut.

Para se të niseshim, në televizor pamë një kronikë për zjarret që kanë pushtuar botën dhe lindi një diskutim. Djali im, i cili ka një shkollim juridik dhe ndjeshmëri të lartë për të drejtën thoshte me një shpirt revolte se këta që vënë zjarrin duhen dënuar jo vetëm për djegien e pyllit, por dhe si kriminelë për masakrat ndaj gjallnesave të tij. Krimi është i shumëfishtë. Kafshët e pyllit nuk mund të orientohen në përpjekjen për t'i shpëtuar rrezikut të shfarosjes. Në gjuhën gazetareske thuhet se nga zjarret prishet ekuilibri biologjik, ekosistemi i natyrës etj etj. të cilat janë terma abstrakte dhe kështu ulet shumë ndjeshmëria dhe përgjegjshmëria njerëzore për dëmet nga zjarret dhe e pasojat e tyre.

Pikërisht në mugëtirën e mbrëmjes, kur gjallnesat e Zotit, të ngopura apo të pangopura, struken në folezën e tyre, në habitatin e vet bashkë me të vegjëlit e tyre, rrethuar me dashurinë që edhe atyre ua fal Zoti Bujar, i

Pikërisht në mugëtirën e mbrëmjes, kur gjallnesat e Zotit, të ngopura apo të pangopura, struken në folezën e tyre, në habitatin e vet bashkë me të vegjëlit e tyre, rrethuar me dashurinë që edhe atyre ua fal Zoti Bujar, i dorëzohen natës në qetësinë e saj. Dremisin a rënkojnë, kuisin a lëngojnë, luten e falen sipas mënyrës së tyre duke marrë e dhënë sinjale që njerëzit nuk i kuptojnë.

dorëzohen natës në qetësinë e saj. Dremisin a rënkojnë, kuisin a lëngojnë, luten e falen sipas mënyrës së tyre duke marrë e dhënë sinjale që njerëzit nuk i kuptojnë. Në suren Ihlas, ajeti 2, Allahu urdhnon e thotë: Allahu është Absoluti, të Cilit i përgjërohet gjithçka në amëshim (çdo krijesë i drejtohet, i mbështetet Atij) për çdo nevojë, dhe,... "Kërkoj mbështetje te Zoti i Agimit, që të më mbrojë nga sherri i natës, kur kaplon terri (Felek-3).

Kështu ndodh si me organizmat e vogla: thneglat, bubrrecat, bubajgat, fluturat, karkalecat, zogjtë e deri me ujkun dhe ariun që ndjehet i plotfuqishëm e sovran në strofullën e tij. Kur papritmas, në stroful ia beh një avull i nxehtë e më pas flaka përveluese e zjarrit, të gjitha këta e shohin veten të rrethuar nga një armik që nuk i ikin dot. Së pari gjallnesat lëshohen në mbrojtje të klyshve e të zogjve të sapolindur, por flaka nuk u jep kohë dhe mundësi, i kap paniku kur shohin fundin e tyre tragjik, klithin, ulërasin, rënkojnë, mallkojnë për gjëmën, gjëmëtarin, shkaktarin. Ariun që ndjehej më i sigurtë e më i plotëfuqishëm, kur flaka fillon t'i lëpihet pas lëkurës me leshin e saj të ashpër e të dendur, braktis këlyshët e vet dhe e pushton tërbimi. Atëherë lëshon drejt qiellit një klithmë të fuqishme gjëmimtare mallkimi për t'i thënë Zotit se ç'farë po bëhej me të. Mallkimi është në adresë të njeriut. I Plotëfuqishmi e dëgjon njëlloj, si mallkimin e milingonës, ashtu edhe për atë të ariut. Ashtu siç dëgjoi duanë e shiut të milingonës kur e pa Hazreti Sulejman, ashtu dëgjon edhe mallkimin për ata që mbi ta lëshuan zjarrin. Melekët e Allahut regjistrojnë me përpikmëri çdo gjë.

Megjithë flakët e nxehta e përvëluese që kanë përfshirë globin, kronikat televizive janë të ftohta dhe me sens ateist. Njeriu është bërë "bishë" e përtej bishës. "...Ruajuni zjarrit, lëndë e të cilit janë njerëzit dhe gurët, që është i përgatitur për mosbesimtarët" (Bekare, 24). Kur Zoti u tha engjëjve: "Unë do të krijoj një mëkëmbës (që do të zbatojë ligjet e Zotit) në tokë", ata thanë: "A do të vësh atje dikë që do të bëjë çrregullime e do të derdhë gjak në të, ndërkohë që Ne të madhërojmë, të lavdërojmë dhe të lartësojmë ashtu si të takon Ty?!". Ai tha: "Unë di atë që ju nuk e dini" (Bekare – 30). Mëkëmbësi që caktoi në tokë Zoti Xh. Sh. ishte njeriu.

"Ska gjë mbi dhé që nuk tregon mjerimin e njeriut dhe njëkohësisht edhe mëshirën e Zotit; sa pafuqinë e njeriut pa Zot, aq edhe fuqinë e njeriut me Zot", shkruan kimisti francez Blaise Pascal (1623-1662). Zjarret i vënë vetëm "njerëzit pa Zot". Ata kanë "trimërinë" dhe papërgjegjësinë.

Edhe Albert Einstein në një mbledhje shkenctarësh në Shtutgart më 1948 ka thënë: "Problemi i vërtetë qendron në zemrën dhe në mendjen e njeriut. Ajo që ne na tremb, nuk është fuqia e eksplodimit të bombës atomike, por fuqia e ligësisë së zemrës së njeriut, fuqia eksplozive e saj për të keqen. Në emrin e Zotit, (në arabisht: = "Bismilahi") nëse ju ATIJ i besoni, merreni ju ATË me seriozitet, zotëroni dhe zbutni zbulimet shkencore; nëse jo, ne jemi të humbur". Fuqia e ligësisë së zemrës së njeriut, fuqia eksplozive e saj në të keqen është në limitet e katastrofës planetare. Me këtë revan që ka marrë njeriu "pa Zot", një ditë do të gjendet një "i krisur" që ta shkrepi edhe makanizmin e bombës nukleare, sepse atë sekret tashmë e kanë në dorë shumë duar dhe nuk është e vështirë të përgatitet edhe një alibi për krimin e parë e ka e bërë "dikush tjetër". Në fakt, punën e bombës atomike po e kryejnë njerëzit me zjarret që po i venë planetit.

Tashmë çdo verë zjarret u bënë rituale të zakonshme. Vera e vitit 2023 qe kampione. Jemi në fund të gushtit 2023. Zjarret vazhdojnë shkrumbojnë e të përzhisin glogin. U dogj edhe Kanadaja (dhe vazhdon të digjet) që mbushi atmosferën me tymrat dhe gazrat e helmatisur. SHBA – ja po e po, si çdo vit. Edhe ishujt Havaj mes Oqeanit të Madh u shkrumbuan. Spanja, Greqia e "Zotit" sivjet la nam me zjarret. U tha se mbi 80 % e tyre ishin të vëna nga dora e njeriut.

Mirë se ne shqiptarët po korrim frutet e ateizmit e të shejtanërisë dhe nuk kemi frikë as nga Zoti dhe as nga mbreti, por grekët e kulturuar e besimtarë të fortë të "Jezusit" pse nuk frenohen ndopak nga mëshira ndaj gjallnesave të pavetëdijshme dhe ndaj viktimave besimtare. "O populli im, ç'është kjo, unë ju thërras në shpëtim, ndërsa ju më thërrisni në zjarr?! (Kuran, El-Gaâfir – 41).

Im atë "rahmet pastë", ishte punëtor i madh. Pak, edhe tamahqar. Dikur ishte zakon që drutë e dimrit t'i siguronim pasi mblidhej vjeshta, kryheshin edhe dasmat dhe njerëzit futeshin në dimër. Punët bëheshin me rend e me sirá. Por baba im ndërroi rendin, mbase imitoi "lëvizjet revolucionare. Filloi t'i bëjë drutë qysh në pranverë. Grumbullonte kërcunj e dru në një anë të avllisë dhe priste dimrin serbes. - O njeri (në Dibër gratë nuk i thërrasin burrat në emër), ndërhynte nana me një llojë zemërate të përmbajtur! Mos i pre drutë tash në pranverë kur ata çelin, shpërthejnë llastarë e lëngëzojnë se ngarkohesh me gjynah. Edhe bimët qajnë si njerëzit, do të të shpjakin (paralizojnë). Ç'do punë ka vaktin e vet, o njeri.

Kur engjelli i asaj dynjaje ia dërgoi selamet, im atë e gjykoi si të padobishme atë praktikë për sigurimin e druve. Vëllau porositi një makinë dru, të cilat i sollën në oborr. – Më mbani pak për krahësh dhe më nxirrni në oborr t'i shohë pak ato dru. Kur i pa trupat e ahut të sharruar bukur që mund të çaheshin lehtësiht e të gatshëm për tu future në sobë, pati një refleksion të dhimbshëm: - Ah, paska qenë gabim. Siç duket iu kujtua fjala e urtë turke "Tamaqari, çuk zarari", e përdorur edhe në Dibër. Apo ndoshta ajo shprehja tjetër orientale, aq e bukur dhe e saktë: "Pak tamah, shumë zian, shumë tamah, krejt viran".

Virani më i madh dhe më i rrezikshëm për njeriun është "njeriu pa Zot", siç u bënë shqiptarët ateistë, "zotat e rrejshëm", qafirët e kriptobesimtarët që me aq mendjelehësi i vënë zjarrin planetit.

Shkodër, 20. 08. 2023

Policia në aksion kundër prejes së pyjeve dhe zjarrëvënësve

Një 65-vjeçar është arrestuar në fshatin Çidhën të Dibrës në mes të gushtit me akuzën e zjarrvënies. Ai u kishte vënë zjarrin disa shkurreve në tokën e tij, por zjarri doli jashtë kontrollit dhe dogji mbi 2 hektarë tokë të fshatit.

U desh ndërhyrja e zjarrfikseve që zjarret të shuhen.

Prefekti i Dibrës, Nexhbedin Shehu, i tha në fillim të muajit televizionit Mat TV se "qarku i Dibrës në sezon veror ka pasur një bilanc të ulët të dëmeve të shkaktuara nga zjarret".

Sipas tij, "ndryshe nga disa qarqe të tjera të vendit tonë, në Qarkun Dibër zjarret kanë qenë sporadike gjatë këtyre muajve të nxehtë, por falë reagimit në kohë të strukturave për mbrojtjen e pyjeve është arritur që pasojat të jenë minimale".

Ndërkohë, strukturat e ligjit kanë pasur në vëmendje edhe dëmtimete pyjeve nga prerja pa kriter. Në fillim të gushtit, në Bulqizë janë arestuar tre persona, që janë kapur në flagrancë duke prerë pyjet afër Liqenit të Zi në Zerqan. Policia ka shpallur në kërkim edhe dy shtetas të tjerë, ndërsa u janë sekuestruar mjetet me cilat transportonin lëndën drusore.



"Si rezultat i monitorimit të vazhdueshëm të zonave të mbrojtura, në të gjithë qarkun, me qëllim parandalimin dhe goditjen e krimeve kundër mjedisit, si dhe me mbështetjen e inteligjencës policore, Strukturat Hetimore të DVP Dibër në bashkëpunim me shërbimet e Komisariatit të Policisë Bulqizë kanë organizuar dhe finalizuar operacionin policor të koduar "Shtegu". Në kuadër të këtij operacioni, Policia mbajti në vëzhgim territorin e zonës së mbrojtur "Liqeni i Zi", dhe si rezultat konstatoi dhe goditi një rast të krimeve kundër mjedisit, që kryhej në këtë zonë, në mënyrë të organizuar nga disa shtetas", njoftoi përmes një deklarate policia e Dibrës.

Njoftim për shoqata dhe organizata joqeveritare

Redaksia e gazetës vendos në dispozicion të shoqatave me fokus Dibrën dhe organizatave joqeveritare hapsira për botimin e veprimtarive apo studimeve të tyre. Redaksia vendos staf që ju ndihmon në shkrimin e kronikave, reportazheve, fotografive dhe teksteve të ndryshme për publikim në media dhe rrjetet sociale etj.

Tarifat e botimit për shoqata dhe OJQ-të janë me kostot e botimit.

Për më shumë informacion telefononi në numrin **0692068603**

ose shkruani emailit:

rrugaearberit@gmail.com

recensë

Grishja e autorit: Bëjeni rrugën për tek e Vërteta! Sepse ky është qëndrim intelektual. Dhe patriotik. Sidomos për rininë.

"Po Demokracisë, Jo Demokraturës", libri i ri publicistik i prof. dr. Ahmet Kamberit

Nga prof. HAJRI SHEHU

"Po demokracisë, jo demokraturës" është libri i dytë i prof. dr. Ahmet Kamberit. Libri i parë është "Pacienti ynë i veçantë". Në këtë libër janë tubuar 20 artikuj. Ata zënë 355 faqe. Librit i paraprin parathënia e autorit – e thukët, e ëmbël, grishëse. "Gjykimi është juaji, i dashur lexues, por unë ju jam mirënjohës, mjafton që ta lexoni", - thotë autori. Po ta përkthenim grishjen e autorit, ajo do të ishte: Bëjeni rrugën për tek e Vërteta! Sepse ky është qëndrim intelektual. Dhe patriotik. Sidomos për rininë.


Libri është botuar nga shtëpia botuese M&B, Tiranë, 2023. Autori, prof. dr. Ahmet Kamberi është i njohur kombëtarisht. Por për ndonjë lexues të ri, jetëshkrimi i prof. dr. Ahmet Kamberit është në mënyrë të përmbledhur në kapakun e librit.

Prof. dr. Ahmet Kamberi shkruan si publicist e si politolog. Por edhe si historian e si studiues. Edhe si mjek e si qytetar. Edhe si atdhetar e Shqipëridashës. Artikujt e përfshirë në këtë vëllim rrokin tema të ndryshme, por ata plotësojnë njëri-tjetrin. Po t'i komentonin, për secilin do të duhej nga një libër më vete. Thelbi është një: Demokratura nuk është demokraci.

Nëpër një pikë kalon vetëm një vijë e drejtë, - thotë gjeometria. Vijat e tjera janë të shtrembra. Dhe atëherë, asgjë nuk mund të jetë edhe kështu, edhe ashtu. As demokracia. Demokracia funksionon si sistem rregullash e ligjesh të bazuara në parimet e drejtësisë, të garantuara nga institucionet përkatëse. Kjo është demokracia, - argumenton autori. Kjo është vija e drejtë e demokracisë. Kjo demokraci nuk ekziston në Shqipëri. Në Shqipëri ka demokraturë. Demokratura është demokraci në formë dhe diktaturë në përmbajtje.

Demokracia ka kulturën e vet politike. Por cila është kjo kulturë në Shqipëri ? Autori thotë: « Ne kemi të bëjmë me një kulturë politike *sui generis* (e llojit të vet – H.Sh.), të mbrapshtë, degraduese, pseudodemokratike. Karakteristika themelore e kësaj kulture politike *sui generis*, të mbrapshtë, degraduese, pseudodemokratike është arti i mashtrimit, manipulimit e përdorimit të popullit Sovran për të garantuar "demokracinë(!)" e sundimtarit "sovran(!)", të "kryetarëve të gjithëfuqishëm", të politikanëve të diskredituar të riciklueshëm, të politikanëve të vetëshpallur "të nevojshëm" a "të pazëvendësueshëm", të politikanëve sahanlëpirës dhe të përfituesve që i mbajnë ata gjallë. Kësaj kulture politike sui generis, të mbrapshtë, degraduese, pseudodemokratike nuk i shërbejnë vetëm deputetët e Kuvendit të Shqipërisë, të zgjedhur me "votim të lirë, të ndershëm e të drejtë(!)", nuk i shërbejnë edhe ndërkombëtarët qejfmosprishës, sehirxhinj, cinikë e midis tyre - edhe qëllimkëqij, por i shërbejnë batalione medieje, profesorë, shkrimtarë, artistë, mësues e drejtorë shkollash. Kësaj kulture politike sui generis, të mbrapshtë, degraduese, pseudodemokratike i shërbejmë të gjithë ne që kemi sy të shikojmë, kemi veshë të dëgjojmë, kemi mendje të mendojmë, kemi gojë të flasim dhe kemi penë të shkruajmë, që bëjmë muhabet përditë në tavolina, që përbëjmë shumicën dërrmuese, por që nuk shpërthejmë së bashku me një zë të fuqishëm buçitës për ta demaskuar, stigmatizuar e shpartalluar atë. Kjo është një kulturë politike që duhet asgjësuar".

Demokracia nuk vjen me dhunë e vandalizma. Në Shqipëri erdhi me dhunë e vandalizma. "Politikanëve dhe drejtuesve të rinj që morën drejtimin e përmbysjes së madhe, - thotë autori, - u nevojitej mbështetja e të mundurve dhe e çdo kundërshtari të socializmit, e çdo të pakënaquri, spekulatori a dredhabishtësi ... Paraqitja e tyre si "antikomuniste" të flaktë u vlente për të fituar besimin e jashtëm dhe të brendshëm. Si prova më bindëse për këtë u gjet nxitja dhe mbështetja për të prishur dhe zhdukur çdo gjurmë të Luftës Nacionalçlirimtare dhe të periudhës së socializmit. Sulmi, që në të vërtetë qe një barbari e vandalizëm, u ndërsye dhe u lëshua mbi monumentet e Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare dhe gjithë infrastrukturën "komuniste": hekurudha, fabrika, uzina, kombinate, miniera, ndërmarrje bujqësore, kooperativa bujqësore, kanale ujitëse, plantacione drurësh frutorë, prita mbrojtëse lumenjsh, termocentrale elektrike, muze lokalë e qendrorë, shtëpi kulture, biblioteka, qendra shëndetësore në çdo fshat të Shqipërisë".



Rreth autorit:

Ahmet Kamberi është mjek specialist kardiolog, diabetolog dhe për sëmundje të brendshme, profesor.

U lind në Peladhi, rrethi Bulqizë, më 13 gusht 1940. Mbaroi Fakultetin e Mjekësisë të Universitetit Shtetëror të Tiranës në korrik 1961. Punoi 10 vjet në Peshkopi. U specializua për sëmundje të brendshme në Spitalin Klinik Nr. 1, Tiranë, për kujdesin koronar intensiv në Stokholm, Suedi dhe për diabetologji në Paris, Francë. Punoi si kardiolog dhe nëndrejtor i Klinikës Speciale, Tiranë. Punoi si kardiolog e diabetolog në ekipin mjekësor të Enver Hoxhës. Drejtor i Klinikës Speciale, ministër i Shëndetësisë dhe kryetar i Komisionit Shtetëror të Mbrojtjes së Mjedisit, nënpresident i Komitetit të 39 të OBSH-së për Rajonin e Evropës, Paris 1989. Deputet në Kuvendin e Shqipërisë dhe kryetar i Komisionit për të drejtat e njeriut e pakicave etnike, profesor në Fakultetin e Mjekësisë, Tiranë, themelues i Revistës Shqiptare të Kardiologjisë, President i Shoqatës Shqiptare të Kardiologjisë, anëtar i Shoqatës Evropiane të Kardiologjisë (ESC) dhe koordinator i saj për Shqipërinë, anëtar i Komitetit të vlerësimit të abstrakteve e paraqitura në Kongreset e ESC-së. Doli në pension në shtator 2008. Punoi në profesion të lirë në specialitetet e tij deri në fund të janarit 2023, duke përmbyllur një karrierë 62-vjeçare në kujdesin mjekësor.


Autor i pesë protokolleve shkencore. Autor dhe bashkautor i mbi njëqind artikujsh në revistat shkencore shqiptare dhe amerikane, autor i 54 referimeve në konferenca shkencore shqiptare e ndërkombëtare, bashkautor i librit "Sëmundjet e Zemrës", autor i librit "Pacienti ynë i veçantë", si edhe autor i disa tregimeve letrare. Mban titullin FESC për merita profesionale, mban urdhrin "Flamuri i Kuq i Punës" të klasit të dytë dhe të klasit të parë për kontributin profesional e shkencor dhe për drejtimin e zhvillimin e shëndetësisë. Mban titullin "Nderi i Qarkut të Dibrës".

Po të shkruanim ne të tjerët për prof. Ahmetin e për punën e tij vigane, thënia më e parë do të ishte: Profesor Ahmeti ka punuar me përkushtim përtej kufirit njerëzor. Si mjek. Si ministër. Si burrë shteti. Si qytetar. Si shok. Si familjar. Profesor Ahmeti i ka tejkaluar të gjitha përmasat e hapësirat e vendit të lindjes e të vendit të punës. Ai i përket gjithë kombit. Edhe me këtë libër. Por ngaqë e duam dhe e vlerësojmë shumë, na pëlqen ta mbajmë krejt për vete, krejt për Dibrën. Një fjalë e urtë arabe thotë: Vepra është e djalit, por djali është yni.

Vendit ia japin fytyrën njerëzit. Shqipërisë ia dhanë fytyrën mogulët. E ç'janë mogulët? E shpjegon prof. Ahmeti në librin e tij: "Mogul (*fjala vjen nga persishtja* – H.Sh.) është një person i rëndësishëm ose i fuqishëm ...". Në shkrimin me titull *"Mogulët e së keqes që e katandisën Shqipërinë si mo'Zo më keq"*, "Mogul është çdo person që pas përmbysjes së socializmit në Shqipëri në vitin 1991, duke shfrytëzuar rrethanat e krijuara, në emër të luftës kundër komunizmit dhe vendosjes së demokracisë, fitoi fuqi të madhe politike, duke i quajtur interesat e tij dhe ato të elitës politike, së cilës i përket si interesat më të mira të popullit dhe të Shqipërisë, me veprimet ose mosveprimet e tij, duke përdorur fuqinë e tij politike, grumbulloi pasuri në mënyrë të pajustifikueshme, e përdori këtë fuqi në të mirë të interesave vetjake, të familjes ose të elitës së grupimit politik përkatës dhe në dëm të interesave, identitetit e dinjitetit kombëtar, në dëm të zhvillimit e begatimit të vendit e të popullit, në dëm të qëndrueshmërisë ekonomike, politike, kulturore e morale të tij."

Autori shkruan me përnderim për Luftën Nacionalçlirimtare. Thënia e tij lapidare, "Kësaj vepre madhështore duhet t'i falen të gjithë shqiptarët, të cilët mbi çdo tjetër çmojnë e adhurojnë atdheun e vet" duhet të lëvizë çdo mendje dhe çdo zemër shqiptare.

Për Luftën Nacionalçlirimtare ka disa shkrime në libër. Një shkrim shumë interesant është ai me titull: *"Ju nuk e dini se sa heroike ka qenë Lufta juaj Nacionalçlirimtare"*. Fjalët e titullit janë të Sër Rexhinald Hibertit (Sir Reginald Hibbert), autori i librit *"Lufta Nacionalçlirimtare e Shqipërisë – Fitorja e hidhur (Albania's National Liberation Struggle: The Bitter Victory, London, 1991)*. Gjatë Luftës Nacionalçlirimtare, Sër Rexhinaldi ka qenë oficer i SOE-së *(The Special Operation Executive)*. Në nëntor të vitit 1994 ai ka ardhur në Tiranë si i ftuar i qeverisë shqiptare në festën e 50-vjetorit të çlirimit të Shqipërisë. Profesor Ahmeti ka biseduar drejtpërdrejt me të dhe e riprodhon tërë bisedën në shkrimin e tij. Dhe nuk mund të mos madhështohesh si atdhetar, kur lexon vlerësime kaq të larta për Luftën nga personalitete të huaja, si Sër Rexhinaldi. "Për Luftën tuaj, - thotë ai, - duhet të shkruani ju vetë. Ju keni male me dokumente ... Në qoftë se ju nuk do t'ia bëni të ditur botës në gjuhët që ajo njeh, ajo periudhë shumë e rëndësishme e historisë suaj do të mbetet në errësirë. Nuk mjafton t'ia bëni të ditur vetvetes. Kam dëgjuar, - vijon diplomati anglez, Sër Rexhinaldi, - se po dëmtoni monumentet e Luftës suaj Nacionalçlirimtare, madje, pllakën e monumentit të Brigadës VI në Përmet e keni thyer. Në qoftë se do të vazhdoni të dëmtoni, të përdhosni dhe të shkatërroni monumentet e Luftës suaj Nacionalçlirimtare, ju nuk e imagjinoni dot se çfarë dëmi do t'i sillni vendit tuaj". Këto janë veprime prej vandalësh. Dhe lajme për vandalizma të tillë kishin mbërritur deri në Angli. Dhe atëherë, cila është fytyra jonë para të tjerëve?! Ka pasur e ka edhe vandalizma të tjerë. Si atdhetar i madh, profesor Ahmet Kamberi i rreshton ata në shkrimin "Mogulët e së keqes ..." (me të cilin hapet edhe libri), te nëntitulli "Përmbysja e socializmit", në f. 30-33, te shkrimi "Drejtuesit dhe politikanët që ndërruan pushtetin" etj.



Në foto: Ahmet Cami, komandant i çetës së Gollobordës

Jemi përsëri te Sër Rexhinaldi. Nuk qe David Smajli (oficer i SOE-së) si ai sepse kishte pikëpamje të kundërta për Luftën dhe popullin tonë. Në vitin 2009, kur vdiq David Smajli (në moshën 92-vjeçare), gazeta britanike "Telegraph", Londër, shkruante në nekrologjinë e tij (9 janar, 2009): "Kolonel David Smajli ishte njëri nga agjentët e fshehtë dhe spiunët më të shquar të Luftës II Botërore, që shërbeu në prapavijat e armikut në Shqipëri, Greqi, Abisini dhe në Tailandën Lindore të pushtuar nga japonezët ... Pas Lufte organizoi operacione sekrete kundër Rusisë dhe aleatëve të saj, Shqipërisë dhe Polonisë". (Përkthimi është i autorit - H. Sh.). Nëse këto "s'janë gjë", lexoni në librin e profesor Ahmetit si i përçmonte shqiptarët ky soj koloneli, sipas fjalëve të Billi Meklinit, eprori dhe miku i tij. Ndoshta, për "merita" të tilla, - thotë profesor Ahmeti, - David Smajli, kur u kthye si triumfator në Shqipëri pas vitit 1990, do të dekorohej nga Presidenti i Shqipërisë, me rastin e 50-vjetorit të Çlirimit të Atdheut me dekoratën e lartë "Urdhri i Skënderbeut"(!). Shumë kuptimplote është thënia e mëpasme: "Dhe thesit të madh të dekorimeve nga presidentët e Shqipërisë, këtu e mbrapa, do t'i shqyhej gryka".

Profesor Ahmeti e ka për zemër rininë e i dhimbset rinia. "Mogulët e së keqes, - thotë autori, - i kanë krijuar rinisë të gjitha kushtet që të harrohet në vese, shthurje, seksizëm e lakuriqësi, dhunë e kriminalitet, si edhe turli emisionesh e programesh televizive për t'i errur asaj sytë, që të mos jetë e aftë të këqyrë ligësitë, paudhësitë e prapësitë e tyre shkatërrimtare". Por, - vijon autori më tej: "Unë besoj se rinia do të zgjohet për të dalë nga kurthi i dehjes dhe letargjisë prej shthurjeve të neveritshme ... Misioni i rinisë së Shqipërisë është të luftojë për demokracinë e vërtetë dhe për të shkallmuar përfundimisht demokraturën".

(Vijon numrin e ardhshëm)

Shkrimin e plotë mund ta lexoni edhe në rrugaearberit.com ose skano kodin:

Rruga e Arbërit nr. 200

intervistë



Liri Rasha, këngëtarja me zërin unik

Me emrin e këngëtares së shquar dibrane Liri Rasha është e lidhur kënga lirike e njërës nga trevat më të pasura artistike të kulturës popullore dhe folkut shqiptar. Në rrugëtimin e saj skenik, ajo asnjëherë nuk ka deformuar këngën e bukur popullore. Të gjitha këngët e kënduara prej saj janë bërë hite dhe kanë udhëtuar e udhëtojnë me kujtesën e njerëzve, që e duan këngëtaren e shquar dhe impresionohen nga magjia e shpirtit të saj të bukur artistik. Në një intervistë për Radio Ejani këngëtarja Liri Rasha tregon për karrierën e saj artistike si dhe produksionet e fundit muzikore që ka realizuar.

- Jeni një artiste me karrierë mbi 50 vjeçare në skenë. Si i kujtoni ato vite të kontributit tuaj në muzikën popullore dhe emocionet që keni përjetuar në karrierë?

- Sa më shumë kalon mosha, aq më shumë rriten emocionet kur kujton vitet në skenë, emocionet që je lidhur me publikun si dhe emocionet që ke marrë. Të gjitha këto vjen një ditë dhe ngarkohesh shumë me emocione.

- Ka pasur momente që keni thënë se jam lodhur me këngën?

- Asnjëherë! Mua çdo gjë mund të më lodhë, por vetëm kënga nuk më lodh kurrë.

- Ju keni përfunduar studimet për mësuesi, si u gjendët te kënga?

- Unë që e vogël jam marrë me këngën dhe shkollën pedagogjike e kam filluar për arsye të këngës, sepse në atë moment ishte shansi im festivali i Gjirokastrës. Unë u paraqita në zonën time me një këngë e cila pati shumë jehonë dhe nga aty kalova në shkollën e mesme në Peshkopi, ku më dhanë bursë dhe bashkë me shkollën vazhdova edhe këngën, ku jam aktivizuar vazhdimisht me Estradën profesioniste të Peshkopisë.

- Disa prej këngëve tuaja edhe sot janë hite dhe këndohen nga të gjithë. Keni ndonjë nga interpretimet tuaja më të veçanta për ju dhe publikun?

- Të them të drejtën mua më pëlqejnë të gjitha, por e shoh edhe vetë që kur interpretoj një këngë përpara publikut nuk e shoh se sa e duartroket. Unë e shoh se sa ja bëj unë qejfin vetes me atë këngë në atë moment. Nëse unë jam e kënaqur me veten, atëhere jam e bindur se publiku e ka pëlqyer këngën. Përndryshe edhe nëse më ka dhënë duartrokitjet për respekt publiku, unë e kuptoj se diçka nuk ka shkuar ashtu si duhet.

- Disa prej këngëve tuaja këndohen sot nga shumë këngëtarë të rinj. Si ndjeheni kur i dëgjoni ato?

- Më pëlqejnë shumë këngëtarët që kanë kënduar këngët e mia, por nuk më pëlqejnë kur thonë se po e këndoj këtë këngë sepse është këngë e popullit. Këto artistë duhet ta dinë se edhe në atë kohë kur këto këngë kanë mbetur të popullit, ka pasur emra të përveçëm sepse dikush i ka krijuar tekstin dhe muzikën. Kështu që këta artistë duhet të kenë respekt për krijuesin e këngës. Ata shprehen që është këngë e popullit se është bërë para viteve 90-të, ku çdo këngë mund të këndohet nga gjithkush sepse është këngë e popullit. Kjo gjë është gabim, sepse kënga është e popullit dhe ne këndojmë për popullin si atëhere ashtu edhe sot, por ka krijues muzike edhe teksti.

- Ju përveçse një interpretuese e denjë e këngës popullore keni krijuar edhe vetë muzikë dhe tekste të këngëve tuaja. Flasim për këtë pjesë të jetës suaj artistike.

- Aktivizimi im në Estradën profesioniste të Peshkopisë gjatë viteve të shkollës më ka ndihmuar në ecurinë time si artiste. Në atë periudhë Estrada kishte një plan dhe duhej repertor, sepse kishte tre premiera në vit ku duheshin këngë të reja. Kështu që mua më është dashur të krijoj vetë. Fillimisht më dukej vetja e pafuqishme për të krijuar dhe u zhvillua një festival i këngës popullore të rrethit të Dibrës kur udhëheqësi artistik më tha të gjeja një këngë për ta kënduar në festivalin e këngës popullore. Unë u mundova të merrja një këngë nga trevat e tjera, por edhe pse këngët ishin shumë të bukura nuk po më pëlqente kjo gjë.

Në fillim krijova muzikën se më erdhi një motiv dhe atij motivi i vendosa një tekst dasme. Kjo është kënga "Oj Zogo", që unë e paraqita në festival. Kënga ishte shumë e bukur dhe u prit nga komisioni që pa gjithë aktivitetin, por dikush u ngrit dhe diskutoi që kënga ka nuanca sllave dhe nuk duhet të paraqitet në konkurim. Kështu që ra si këngë për momentin edhe pse më vonë unë e këndova nëpër turnetë që bënte estrada në fshatrat e Dibrës. Këtë këngë e kanë kënduar shumë këngatarë dhe normal që e humbet pak orientimin për autorësinë.

- Pse pikërisht kjo këngë është bërë hit në muzikën popullore?

- Kjo është një këngë e thejshtë, sepse edhe kur krijohet kënga nuk duhet ta bombardosh me shumë tekst, por duhet një tekst i thjeshtë që ta kuptojnë njerëzit dhe mos të përtypet fjala në këngë, por të thuhet fjala pastër. Gjithashtu edhe vija melodike e kësaj kënge rastisi mirë dhe u pëlqye e u këndua në të gjitha trevat shqiptare.

- Në këto 50 vite karriere jeni vlerësuar me mjaft çmime dhe medalje për kontributin tuaj në muzikën popullore. Çfarë janë vlerësimet për një artist?

- Kur vlerësohet artisti e quan si kurorëzim të punës që ka bërë. Të them të drejtën kur kam filluar të këndoj nuk kam menduar për tituj, por kam menduar vetëm të këndoj deri aty sa lutesha që ta merrte vesh udhëheqësi artistik i zonës se unë këndoja. Nuk më shkonte mendja se unë do isha këngëtare me tituj, por filluan vlerësimet. Filloi Festivali Folklorik i Gjirokastrës dhe mora medaljen "Naim Frashëri", shkova në festivalin tjetër dhe mora Urdhërin e klasit të tretë dhe më vonë edhe të klasit të dytë. Pastaj kam marrë dhe shumë vlerësime me Estradën profesioniste të Peshkopisë. Në vitin 1988 mora titullin "Artiste e Merituar", pastaj titullin "Mjeshtër i Madh" dhe më vonë edhe titullin "Kalorësi i Skënderbeut".

- Këngën në familjen tuaj e ka trashëguar edhe vajza juaj Ingriti, e cila tashmë është një këngëtare e afirmuar në muzikë. Sa keni ndikuar ju në formimin e saj artistik?

- Në hapat e para kur ka filluar të këndojë dhe ta pëlqejë muzikën ajo ka pasur idhull dikë tjetër. Njëherë kishte si idhull këngëtaren Afërdita Zonja, ndërsa më vonë kur doli Parashqevi Simaku ajo kishte idhull këtë këngëtare në pjesën e lëvizjeve në skenë. Pastaj më ka ndjekur mua hap pas hapi në skenë dhe nëpër turne sepse e kam marrë vazhdimisht me vete. Unë nuk e kam detyruar asnjëherë, përveçse në nuanca që kam

"Më pëlqejnë shumë këngëtarët që kanë kënduar këngët e mia, por nuk më pëlqejnë kur thonë se po e këndoj këtë këngë sepse është këngë e popullit. Këto artistë duhet ta dinë se edhe në atë kohë kur këto këngë kanë mbetur të popullit, ka pasur emra të përveçëm sepse dikush i ka krijuar tekstin dhe muzikën. Kështu që këta artistë duhet të kenë respekt për krijuesin e këngës".

ndërhyrë kur këndonte ndonjë këngë. Aty më pëlqente që t'i kishte nuancat sinkron, ndërsa që t'i them të këndojë apo mos të këndojë, nuk e kam bërë. Ajo ka ecur vetë shumë mirë dhe këndon, por ka edhe një punë tjetër sepse ka përfunduar studimet për drejtësi me rezultate të shkëlqyera dhe vazhdon punën si juriste pranë një institucioni.

- Do të dëshironi ta shikoni Ingritin si këngëtare të muzikës së lehtë apo asaj popullore?

- Faktikisht muzikën e lehtë ka filluar ta këndojë shumë bukur, por këndon shumë bukur dhe muzikën popullore dhe kjo më pëlqen.

- Si kanë qenë përshtypjet e publikut kur ju kanë parë të këndoni në duet?

- Kur hapa telefonin një ditë te kanali YouTube dhe pashë komentet tek një duet që kemi bërë bashkë, njëra shkruante "sa bukur kjo vajza" dhe ishte habitur se si ka mundësi ky zë më i bukur se i Liries, por kur mora vesh që është e bija aty nuk kam se çfarë të them, kishte shkruar në koment.

- Cili është mendimi juaj për brezin e ri të këngëtarëve të muzikës popullore, dhe nëse ka prurje apo devijime më tepër?

- Momentalisht ka shumë prurje dhe nuk ka devijime. Ishte një moment kur hyri tallavaja që ndikoi edhe tek ne dhe gati na u prish e kënduara, por tani është një brez që po merret me këngën folk dhe janë rikthyer te tabani.

- Pse keni preferuar që të realizoni duete vetëm me këngëtarë të rinj?

- Unë kam parë këngëtarët që janë me emër dhe vazhdimisht bëjnë duete me një këngëtar të nivelit të vet dhe kjo më pëlqen se tek ata është një këngë e arrirë dhe e dëgjon me kënaqësi. Ndërsa unë kam zgjedhur të këndoj me një këngëtar që nuk është në nivelin tim dhe pse më vonë mund të bëhet shumë më i mirë sesa unë, por kam zgjedhur këngëtarë që janë të paafirmuar për t'u dhënë një mbështetje.

- Kohët e fundit keni sjellë disa këngë të reja popullore me tekstet dhe muzikën tuaj. Cilat janë krijimet e fundit muzikore dhe çfarë presim në vijim nga ju?

- Unë këtë vit kam punuar për këngë të reja sepse pata një shtytje nga disa dashamirës dhe u kritikova shumë pse jam e tërhequr nga skena, ngaqë mua më presin adhuruesit e mi. Këto ishin dashamirësit e mi, një krijues tekstesh që unë kam shumë këngë me tekstet e tij dhe ai është Agim Qoku me origjinë nga Dibra, por lindur dhe rritur në Çermenikë. Naim Gjoshi më ka bërë dy këngë, që janë të dyja perla për mua. Gjithashtu kam realizuar dhe një këngë tjetër që e dua shumë, e kam krijuar para shumë vitesh dhe sivjet mu mbush mendja që ta inçizoja. Unë isha duke parë një emision pleqsh, unë pleqtë i dua shumë dhe po fliste dikush që i kishin ikur fëmijët jashtë. Unë duke parë emisionin më vinte një muzikë në vesh, ku dhe dy strofa të tekstit më lindën në atë moment. Kjo ka dalë një nga këngët që unë e dua shumë dhe titullohet "Loti i vetmisë".

- Keni pasur një lidhje të ngushtë me artisten e madhe Luçije Miloti, e cila ju ka dashur dhe ju e keni dashur shumë.

- Unë e kam dashur si artiste sepse ajo ka qenë një artiste e madhe. Unë jam falenderuese vazhdimisht që më ka dhënë dorën dhe më ka vlerësuar si këngëtare. Unë këndoj këngën "Çuçurushja", që ajo vetë më tha se e kishte ruajtur këtë këngë për ta kënduar unë. Ajo më tha që gjithë ato vite që ka qenë sëmurë i kishte pëlqyer vokali im dhe e kishte ruajtur këtë këngë që ta këndoja unë. Unë edhe sot kur e këndoj këtë këngë më duket sikur e kam Luçijen aty afër.

- Së fundi një përshëndetje për dëgjuesit tanë dhe adhuruesit tuaj të shumtë.

- Është e vërtetë që kam shumë adhurues sidomos përtej kufijve. Unë ju premtoj që këngën nuk do ta le kurrë, derisa të kem frymë.

Intervistoi: Gazmend Agaj / *Marrë nga albanian.cri.cn*

histori

**Me rastin e 80-vjetorit të krijimit,
15 gusht 1943**

Çeta partizane e Gollobordës

Nga: ZABIT LLESHI

Për krijimin e saj u grupuan vullnetarë partizanë nga Golloborda, Gryka e Madhe, Gryka e Vogël, një pjesë ishin aktivizuar me çetat e tjera. Përveç veprimtarëve të hershëm antifashistë si Spiro Velko, Asllan Zeneli, Uruç Karahasani, Maliq Qazimi dhanë ndihmesën e tyre pjesëtarë të fisit Cami dhe vullnetarë të tjerë nga Viçishti të njohur në luftërat për liri e pavarësi të udhëhequr nga Dan e Feta Cami, Tahir Tola etj.

Intelektualët gollobordas Qazim Kasa, Xheladin Sadiku, Abdurrahman Terziu, Ismail Driniziu, Hamit Destani zhvilluan një propagandë për demaskimin e forcave italiane pushtuese duke ndihmuar lëvizjen Nacionalçlirimtare dhe veprimet luftarake të çetës së parë partizane të Dibrës. Në shkurt 1942 erdhën në Dibër Ejup Hatipi e Ahmet Jegeni. Ahmeti kish marrë pjesë në lëvizjen studentore në Itali nëntor 1939 – shtator 1941 internuar nga fashizmi në ishullin Ventotene Itali, pranohet në radhët e Partisë Komuniste nëntor 1942. Në Dibër të Madhe takimet e militantëve komunistë dhe veprimtarëve antifashistë bëheshin në shtëpinë e Irfan Hajrullait. Traktin e parë e lëshuar nga PKSH ardhur në Dibër nga Nazmi Rushiti e çuan në Gollobordë Ahmet Jegeni e Ejup Hatipi. Ata u caktuan nga grupi për të punuar në fshatrat e Gollobordës dhe Homeshit.

Gollobordasit që punonin në gjithë Shqipërinë si Nuredin Sinani, Mahmut Isaku, Jonuz Basha etj., u aktivizuan në Vlorë, Tiranë, Elbasan, Durrës me njësitet guerile duke u bërë një shembull i madh frymëzimi për bashkëfshatarët e tyre kur vinin pranë familjeve në Trebisht, Gjinovec, Ostren pa përjashtuar punëtorët e tjerë që punonin në Dibër të Madhe, Manastir, Ohër, Shkup e deri Selanik, Sofie etj.

Ahmet Cami kishte karrierë ushtarake si oficer. Pasi mbaroi shkollën e oficerëve në Tiranë, shërbeu në Ushtrinë e Mbretërisë në Shkodër, Gjirokastër dhe Elbasan. Më 7 prill 1939, pasi përcolli Ahmet Zogun me suitën e tij në Kapshticë për Greqi, u kthye për në vendlindje. Më 6 prill, bashkë me shumë vullnetarë nga fisi Cami e Dibra, u bashkuan me Haxhi Lleshin në frontin Urë e Spiles - Miresh - Viçisht - Çerenec, kundër ushtrisë italiane që kishte sulmuar Jugosllavinë.

Fasli Cami është përjashtuar nga shkolla Normale për veprimtari antizogiste e antifashiste. Kishte një formim e pjekuri që e kishte fituar me pjesëmarrje aktive kundër fashistëve italianë duke dhënë jetën e tij të re. Në përpjekje me një njësit italian më 7 duke u gdhirë 8 prilli 1941 në kodrat e Çerenecit vritet mësuesi patriot Fasli Cami një shembull frymëzimi për shumë të rinj dibranë në luftën e sapo nisur kundër ushtrisë fashiste italiane, që kishte trokitur në portat e Dibrës.

Më 10 prill në Viçisht u vranë Ejup Cami, Musa Cami e Mexhit Lezi. Pas pak ditësh u arrestuan 19 burra nga Camët ndërmjet tyre Ahmeti, Sula, Dilaveri, Ukja i Dull Camit, Izeti etj. Fillimisht i dërguan në Tiranë pastaj i grumbulluan në Burrel. Aty ishin edhe 12-13 luftëtarë nga Jasharajt e Maqellarës, që luftuan më 6 prill në sektorin e Bllatës nën komandën e Aqif Lleshit. Për daljen nga burgu në prill 1943 ndihmoi Beqir Valteri me ndërhyrjen dhe kujdesin e Haxhi Lleshit. Familja Valteri kishte një miqësi të vjetër me familjen Cami.

"Kur isha në Mat u shkova në shtëpi Valterëve (në shkurt 1943). Beqiri dija se ishte i lidhur me fashistët dhe Mustafa Krujën, por armiqësia me Zogun, pritja që u kishin bërë Valterëve kur ishin emigrantë në Jugosllavi mendova se mund të ndryshoj rrugë. Më tha se kishte respekt për mua, por nuk mund të hiqte dorë nga e tija. Me qenë se ruan respekt ndaj meje tregoje me një shërbim, më liro nga burgu i Burrelit Jasharajt dhe Camët. Ramiz Valteri ndërhyri në bisedë or mixh iu drejtua Beqirit mos harro sakrificat që kanë bërë Lleshet për fisin tonë kur kemi qenë ngushtë, na hapën portën e zemrës, na shtruan sofrën bujare me të gjitha të mirat Beqiri heshti pak çaste dhe tha e kam për detyrë të ta shkoj këtë rixha".1 Pas daljes nga burgu në prill 1943 u bashkua me lëvizjen Nacional-Çlirimtare. Kristo Frashëri, ish partizani i çetës së Grykës së Madhe, shkruan: "Më 26 korrik 1943 në Gjoricë u formua batalioni i Dibrës ku u rreshtuan 3 çeta, e Grykës së Vogël, e Grykës së Madhe dhe Sllovës"2.

Celula e Partisë Komuniste e Dibrës e caktoi Ahmet Camin komandant të çetës së Gollobordës e cila u bashkua me batalionin partizan të Dibrës më 15 gusht 1943.

Çeta e Gollobordës u krijua në gjysmën e dytë të muajit gusht 1943, sdudiuesi i luftës Nacionalçlirimtare dhe i dëshmorëve të saj Resul Bendo kur shkruan për Heroin e Popullit Spiro Velko nënvizon "Me formimin e çetës së Gollobordës në gjysmën e dytë të muajit gusht 1943 Spiro Velko u caktua komisar i çetës së Gollobordës3.

Aksioni i parë i çetës së Gollobordës ishte në rrugën Dibër-Strugë me datë 3 shtator 1943, bashkë me çetën e Grykës së Vogël. Për këtë aksion u nis edhe Haxhi Lleshi, por u kthye në Ostren sepse mori njoftimin për ardhjen e misionit ushtarak anglez pranë batalionit partizan të Dibrës. Misioni ishte në Vorre të Vrame. Gjatë kthimit komandanti i batalionit mori me vete çetën e Grykës së Madhe. Në Trebisht më 2 shtator 1943 çetat sulmuan dhe dogjën postën e xhandarmërisë Trebisht, dogjën dokumentet zyrtare të saj. komunën e mori në dorëzim Këshilli Nacionalçlirimtar.

Partizanët së bashku me komandantët Ahmet Cami e Ymer Lleshi festuan së bashku me popullin. Të nesërmen organizuan në Modriç pritën në rrugën automobilistike Dibër-Strugë. Pasi hyri autokolona në pritë u organizua një sulm i befasishëm. Dhjetë oficerë të ushtrisë fashiste italiane u vranë, u dogjën 3 makina, u sigurua një mitraloz, 5 pushkë dhe një sasi municioni4. Pas këtij aksioni dy çetat u kthyen në Tërnovë pa humbje. Në shenjë hakmarrje ushtria italiane dogji me 4 shtator 400 shtëpi në Trebisht, arrestuan disa fshatarë midis tyre mësuesi Mustafa Shahini e Ismail Sinani.

Më 9 shtator 1943 çeta e Gollobordës në Dibër të Madhe në kuadër të Batalionit realizoi detyrën për ruajtjen e trupave italiane pranë kazermave, depot dhe objektet e tjera. Më 12 shtator 1943 divizioni Firence, pas dorëzimit, filloi të lëvizë nga Dibra e Madhe në 2 drejtime 1. Nga Bllata Ura e Topojanit – Bulqizë. 2. Ura e Spiles-Miresh-Çerenec-Grykë e Madhe Bulqizë. Çeta e Gollobordës mori detyrë të ruajë forcat italiane nga një sulm i mundshëm i ushtrisë gjermane nga Struga duke mbajtur lidhje me Ahmet Jegenin si përfaqësues i batalionit partizan pranë komandës së Divizionit italian5.

Me largimin e forcave italiane nga Dibra e Madhe, paria dhe Balli Kombëtar bashkuan forcat kundër Nacionalçlirimtares, filluan të provokojnë qytetarët e Dibrës së Madhe, kërkonin të krijonin anarki, nxitnin revolta e ngatërresa etj.

Shtabi i Batalionit dhe Këshilli Nacionalçlirimtar i Dibrës morën vendime dhe caktuan afatin e një ultimatumi. Më 30 shtator 1943 ora 15.00 të gjitha forcat e Parisë të largohen nga Dibra, ndryshe forcat partizane do t'i nxjerrin me forcë. Pa mbaruar ultimatumi paria reaksionare forcat e ardhura të Ballit Kombëtar me rreth 3000 forca larguan nga Dibra e Madhe.

Tani deklaruan ata duam të luftojmë gjermanët, por na duhet një qendër për t'u organizuar prandaj forcat partizane të lironin Peshkopinë. Këto kërkesa i përkrahu edhe kapiteni anglez Hends.

Një ndër betejat më të ashpra e të përgjakshme që çeta e Gollobordës përballoi me heroizëm ishte ajo e mbrojtjes së Peshkopisë me datë 17 tetor 1943 nga forcat reaksionare të Dibrës. Ato përfaqësoheshin nga Fiqiri Dinja, Hysni Dema, Halil Alia, Selim Kaloshi, Ali Maliqi, Dilaver Dinja, Miftar Kaloshi. Abas Kupi, kish marrë në Peshkopi Ndrec Lufin, Bilal Kolën, Dule Allamanin, Isuf Selmanin, Murat Bashën. Trupat italiane në Peshkopi, një pjesë i nisën për Dibër të Madhe, pjesa tjetër u nis nga Muhurri-Katër-Grykë për t'u bashkuar me divizionin në Burrel. Kazermat, depot dhe armatimet e Ushtrisë italiane në Peshkopi u muarën në dorëzim nga çeta e Sllovës dhe ato vullnetare që komandoheshin nga Faik Shehu. Paria me forcat e saj bëri përpjekje të përfitojë nga pasiguria e forcave italiane dhe një natë sulmoi kazermat, por u ndeshën me ushtrinë italiane e vendosur të ruajë objektet e saj. Këtu humbën jetën disa fshatarët të zhgënjyer në mbështetje të parisë reaksionare dibrane. Menjëherë ndërhyn forcat partizane për të vendosur qetësinë dhe rregullin. U zgjodh Këshilli Antifashist Nacionalçlirimtar dhe filloi nga puna. Paria reaksionare e Dibrës krerët e Ballit Kombëtar të ardhur në Peshkopi të mbështetur nga misioni anglez nuk mund të pajtoheshin me faktin se pushteti ishte në duar të lëvizjes Nacionalçlirimtare. Mitat Frashëri u bëri thirrje krerëve të parisë të vepronin dhe të hynin sa më parë në Peshkopi për të marrë pushtetin.

Pa u vonuar forcat e parisë u futën në Peshkopi dhe zunë disa pozicione dhe pika dominuese.

Para se të merrte Peshkopinë, Paria filloi përgatitjet të merrte kalanë nga brenda nëpërmjet kompromisit. Abas Kupi si anëtar i shtabit të Përgjithshëm të Ushtrisë Nacionalçlirimtare ishte në Peshkopi me 250-300 forca. Pas shumë bisedimesh me Esat Ndreun dhe Zoi Themelin përfaqësues të Frontit Nacionalçlirimtar, u arrit që të caktojnë prefekt Jahje Çaçin dhe qark komandant Miftar Kaloshin. Pushtetin në Peshkopi e ushtronte Këshilli Nacionalçlirimtar, që kontrollonte zonat e çliruara të krahinës së Dibrës. Në bazë të marrëveshjes po krijohej një (dy) pushtet duke u lënë rrugë forcave të parisë të asgjësonin forcat Nacionalçlirimtare për të marrë krejt pushtetin. Pastaj shtruan problemin të largoheshin partizanët jo dibranë ndërsa vendasit t'u nënshtroheshin urdhrave të tyre.

Shtabit të Batalionit dhe Këshillit Nacionalçlirimtar u kishin lënë të drejtën të përfaqësoheshin me nga një njeri në komitet, nga 12 që kishin ato. Të hapeshin depot e kazermave dhe t'i dorëzohej parisë gjithë materialet që ishin në depo. Drejtuesit e Luftës Nacionalçlirimtare Stefan Luarasi, Riza Doda, Imer Lleshi, Hasan Luma u orientuan për të patur kujdes, të evitohej përplasja dhe gjakderdhja, mbasi ato përkraheshin nga dibranë të gënjyer e të mashtruar.

Për të vlerësuar situatën tre çetat morën urdhër të shkonin në Peshkopi (Grykës së Madhe, të Vogël dhe Gollobordës) bashkë me çetën territoriale të Aqif Lleshit. Gjendja prag lufte. Oficerët e misioneve angleze i nxisnin kontaktet dhe bashkëpunimin e krerëve të Ballit Kombëtar, të Legalititetit, me parinë dhe bajraktarët e Veriut. Anglezët mendonin se kishte ardhur momenti i përshtatshëm kur një trevë e ndezur e lëvizjes Nacionalçlirimtare, siç qe Dibra mund të bëhej një zonë e nacionalistëve të kulluar 6.



Në foto: Ahmet Cami, komandant i çetës së Gollobordës

Forcat e batalionit të Dibrës kishin zënë pozicionet tek kazermat e qytetit dhe Kodrat mbi to, kazermat e Pollozhanit tek ndërtesa e ish prefekturës e të burgut, në lagjen e Kallaveres, në varret e Staravecit. Në vijën mbrojtëse ishin çeta e Sllovës, vullnetarët e Faik Shehut, Azis Hoxhës, Zija Serdarit e Shaban Vakufit. Kishte ardhur edhe çeta e Lumës, bashkë me një njësit të çetës së Sharrit me 40-45 partizanë (kosovar, malazez, serb dhe shqiptar).

Çeta e Sharrit ishte thirrur nga Vukmanoviç Tempo për të ardhur në Dibër të Madhe në Kuadër të formimit të brigadës parë Kosovaro-Maqedonase. Për të dalë nga Sharri rruga më e shkurtër ishte ajo Gostivar-Kërçovë, por rrezikoheshin nga gjermanët dhe forcat e Xhem Hasës. Çeta kërkoi ndihmën e forcave partizane të Dibrës. Haxhi Lleshi bisedon për këtë me komisarin e çetës së Lumës Abedin Shehun, i cili erdhi në Peshkopi. Forcat reaksionare të komanduara nga Fiqiri Dinja, Hysni Dema, Abas Kupi, Halil Alia, Ali Maliqi etj., sulmuan pozicionet e Nacionalçlirimtares nga Pollozhani në Staravec. Lufta më e ashpër u bë ajo midis kazermave të qytetit dhe qendrave të zjarrit në krahun verilindor të lagjes Kallavere. Të dy palët herë njëra, herë tjetra përparonin dhe tërhiqeshin.

Në mëngjes artileria e forcave çlirimtare me topat që komandoheshin nga Siri Strazimiri e mortajat e partizanëve italianë qëllonin pozicionet mbrojtëse të parisë sipas informacioneve që u vinte nga njerëzit e thjeshtë qytetarët e Peshkopisë. Predhat e para shembën muret e shtëpisë ku strehoheshin Halil Alia, Fiqir Dinja e Riza Drini. Të njëjtin fat patën forcat e parisë, që mbronin frontin nga Bashkia tek Hotel Dëfrimi, të cilat drejtoheshin nga Kadri Kallçishta e Beqir Sina. U detyruan të lënë llgoret e të dalin jashtë luftimit. Beqir Sufa komandant i vullnetarëve të Sllovës me Aqif Lleshin e Faik Shehun i shkulën forcat e Fiqiri Dines, Hysni Demës e Ali Maliqit nga lagjja Dobrovë, duke u larguar përroit të Peshkopisë për Dohoshisht. Në bahçen e Sheh Imerit u lëshua një predhë pas hotelit të Çengës në Tomin duke vrarë dhe plagosur 30-35 mercenarë të parisë. Midis tyre oficerët zogist Met Hoti nga Lura, Ibrahim Koleci nga Lami i Madh i Selitës së Matit. Miftar Kaloshi u plagos rëndë.

(Vijon)

Për shkrimin e plotë shih në rrugaearberit.com ose skano kodin:

Poetja që shkruan me gjuhën e shpirtit

Nga **SHAQIR SKARRA**

Katër vite, katër vëllime me poezi, dhe unë ndjehem me fat se redaktova tre librat e saj, isha pra edhe lexuesi i parë i poetes tashmë të afirmuar Sulbije (Tota) Shehu. Poetja erdhi fare rastësishëm dhe u fut në hullinë e bukur të poezisë dhe tashmë në këtë hulli po rend, nuk po ecën.Shpirti i saj krijues u shfaq herët, qysh kur ishte në shkollë, por sot pas kaq vitesh vargu i saj i ka kaluar trojet shqiptare dhe nuk është më ajo poezia e dikurshme që qëndronte në fletë të vogla blloku, por është përhapur si aroma e luleve të bjeshkës, anembanë globit dhe po lexohet e pëlqehet nga të gjithë. Jo vetëm kaq, por forca e vargut të poetes është bërë këngë e na vjen fuqishëm nëpër telat e çiftelisë nga rapsod të njohur brenda dhe jashtë trojeve tona. Vëllimi i saj i katërt është ndarë në dy pjesë.

Pjesa e parë është me lirika për të cilën poetja e lëvron më së shumti dhe pjesa e dytë është me tekste këngësh por pa u larguar aspak nga lirizmi i saj. Poezitë e Sulbijes ngjajnë së shumti me një mushkë xanxare, lëshuar lëndinave lirike të poezisë së sotme shqipe, ku hapi i të cilës rend në harmoni të plotë me hapin e ndjenjave të zjarrta të poetes, të cilat shpërthejnë thellësisht hapësirash të pa fundëme të muzës së saj krijuese e dalluese nga poezitë që kemi lexuar rëndom vitet e fundit. Vargjet e Sulbijes strukturohen në poezi të bukura që e plotësojnë dhe hijeshojnë më së miri librin nga faqja e parë deri tek e fundit.Tingujt e lehtë që na shoqërojnë nga fillimi e deri në fund të leximit, s'janë gjë tjetër veçse një akustikë e ndjesive të saj, prej një gruaje të fortë malsore.

Vëllimi më i fundit i poetes Sulbije Shehu me titull "Mos ma prek vargun në letër", një titull mjaft intrigues e gjithë metaforë,nuk është shkruar me një frymë apo sipas ndonjë ditari pune. Ato vërtet janë krijime prej momentesh por që në fakt përbëjnë një tërësi, një libër. Poezia e Sulbije Shehut nga fillimi deri në fund ka shumë prirje të sundohet nga lirizmi, por befasisht del se ajo është e ngarkuar edhe me mjaft meditim filozofik. Në poezitë e Sulbijes ka mesazh për lexuesin, ka filozofi, ka dashuri, ka dhimbje, ka jetë, ka shpresë.

Vargu i saj shpreh shqetësim, ka nerv, nuk duron dot fryrjet boshe, buzëqeshjet e shtira, mashtrimin e pështirë. Jo, poetja është e vërtetë, reale si në jetë ashtu edhe në artin e saj. Përveç lirikave aq të ëmbla deri në thellësitë më imta të ndjenjës hyjnore e njerëzore, aq të lira e të dlira, vërejmë se në vargjet e poetes rroken me mprehtësi tema sociale. Sulbije Shehu ka zhvilluar, në koherencë me vetë stilin e tij, për të cilin ka një vëmëndje të posaçame, diçka e ngjashme me simpatinë, por me drejtim të dyanëshëm. Empatia e poetes shprehet mjaft mirë në gjetjen e vetes tek të tjerët dhe në zbulimin e tjetrit tek vetja.

Poezia e Sulbije Shehut në fakt është vetë biografia, jeta e saj. Poezia e saj është ujëvarë e kaltër në pasqyrimin artistik nëpërmjet vargjeve të vrullshme, sa të sinqerta, aq edhe të bukura.

Vetë talenti i saj është vënë në dukje herët, që në vëllimin e parë me poezi dhe tashmë në këtë vëllim vjen në rritje, është talent mjaft i këndëshëm dhe i mirë i pranueshëm e poetja tashmë e afirmuar dhe e njohur në qarqet e letërsisë shqipe është futur bindëshëm në hullinë e poezisë, po e shtyn plorin vazhdimisht dhe me sa duket nuk ka të ndalur.Ajo është vyrtyti i çiltërsisë së saj, që u fal vlerave letrare ëmbëlsinë më







të bukur, siç është lirika.Leximi i lirikave sot, në botën e internetit është pa dyshim pjesë e atij ushqimi shpirtëror të përzgjedhur me kujdes, për të cilin qenja njerëzore ka shumë nevojë, me qëllim që ta ushqejë shpirtin me harmoninë dhe muzikalitetin e domosdoshëm. Në poezinë e bukur "Falma syrin, ta pushojë lotin " thotë:

"Falmi sytë, ta pushojë lotin,
Falma zemrën ta përkëdhel.
Dashurinë t'na e bekojë Zoti,
Do ta bëj jetën pranverë.
Afroju pak, pashë sytë e ballit!
Të marr aromë moj lule thane.
Krejt burimet në ato bjeshkë,
Nuk ma shuajnë etjen tande".

Poetja Sulbije Shehu di ta jetojë jetën, ashtu siç i vjen pa patur fare komplekse, ajo ka kodin e saj moral, ka miqësinë e saj, ka dinjitetin e saj dhe është mjaft e zonja e vetes, ajo thur vargje që të ngelen në kujtesë për gjatë, sepse brenda ngjyrave të lirikave të saj ka lule por dhe furtunë, ka dallgët e jetës që përplasen sa në një breg në tjetrin breg. Ajo di të na e jap fabulën poetike shumë të tejdukshëme, me hijeshi jetësore dhe mjaft të çiltër, ashtu siç është në fakt edhe vetë.

Ajo e jep fabulën poetike shumë tejdukshëm dhe me mjaft hijeshi jetësore e të çiltër. Pa dashur të shtrihem e të qëmtoj në analizë apo në shqyrtimin e figurave stilistike, autorja në këtë libër, në profilin e saj poetik autorja dallohet për shije të shëndosha estetike. Ajo e do të bukurën në jetë, në art dhe poezi sepse estetikën e ka pjesë të stilit të vargut të saj.

Përveç fabulave e poezive, autorja shpalos qartë ndjenjat e saj, përjetimet, mendimet dhe qëndrimet ndaj dukurive të vetë jetës njerëzore, ndaj realitetit të sotëm, ndaj të mirës dhe të keqes. Poetja përballet me forcën e mendimit dhe të penës, në mënyrë të qartë dhe të prerë, me çdo dukuri që ia rrok talenti i saj , por ç'ka është më e rëndësishme, bëhet si përfaqësuese e një brezi të tërë që në fakt vepron e mendon si ajo.Në këtë vështrim të duket sikur Sulbija është vetë një përfaqësuese e çdo lexuesi, e çdo moshe, që duke njohur bukur këto krijime poetike, ndjen e vepron njësoj si dhe vetë ajo. Dhe pa dyshimin më të vogël kjo është edhe një nga meritat e veçanta të këtij vëllimi poetik.

Nëse do të bjerë në dorë libri i sapo botuar i Sulbije Shehut, me siguri do ta kesh të vështirë të shkëputesh sado pak nga rrjedha e leximit, pasi poezitë të rrëmbejnë, të fusin në një botë të gjërë ndjenjash e dashurie njerëzore, krejt natyrshëm derdhur në vargje me mjaft ndjenjë e pasion. E kur arrin tek strofa e fundit, ndjen vërtet keqardhje përballë pamundësisë për të "notuar" në këtë lëndinë të bukur njerëzore. Autorja na çon kudo me vargun e magjishëm të saj, nëpër vendlindje, në ato vende të bukura e piktoreske, tek ato bjeshkë me burime, tek lisat, në fshat e Gjallicën kryelartë. Dhe ja se si do të shprehet:

"Këtu nën një bli ma bëni varrin,
Le të pushojnë bilbila edhe udhëtarë .
Se në prehër të Gjallicës e ve kokën ,
Mes këngëve me ju do jem e gjallë..."

Fabulat e gjetura nga vetë autorja si dhe lirikat e këtij libri mbresëlënës, nuk janë edhe shumë të shkurtëra, por temat janë shumë të larmishme dhe kudo mbizotëron dashuria. Vetëm pesimizëm nuk gjen në poezinë e Sulbije Shehut. Këtu ka jetë, ka shpresë, ka dashuri. Kushdo që do i lexojë këto lirika, do të kuptojë qartë se vetë autorja i ka shkruar me stil të thjeshtë, me një konceptim dhe trajtim krejt origjinal, duke përdorur më së shumti metaforat dhe krahasimin. E vetmja e metë e autores është se gjithmonë mundohet të shkruaj gjatë, kërkon me ngulm ta ngjesh poezinë, dhe kjo tashmë po i bëhet si dukuri e zakonshme, pjesë e stilit poetik që ka.

Asnjë zë nuk i shkon aq bukur dashurisë sa zëri i gruas. Duket sikur dashuria e vërtetë flet me zërin e saj. Në vëllimin me lirika dhe tekste këngësh poetja Sulbije Shehu vjen për të na provuar edhe njëherë mendimin e njohur se nëqoftëse dashuria për burrin është një pjesë e jetës,për gruan është e gjithë jeta.Dhe vërtet kur lexon këtë vëllim, ndjen vetëdijshëm se aty brenda është tërë jeta e gruas, e cila ekziston dhe merr kuptim falë dashurisë.

Në qendër të poezisë së Sulbijes është vetvetja, një qenje ngaherë e dashuruar e cila e bashkuar me partnerin, përfiton një botë të magjishme. Dhe ja se si do të shprehet poetja në poezinë me titull "Ne të dy"

"Përqafuar do të rendim ,
Nëpër stinë e nëpër vite .
Ty të kam një forcë më vete ,
Kurrë në jetë nuk më mërzite...."

Poetja Sulbije Shehu sinqerisht të bën të reflektosh se pas çdo poezie apo tekst kënge kur lexon, spikat bota e saj e pasur shpirtërore, me magjinë e bukurisë dhe hirit femëror, e çliruar nga mjaft aspekte të përditëshmërisë së rëndomtë.

Poezia e Sulbijes është një mozaik kërkimesh në shpirtin e fshehtë të dashurisë dhe kujtimit emocional të dritëhijeve të tyre, të gjendjeve dehëse. Autorja di të ruaj bukur ekuilibrin mes ndjenjës dhe mendimit, mes figurës dhe imazhit, mes gjendjes dhe mesazheve që burojnë nga materia poetike. Dhe duke përfunduar, nuk më mbetet gjë tjetër, thjeshtë të uroj poeten se po ecën bindëshëm në brazdën e poezisë, duke i thënë: Vazhdo....! dhe duke kujtuar thënjen brilante të Dritëro Agollit:" Poetët janë si anije të bardha...Vijnë e largohen tej në horizont dhe përsëri shfaqen të bukur dhe të mahnitëshëm...."

Gazeta "Rruga e Arbërit"
Aty ku fjalët nuk i merr era...
Ne nuk jemi gazetë e pavarur, ne jemi gazetë e lirë dhe pavarësia jonë garantohet vetëm nga mbështetja e lexuesve...

poezi

Cikël me poezi nga Urim BAJRAMI



IDENTITET

Unë jam një Zot i vogël
Rebel i mallkuar përjetësisht
I heshtu vij të jetoj, këtu
Me ju njerëz, sigurisht.

Betuar jam të mos ju shaj
As t'ju mallkoj a t'ju përbuz
Jam Kopili i Vogël i Zotit të Madh
Rrallë herë më qëllon të bërtas
Apo t'ju flas me thumb e me romuz
Madje, kur më shani, më shumë ju dua
I sigurt se më doni pakëz dhe ju mua.

VOGËLUSHES

Kur ika si një re e bardhë,
harrova të të them përrallë.

Syçkat t'u skuqën.
Qave shumë.

Kisha ikur unë.

Ndoshta s'do të kthehem më,
ti s'do mbetesh pa përralla.

Merre shpirtin tim,
po ta lë.

Shfletoje nga e para.

ZEMËR E PLOTË

Unë kam një dhomë të varfër.
shpirti rehat më bën aty.
Në dhomën time, 2x3x4,
tavolina e vjetër shtyn vitet në vetmi.

Një divan i bërë me llastikë,
një tjetër më i mirë se ai.
Të mirin e ruaj për ndonjë mik,
kur vjen e më kërkon në shtëpi.

Perdet janë grisur me kohë,
dollapin me pak bukë, kripë e votkë.
Për miqtë e mirë, i njoh a s'i njoh,
zemrën në dollap e kam lënë të plotë.

SYTË E TU

Kam turp të të shoh në sy,
dhimbjet më zgjohen nga gjumi,
nuk dehem dot pa ty,
atje tej, te bari, te lumi.

Sot në ç'dreq shtegu më dolën,
nga sytë e ty të fikët më ra.
Kur u zgjova, sytë e tu më folën:
Shpirti yt, nevojë për dhimbje ka!

LUTJA IME

Të lutem shumë,
shëmtohu pak!

Pak, fare pak.

... Se ma mbushe shpirtin plot plagë.

LUTJA JONË

Eh Zot, Zot!
Nuk t'i reshtëm kurrë lutjet.

E ç'fituam?

Vuajtjet, vuajtjet...

PËR TY

Kujdes
kur të ngjitesh maleve të mia.

Janë plot gropa dhimbjesh.

Nëse rrugës të zë uria,
ngopu me legjenda ikjesh.

RIKTHIM

Siç ka ndodhur përherë,
do të ndodhë.

...një përqafim i lehtë
dhe "të dua" nëpër buzë

Një ikje e shpejtë,
dhe një rikthim në muzg.

SËRISH PËR TY

Kur të jesh në udhëkryq,
e s'di nga të shkosh,
merr rrugën e përgjakur.

Aty do më takosh.

LEJE PËR TË VDEKUR

Miqtë e mi,
më jepni leje të vdes?

E di,
ju dhimbsem...

Por duhet të iki, miq.

Vdekja po më pret.

Në shtrat,
lakuriq.

PO, JAM UNË

Hapet birra,
derdhet dhe derdhet.

Shkumë. Shkumë. Shkumë!

Në dëgjofshi se dikush u mbyt
në gotë rakie.

Jam unë.

STINËT E MIA

Brenda pranverës,
harrohem unë.

Brenda vjeshtës, ti.

Vera
Dimri
çmenden mes nesh.

Unë e ti,
stinë ndërrojmë shpesh.

MAGJI

Ti je kaq e bukur,
sa unë
do vdisja tri herë.

Një herë për ty,
për vete,
pastaj për ne të dy.

PRITJE

Të prisja të bëheshe nuse...

Lotët të qenë pellguar
në cep të një buze.

Unë, i hutuar
mu duk se jam në ëndërr.

...ti prisje të bëhesha dhëndër.

STATUJAT

E kam të vështirë
t'u besoj njerëzve
këto kohë.

Më mirë
u besoj statujave që njoh.

ZË VARRI

Kërr-kush
nuk shkroi për mua.

Sa isha gjallë
as unë.

Adresën tuaj
tashmë nuk ua dua.

E imja s'ju hyn më në punë.

NESËR VDESIM

Nesër vdesim!

Kujdes!
Mbani rregull.

Nuk duhet të vononi.
Lamtumira duhet e ftohtë.

Po jua them që sot:
Nesër vdesim!

Mbahuni të fortë!

EPITAFET

Mësoji epitafet e varreve të mia,
mëso kur për ty
më lindi dashuria.


Kur më lindën lavditë
gëzimet
trishtimet
marrëzitë.

Mësoji të gjitha.
Pastaj,
eja në parajsën time.

Do kesh mësuar të ecësh
të ëndërrosh.
Për mua si të vdesësh.

E të dish si të më kërkosh,
Dreq!

Nesër, mos më thuaj:
Ke qenë mësues i keq.



Biznesmenit të suksesshëm

Ky njeri i punës,
Që njeh veç sukses,
Çdo gjë Musa Riçku,
E ka arrit me djersë.

Në supermaketet,
Tiranë, Peshkopi,
Me stafin e tij,
Mjaft mirë ka shërby.

Është i papërtushëm,
Edhe shumë human,
Njerëzve në nevojë,
U ka qëndru pranë.

Shumë aktivitete,
Ka sponsorizu.
Është i kudondodhur,
Din veç me punu.

Ka fitu respektin,
Me Hasijen bashkë,
Njerëzit që punojnë,
Populli i ka dashtë.

Për k'të biznesmen,
Kudo që të shkosh,
Vetëm fjalë të mira,
Për të do dëgjosh.

Shuip Elezi



Rruga e Arbërit nr. 200

recense

Rrëth vëllimin poetik “S’më pyesin vitet”,
Poezi, botimet ADA, Tiranë 2023

Basir Bushkashi, poet i aromave të shpirtit

Nga **MEVLUD BUCI**

Basir Bushkashi është një poet liriko-filozofik në dritën e shpirtit njerëzor, ku çmon njeriun, virtytet me nota prekëse dhe qëndis një verb komunikues. Vargjet e tij janë të frymëzuara, me detaje që reflektojnë një këndvështrim human, duke qëmtuar nga jeta, çaste, zbulime, meditime, kujtesë e mall. Ai është poeti që do dhe entuziazmohet nga bukuria e jetës dhe në shpirtin e njeriut gjen blerim e mirësi. Mesazhet e realitetit i përcjell me ide të hapura e të nënkuptuara ku asesi nuk përjashtohet thellësia e tyre evokuese, të cilat e bëjnë lexuesin të meditojë gjatë, të shohë në to përvojat e tij, të bukurën dhe madhështinë e jetës kur ajo jetohet me kuptim. Kështu, nuk vjen rastësisht përkushtimi i tij për figura të shquara, por edhe për njerëz të zakonshëm, për shokë e miq, për të njohur e të panjohur, që zënë vend në këtë poezi lirike-refleksive.

Në librin e tij të fundit “S’më pyesin vitet”, botim i shtëpisë botuese ADA, autori i është përmbajtur idesë se vitet bëjnë punën e tyre, por poeti sikur don t’i ndalojë ato të mos shkojnë deri te plakja dhe ia arrin kësaj poetiksht, duke na prezantuar një libër me frymë rinore. Poeti është në kërkim të gjurmëve më të bukura të viteve, ato gjurmë që u njomën me frymën e dashurisë, respektit e të mirënjohjes, që, në një pikë të caktuar të vëzhgimit kohor, kur kthen kokën pas, të bëjnë që të mos skuqesh. Poeti kërkon nga jeta maksimumin, ndërsa shprehet: *Dhe kur do të iki / Përgjithmonë, / S’më pyesin, / s’ma thonë.*

Vështrimi i jetës, kohës, kombit, mirësitë, jepen aq natyrshën në poezitë (të sugjeruar veçmas për t’u rilexuar): *Ftesë e një vendlindasi, Po sikur?, A Z Çajupi, tungjatjeta!, Bukuria, Përgjithkund ca zogj, Krejt i vetmuar, Dritëro Agolli, Dhimbje, Kur u largova, Fluturim, Libri i burrërisë, Pse kaq mjegullim? etj.*

Si poet i Mallunxës së Matit, i lidhur fort me trevën e vet, me punën si mësues dhe me ndjesi të shumta të takimeve me njerëz, ai nuk harron të shpërfaqë çaste, të përthekojë motive, të veçanësojë vlera e tipare të këtyre njerëzve në udhën e bukur të artit, si për të përcjellë idenë se arti i takon njeriut dhe zbulohet përmes botës së tij.


Poeti e traskripton dhe e transfiguron peizazhin në ndjenja, mendime e konkludime origjinale: *Këndojnë plot zogj / në harenë e vet /sa harbohet pylli / po mbi të gjithë / drithërohet bilbili.*

Ajo që duhet spikatur te ky poet është trokitja emocionuese e vargut, ngrohtësia, që përbën pikën më të fortë të origjinalitetit të tij të spikatur. Vizioni njerëzor i shpirtlirisë, i veshur me një vel të hollë romantik, është një veçori që haset rrallë te poetët që turren pas metaforave të vështira, pas kalambureve të figurës dhe trandeshencës së ftohtë e atmosferave mjegulluese, por kur i largohesh kësaj tip-poezie, asgjë nuk të mbreson.

Lirizmi i Bushkashit është i dallueshëm dhe vetëm i tij, që të kujton një poet i cili shkruan për atë që njeh, që ndien dhe që e transmeton me vetvetishmëri si burimet e kristalta malore; është një lirizëm në substancë jo i kërkuar, i buruar, me gjelbërimin e një shpirti që përçon mirësi.

Më mirë se në poezinë “Një bli” kjo nuk mund të shprehet kur poeti ngre kumtin: *Një bli harliset / mbi të tjerë / më madhështor / më mbretëror / Dhe e dini pse / ju miqtë e mi, / se rrënjët i ka / në thellësi.*

Poeti e zgjedh figurën e blirit, po herë edhe të të lisit, të bredhit, panjës a të ndonjë druri tjetër, se poezinë e do të gjelbëruar si drurët, si vetë natyra, ndaj vargjet e tij vijnë natyrshëm



me kërkime të sinqerta e zbulime lirike, pse jo edhe dramatike, që përcjellin e gulfojnë rrjedha malli mbi jetën, të bukurën , shpirtin, arratinë e kujtesës duke u ndalur në ato çaste me një bukuri të pashlyer.

Stinët zënë vend herë- herë jo thjesht si përmendje, por të përmendura përmes vetëndjerjes së tyre në një kalendar poetik ditësh; te femra, bukuria e saj, dashuria si shpërblim i fizikut dhe karakterit, poezia e Basirit gjen prehjen e saj, e prej kësaj prehje arrin të shkëputet dhe të përndizet. *Një vajzë e bukur / një police / shenja policie / mban përmbi gji”*

Intesiteti i ndjenjës që gjendet këtu nuk e shteron hovin e tij ndërsa përcillet përmes vargjeve: *honeve të shpirtit / kërleshen erërat / kërleshen aq egër/ sa gjoksi më dhemb; dhe: siç e vëmë re, këto fjalë dallohen për minimumin e vargjeve dhe maksimumin e ideve.*

Basiri është poet i konstatimeve të holla, që shprehen në kursim fjalësh e flasin e nënkuptojnë mjaft ide, alternojnë situata të bukura me njëra-tjetrën.

Bushkashi është një konstruktor i vargut. Poezitë e tij nuk janë shumë të rrjedhshme. Fillojnë e mbarojnë si një çast mahnitje. Mobilizojnë estetikisht dhe të këndellin prej joshjes që sjell ëmbëlsia e fjalës. Ky lloj ndërtimi e sjell poezinë e tij në një nivel të mirë realizimi duke fryrë si një fllad i ëmbël bjeshkor, si një nimfë liqenore e Ulzës dhe e kodrave magjike përreth saj.

Edhe kur Basiri rrok tema sociale e përdor satirën, heshtat goditëse të saj me një parfumim lirik, sepse ai është poet i butë, më tepër shpreh keqardhje dhe kërkon sa më shpejt ndreqjen e ca veseve që duhet të kuptohen e të mos përsëriten përmes vetëkorrigjimit.

Poezia e tij është e pastër si kristali, jo kristal i ftohtë, e kthjellët si një qiell mbi kreshtat e maleve, e shtrirë, si kodrat e valëzuara të Burrelit plot lule dhe hijeshi, është një poezi që nuk ka qëllim mbylljen dhe tjetërsimin absurd, poezi e konkretësisë, por edhe e përgjithësimit dhe e reflektimit. Ajo nuk zhytet në brenga lënduese e në qarje të një ligështuesi pesimit, përkundrazi të afron optimizëm dhe gëzim, edhe pse koha ikën, thinjat zbardhen edhe më, vitet mprehin presën, por poeti nxiton ta mbushë vargun me aroma të bukura të dashurisë njerëzore si lirik i heshtur, pa bujë, por që tërheq vëmendjen e një rrethi të madhe lexuesish dhe mban respektin si poet me zë dhe dashamirës, larg çdo hipokrizie, e për nga lirizmi ta kujton Seremben tonë të madh, por edhe bardët popullorë e lirikën agolliane, natyrisht duke qenë vetvetja.

Koncentrimi i mendimit jepet përmes një lakonizmi për t’u pasur zili, ngrehina e vjershës vjen përmes zhvillimit të një mendimi me peshë, që ka një bërthamë rrezatuese, kjo ngrehinë është e hijshme dhe komode, e ngrohtë si një vatër e thjeshtë ku duhet të trokasësh lehtë, pa bujë, sepse e di që aty gjen vetëm dashuri.

Në përfundim, mund të themi se Basir Bushkashi me librin e tij me poezi “S’më pyesin vitet”, realizon një ligjërim poetik në hulli të ligjërimit të tij të më parshëm, por ajo që sjell të re është se ai edhe pse tashmë vitet i ka më të shtuara mbi supet e tij, freskinë, energjinë e vargut e shpërfaq në mënyrë të tillë sikur i ka prapësuar disa vite dhe gjendet në një moshë më të re. Kjo, se sa ç’jeton kohën reale, aq jeton kohën e vet poetike të artistit të frymëzuar e të sinqertë. Poeti matjan Bajram Canameti, ka të drejtë kur e përkufizon portretin e Basirit me vargjet: *Te fjala jote, poet fisnik / mbruhen udhët malore / si një diamant shndrit / agimeve mëngjesore”.*

Në kërkim të fatit

(MARRË NGA KANUNI I DIBRËS, XHAFER MARTINI, BOTIMET M&B, 2016.

Nga **XHAFER MARTINI**

Dy vëllezër jetonin bashkë. I vogli punonte shumë, kurse i madhi jetonte “ku rafsha mos u vrafsha”, dhe nuk prekte punë me dorë. Ditën rrinte nën hije të arrës ose humbiste në ndonjë lojë me shokë si vetja. Në shtëpi kthehej vetëm për të ngrënë dhe për të fjetur. Kishte fëmijë e grua, por ato, i mbante vëllai i vogël. Ky ishte punëtor i madh. Ishte i ndershëm dhe nuk dinte të bënte hile. Vëllai i madh e quante budalla. Këtë e tregonte edhe me veprime, por e thoshte edhe me fjalë. Por vëllai i vogël nuk ishte budalla, si kujtonte tjetri, e duronte të madhin, se e kishte vëlla.

Ajo që e çuditi vëllain e vogël, ishte kërkesa e të madhit për t’u ndarë e për të jetuar secili me vete. I vogli, me atë dashurinë e sinqertë dhe të papërlyer të vëllait për vëllain, i tha:

– Deri më sot gruan tënde, ty e fëmijët, u kam mbajtur unë. Fëmijëve e gruas hallall u qoftë, por ti je barra më e rëndë, se jo vetëm nuk fiton asgjë, por edhe prish. Si do ndahesh ti kur je kështu si thashë?

– Kjo nuk është puna jote. Unë dua të ndahem.

– Mirë, si të duash, por do të pendohesh.

Vëllai i madh u nda duke zgjedhur çfarë i pëlqente në pasurinë shtëpiake. Edhe tokat që mori, qenë me prodhuese. Por e bëri pasurinë për një kohë të shkurtër rrush e kumbulla. Tokën e la djerrë, nuk e mbolli fare. Mori gruan dhe fëmijët, ia çoi në derë vëllait të vogël.

– Amanet gruan dhe fëmijët deri sa të kthehem, – i tha.

– Po ku do të shkosh?

– Do të kërkoj fatin.

– Ç’fat, more!Fatin e ke tek puna, por ti nuk punon.

– Unë jam njeri pa fat dhe, sado të punoj, nuk bëj hair. Pa fat kot mundohet njeriu.

– Rri e verju punës se nuk t’i mbaj më gruan e fëmijët, vetë deshe të ndahesh. Po të kesh ndonjë hall të madh, hadje de, por ti të dalësh me gjezdis dynjanë dhe unë të të mbaj familjen, kjo nuk bëhet.

– Në daç mbaji, në daç hidhi në përrua, – tha vëllai i madh dhe iku.

Kaloi krahinë me krahinë duke kërkuar fatin, por kërkund nuk e gjeti. Një ditë, ndërsa kishte marrë kotsëkoti një udhë malore, takoi një plak shumë të vjetër, të cilin e pyeti:

– Or plak, mos di ku është fati im. Jam njeri pa fat dhe kam dalë ta kërkoj.

– Mos iu ndaj kësaj udhe që të çon në Pyll të Zi. Aty ndodhet Fatthënësi dhe ti do t’i thërrasësh tri herë e do ta pyesësh për fatin. Ai me siguri do të përgjigjet.

Burri falenderoi plakun dhe mori udhën për në Pyllin e Zi. Nuk kaloi shumë kohë dhe në udhë takoi një ujk. Ky ishte kockë e lëkurë.

– Ku po shkon? e pyeti ujku njeriun.

– Në Pyllin e Zi të takoj Fatthënësin të më tregojë ku e kam fatin, se jam njeri pa fat…

– Pyet edhe për fatin tim, – i tha ujku, – se edhe unë pa fat jam. Shiko si jam bërë kockë e lëkurë. Ha sa të dua, por nuk shëndoshem…

– Do të pyes, – premtoi burri dhe u nis për rrugë.

Si kapërceu një të përpjetë të vështirë, i doli para syve një pamje mahnitëse: një lëndinë e rrafshtë, mbuluar me bar jeshil një pëllëmbë, me një ujë të kristalt që i shkonte përmes, plot me hije nga rrapat e mëdhenj që ishin radhitur si nga dora e njeriut në të dyja anët e rrjedhës së ujit. Njëri prej atyre rrapave, më i madhi, kishte filluar të thahej nga trungu deri në majë. Rrapi, sa e pa njeriun, e pyeti tërë shpresë:

– Për ku je nisur, o njeri?

– Do të shkoj në Pyll të Zi të pyes për fatin tim, se jam njeri pa fat. Kam punuar shumë, por bereqeti nuk më jepet, bagëtia nuk shtohet, shkurt jam lodhur kot…

– Të keqe të madhe paske, o njeri, por edhe unë, si e shikon, jam duke u tharë, megjithëse ndodhem në tokë të mirë dhe rrjedhën e ujit e kam tek rrënjët. Pyet edhe për fatin tim, të lutem…

– Do të pyes, do të pyes, – tha njeriu dhe mori udhën për në Pyll të Zi.

Mbas disa orësh mbërriti aty. Pylli i Zi ishte një mrekulli e natyrës. Kishte plot kafshë të egra të të gjitha llojeve, kishte zogj, përrenj me ujëra të kulluar, liqene malorë, rrethuar nga pisha të blerta dhe të gjata, kroje dhe burime. Nga ai vend nuk kishe qejf të largoheshe. Por ai kishte shkuar për të kërkuar fatin dhe thirri:

– O Fatthënës!O Fatthënës!

– Çfarë kërkon nga unë? – u dëgjua një zë i fortë.

– Jam njeri pa fat, kërkoj të di për fatin tim.

– Fatin e ke asaj rruge të cilën more për të ardhur këtu.

Burri e pyeti edhe për fatin e ujkut dhe të rrapit. Fatthënësi ia tregoi. Njeriu mori udhën e kthimit dhe ja ku shkoi tek rrapi. Ky e pyeti:

– Ç’të tha Fatthënësi për mua?

– Ti ke tek rrënjët një kazan të madh me flori. Kush e nxjerr kazanin, të shpëton, ndryshe do të thahesh fare…

– Po ç’prêt!? Nxire!Ti bëhesh i pasur, ndërsa unë gjelbëroj si më parë. Një udhë e dy punë, i thonë kësaj. Nuk ka ku vete më mirë.

– Jo, jo. Unë kërkoj fatin tim.

– Po ku ka fat më të madh se sa të marrësh një kazan me flori?

Po kujt t’i thoshte! Njeriu ishte i vendosur në të vetën. Ujku ishte kaq shumë i interesuar për të mësuar për fatin e vetë sa, qysh kur takoi njeriun, nuk e mbante vendi. Lëvizte me shpejtësi poshtë e përpjetë asaj udhe dhe minuti i dukej orë deri sa të vinte njeriu. Kur burri po bisedonte me lisin, ujku ishte fshehur tek një gëmushë aty afër. Ishte kurioz i madh, por, kur dëgjoi tërë biseden, kur mori vesh se njeriu kërkonte një fat më të madh se një kazan me flori, u çudit. Iku teposhtë, pa e parë burri, se donte të takohej me të në vendin e caktuar e të mësonte për fatin e vetë.

– Mësove gjë për fatin tim? – e pyeti sapo e pa.

– Mësova shumë.

– Po hë, ç’mësove?

– Ti nuk ke ngrënë një njeri budalla. Sado të hash kafshë të egra si sorkadhe e të tjera, nuk do të shërohesh. Duhet të gjejsh një njeri budalla dhe ta hash për t’u shëruar.

– Më budalla se ti nuk kam kë gjejë, – tha ujku dhe iu hodh në grykë e ia shqeu gurmazin.

kujtesë

Në kujtim të inxhinierit të talentuar dibrano – shkodran, Kujtim Domnori



Kujtim Domnori lindi në fshatin Allejbegi të rrethit të Dibrës më 17. 05. 1947. Babai i tij Jahja Domnori, në vitin 1946 u emërua krye-mësues në shkollën e fshatit Alejbegi. Në dhjetot të këtij viti ai solli në fshat bashkëshorten e tij shtatzëne, Naxhijen dhe vajzën 5 vjecare Pertefen.

Dimri i atij viti qe shumë i egër dhe gjithë Dibra ishte e mbuluar nga dëbora. Naxhijes me të arritur në shtëpinë e Kadri Demirit (Osmanit) iu krijua një mjedis i ngrohtë familjar. Ajo ishte nje vajzë qytetare shkodrane e cila në fshatin tonë në Dibëer kërkonte rrugë të asfaltura dhe me trotuare. Po po, i thanë gratë e fshatit që e vizitononin cdo ditë bashkëshorten e mësuesit, që u zhvillonte kurset kundër analfabetizmit i shoqi, mësues Jahja, sapo te shkrihet bora do të dalin trotuaret dhe pllakat e bulevardit.

Erdhi pranvera, bora shkriu, dolën baltrat e mëdha të Allejbegisë, i gjithë mjedisi filloi të gjelbërohet, puna e fshatarëve e rriti intensitetin, por edhe Xhijes stina e pranëverës i solli ëmbël ardhjen në jetë të një fëmije të shëndetshëm, të bukur, që u prit nga mjeku gjinekolog dhe mamia të ardhur nga qyteti i Dibrës së Madhe, djalin e quajtën me emrin e bukut Kujtim. Lindja e tij ishte kujtimi më i bukur i ciftit Domnori në Dibër. Atë ditë gjithë fshati gëzoi. Pothuajse të gjitha gratë e fshatit e vizituan dhe uruan Xhijen për lindjen e djalit, që më pas do ta lidhte përgjithmonë me ato bashkëfshatarë që e donin dhe respektonin mësuesin e tyre pa masë. Nënë Rrushja, e ema e Kadriut, që kish rritur shumë fëmijë e nipër e mbesa, u kujdes në mënyrë të vecantë për Xhijen e re dhe Kujtimin e vogël. Kurse Nazmija, bashkëshortja e tij, i conte në dhomë cdo ditë bukën e ngrohtë dhe gatuente për të ushqime të shëndetshme që nuses të mësuesit të mos i mungonte agjë. Motra 5 vjecare e Kujtimit Pertefi, sëbashku Fatmirën moshatare, vajzën e Kadri Demirit, shkonin herë pas here dhe e përkundnin djalin e vogël në djepin që përdornin familjet dibrane për fëmijtë deri në moshën 2 vjecare.

Pas dy vitesh mësues Jahja Domnori u transferua në Shkodër, duke shërbyer për zhvillimin dhe përhapjen e arsimit në të gjithë fshatrat përrreth qytetit të Shkodrës. Atë ditë kishte dalë i gjithë fshati për të përcjellur mësuesin e dashur, që u mësoi fëmijëve të tyre jo vetëm shkrim e këndim, por edhe shkencën e punimit të tokës, të rritjes së bimve e frutave, mënyren e jetesës, kulturën e sjelljes etj, duke ndërtuar pranë shkollës një parcelë eksperimenntale dhe krijuar një bahce ku nxënësit mësonin kulturat bujqësore. Kjo bahce u bë model për të krijuar në këtë fshat shumë bahce të tjera. Së bashku me prindërit u largua edhe Kujtimi i vogël, por vetëm fizikisht, pasi ai u rrit me ndjenjën e krenarisë se kishte lindur në Dibër, në një familje me shumë trandita dhe në një fshat që është vëndbanim që nga koha e Neolitit të mesëm, me shumë tradita atëdhetare e kulturore dhe që ai e quante me krenari origjina e tij e dytë.

Kujtimi u rrit me një ndenjë të vazhdueshme dashurie për Dibrën, për fshatin Allejbegi, dhe fëmijët e familjes së Kadri Demirit ku lindi, i quajti dhe i trajtoi gjithmonë si vëllëzrit me motrat e tij. Ata i lidhi një miqësi e ngushtë të cilën e kanë ruajtur dhe e trashëgojnë edhe brezat më të rinj.

Pasi mbaroj me rezultata të shkëlqyera Universitetin e Tiranës dhe u titullua inxhinier ndertimi, Kujtimi filloi punë si Drejtori i parë i Kantierit të Ndërtimit të Hidrocentralit të Fierzës. Brënda një kohe të shkurtër, kantieri i ndërtimit të këtijë hidrocentrali u mbush me dibranë. Ishte koha kur shumë djem të ri kërkonin të largoheshin nga koperativa bujqësore dhe të punonin në ndërmarje shtetërore, sidomos në vepra të mëdha, pasi paga ishte shumë më e mirë e mund t'ju vinin në ndihmë famijeve të tyre me të ardhura të pakta. Djemtë e rinj dibranë gjetën një strehe të sigurtë tek Drejtori i Kantjerit të Ndërtimit të Hidricentralit të Fierzës, e më pas edhe të Komanit ku edhe u specializuan në profesione të ndryshme. Kadri Demiri, kryefamiljari i shtëpisë ku lindi Kujtimi u bë si "zyrë pune", duke u dhënë letra rekomandimi qindra dibranëve për Kujtimin, që t'i punësonte në kantjerin e tij. Drejtor Kujtimi me cilësitë e larta morale edukuar nga familja e tij dhe dashurinë e madhe për Dibrën, vëndlindjen e tij, i sistemoi të gjithë nëpër kantieret e ndërtimi të kësaj vepre të madhe të dritës. Kjo bëri që respekti e mirënjohja e dibranëve për inxhinier Kujtimin të ishte e madhe. Ai e vizitonte shpeshë herë Dibrën, fshatin dhe shtëpinë ku lindi, ndante me bashkëfshatarët gëzimet dhe hidhërimet, i ndihmonte me të gjitha mundësit që i lejonte regjimi i kohës për t'i shkolluar e punësuar fëmijtë e tyre.

"Kur Kujtimi vinte në fshatin tonë, ne, ato ditë bënim festë, pasi ai na sillte me gjithë qenjen e tij, dashurinë e fisnikrinë e mësues Jahjas, ciltërsinë e bukurinë e nënë Xhijes, elegancën e motër Përtefit dhe humorin e kulturën e pasur të shkodranit" - më thoshte një ditë Basri Hakorja, mesues nga fshati Brezhdan i Dibrës. Dhe më pas ai vazhdon: "Për sa kohë isha student në Institutin e Shkodrës, Kujtimi vinte cdo fundjavë dhe më merrte në shtëpine e tij në Shkodër, ku gjeja një mikëpritje të shkëlqyer nga prindërit, vëllai Irfani dhe motrat e tij Përtefi dhe Eseni.

Pas ndertimit të Hidrocentralit të Fierzës, ai punoj për ndërtimin e një vepre tjetër të Dritës, Hidrocentralin e Komanit, ku e celnikosi edhe më tej miqësinë e bashkëpunimin me dibranët si ndërtues të zotët e njerëz të sakrificave, për të cilët gjithmonë ishte krenar. Në prag të ndryshimeve demokratike Kujtimi u kthye në qytetin e Shkodrës si inxhinier në Ndërmarjen e Ndërtim Banesave dhe më pas në Bashkinë e Qytetit, që e deshi dhe respektoi aq shumë. Si inxhinier i talentuar ai u përpoq për të rindërtuar shumë godina e lagje karakteristike të qytetetit, por jo gjithëmonë gjeti mbështetjen e përkrahjen e drejtuesve të rinj.

Janë të shumta godinat dhe lagjet e kryqëndrës të veriut të shqipërisë, Shkodrës, që kanë vulën e inxhinietit të talentuar Kujtim Domnori.

I indinjuar që komunizmi i prishi shtëpinë e vjetër dhe të bukur të Domnorëve në lagjen Perash, për të ndërtuar disa palate banimi 6 katëshe, ai përsëri në ish bacen e tij ndërtoj një godinë të re, vetëm për të mos u larguar nga trojet e të parëve nga qyteti i Shkodrës.

Kujtimi e lidhi jetën me mjeken e re, stomatologen e talenduar Bella, që ashtu sic ka emrin, kish sjelljen e nurin e shkodranes bujare, e qeshur dhe gjithë mirësi. Ato lindën e rriten dy djem të mrekullueshëm, Valdrinin dhe Eltonin, i cili eshtë profesori i talentuar i eleketronikës dhe informatikës dhe pedagog mësimdhënës, ashtu si edhe gjyshi i tij, në disa Unbiversitet të Tiranës dhe Elbasanit.

Kujtimi vitet e fundit jetoi midis Tiranës dhe Shkodrës, në dy qytetet ku u rrit dhe edukua si inxhinier pasi rrethohej gjithmonë nga intelektualë të fushës së ndëretimit, me të cilët diskutonte e projektonte me shumë passion për ti zhvilluar këto qytete, pa prishur trashëgimië e madhe kulturore që trashëgonin. Ai u bë gjysh i lumtur me nipër e mbesa të cilët e donin aq shmë për ëmbëlsinë e vecantë që transmetonte me gjithë qënjen e tij.

DEMIR OSMANI

KËRKOHETGAZETAR/E

Kërkohen një gazetar/e me kohë të pjesshme. Detyra kryesore është të shkruajë dhe raportojë për ngjarje që ndodhin në qarkun e Dibrës. Të interesuarit duhet të kenë pasion gazetarinë. Përbën avantazh përvoja në shtypin e shkruar ose në qoftë se kanë mbaruar studimet për gazetari dhe letërsi. Të jenë të angazhuar për punën në grup dhe të jenë të pavarur politikisht gjatë kohës që bashkëpunojnë me gazetën.

Të interesuarit të komunikojnë me redaksinë.

Tel. **069 20 68 603.** E-mail. **rrugaearberit@gmail.com**

NEKROLOGJI

Xhetan Strazimiri, mësuesi dhe intelektuali i përkushtuar për dijen dhe për Dibrën



Profesori Xhetan Strazimiri u nda nga jeta më 28 qershor 2023. Ai u lind më 1939 në fshatin Pocest të Maqellarës në një familje me tradita të larta patriotike. Xhetan Strazimiri është pinjoll i familjes së të madhit Ismail Strazimiri, një veprimtar i shquar dibran që bëri emër në kohën e Pavarësisë dhe që është partizani më i vjetër i Dibrës dhe dëshmor i Luftës Nacionalçlirimtare. Dhe Xhetan Strazimiri me kushërinjtë e tij Shaban Strazimiri, Baudin Strazimiri, Drita Strazimiri (Xholi) dhe tri motrat Strazimiri, Setkie, Ulvie, Hike kanë lënë gjurmë të veçanta në arsimin e Maqellarës si dhe dhjetra kuadro të tjerë nga Pocesti.

Mësuesi Xhetan Strazimiri ka mbetur në kujtesën e qindra nxënësve të tij në zonën e Dibrës dhe të Tiranës për 43 vjet me radhë duke mbetur një intelektual i shquar dhe studiues i talentuar. Pasi mbaroi shkollën pedagogjike në Peshkopi, profesori dha mësim në shkollën 7-vjeçare Maqellarë në shkollën "Demir Gashi" dhe pas mbarimit të universitetit më 1993 u bë profesor i gjeografisë në shkollën pedagogjike Peshkopi, prandaj ka mbetur në memorien e mësuesve që u shkolluan aty si një mësimdhënës i palodhur dhe shumë i dashur për të gjithë pedagogjikasit.

Më pas profesor Xhetani punoi për vite të tëra pa u lodhur në Tiranë duke mbetur një mësues e drejtues i dashur dhe shumë i talentuar për breza të tërë që e kujtojnë me veneracion dhe sot e kësaj dite. Gjatë punës së tij si mësues është dalluar për metodat e mësimdhënies dhe si njeri i afërt me nxënësit dhe prindërit e tyre. Ka bërë një punë të palodhur dhe me vlera në Arkivin e Shtetit për më shumë se 10 vite. Një punë mbresëlënëse ka lënë Xhetan Strazimiri me studimet e tij të shquara në rrafshin e krijimtarisë materiale e filozofike të popullit tonë me librat e tij me dy vëllimet e botuara "Filozofia e jetës" dhe një në dorëshkrim.

Edhe pas daljes në pension z. Xhetan Strazimiri vijoi të jepte kontribut të shquar si pjesë e elitës së intelektualëve dibranë në Tiranë ku shquhej për mendimet dhe idetë e tij të veçanta.

Me ndarjen nga jeta të tij familja, bashkëshortja Meliha dhe dy gocat, humbi njeriun e tij të dashur dhe kolegët dhe ish-nxënësit e tij një burrë me vlera të shumta që do të mbetet një shembull i shquar përjetë. U prehsh në paqe, o njeriu ynë i mirë dhe i dashur!

Nga: Adem Ymeraj, Osman Turja, Ismail Erebara, Qamil Hamzaj, Shahin Lazri, Bajram Xhafa, Neki Osmani, Baudin Strazimiri, Ramadan Ajazi, Pjetër Tarazhi, Ruzhdi Mata, Lavdrim Shehu, Ramazan S. Ilnica, Baftjar Gazidede, Ulvie Gazidede (Strazimiri), Adem Bunguri, Hilmi Cani, Rustem Strazimiri

Tiranë, më 3.7.2023



Folklori dibran u paraqit në Festivalin e Gjirokastrës nga tre grupe folklorike

Ansambli folklorik i Dibrës, "Përparim Tomçini"; Ansambli Shtetëror i Këngëve dhe Valleve Popullore Shqiptare në Maqedoninë e Veriut dhe Ansambli Artistik "Lura" nga Londra paraqiten këngën dhe vallen folklorike të Dibrës në Festivalin Folklorik të Gjirokastrës, rikthyer pas 8 vitesh ndërprerje. Grupi i Bulqizës mungoi në Gjirokastër

Dibra e nisi festivalin me ritin e jetës baritore të zonës së Kalasë së Dodës. Më pas, një valle dyshe burrash nën interpretimin e valltarëve Rakip Pashnjari dhe Gjuran Ilnica.

Mifterim Kupa dhe Fatmir Daku sollën një interpretim të këngës "Hajde moj Laznore".

Kënga e Suf Murrës, nën interpretimin e Mifterim Kupës dhe Edmond Përnezhës e shoqëruar nga grupi, solli elementë polifonikë të zonës së veriut, pak të njohura për publikun, por që në kalanë e Argjirosë mori duartrokitje të ngrohta.

Me duartrokitje u prit edhe kënga tjetër, Atje n'at zabel, kënduar nga Eda Uka dhe Etmond Përnezha.

"Ti Moj Dibra e Kastriotit,/Brez pas brezi e mot pas moti,/ Luft' o me krajla e luft' o me mbretër,/

Dibër ishe, Dibër mbete!". Këto janë disa nga vargjet e këngës "Dibër ishe, Dibër mbete" kënduar nga Eduart Hoxha dhe shoqëruar grupi i burrave.

Këtë vit paraqitja në festivalin e Gjirokastrës ka disa veçanti.

"Për herë të parë Ansambli i Dibres u prezantua duke mbajtur mbi supe emrin e kompozitorit dibran Përparim Tomçini, ku pjesa më e madhe e programit e prezantuar në festival mban autorësinë e kompozimeve të tij", tha për gazetën "Rruga e Arbërit" udhëheqësi artistik i Ansamblit, Igli Tomçini.

Tomçini tha se "një e veçantë tjetër është kënga e Suf Murrës, e sjellë me elemente polifonike të zonës së veriut, gjë e cila është e rrallë për këngët e zonës sonë".

Për herë të parë këtë vit dy Dibrat e kanë zhdukur kufirin, duke bashkuar për tu përfaqësuar në këtë festival, Dibra e Madhe dhe Peshkopia.

Motive folklorike nga Dibra paraqiti natën e parë të hapjes së festivalit edhe Ansambli Shtetëror i Këngëve dhe Valleve Popullore Shqiptare në Maqedoninë e Veriut. Në repertorin e këtij Ansambli ishin këngë "Fusha e Korabit", "Këngë për Suf Xhelilin", "Na këndojnë pushkët nëpër kulla" si dhe "Vallja e Dibrës".

Festivali Folklorik Kombëtar 2023 nisi me 24 qershor në kalanë e qytetit të Gjirokastrës në një skenë të hapur për të gjithë dhe u mbylle me 1 korrik 2023.

Në këtë festival u ngjiten në skenë mbi 1200 artistë nga të gjitha trevat shqiptare dhe diaspora.

Në këtë festival, më datë 29 qershor 2023, u paraqitet me një repertor edhe Ansambli "Lura" nga Londra.

U ndje mungesa e grupit folklorik të Bulqizës në këtë festival. Një burim pranë grupit organizator tha për gazetën "Rruga e Arbërit" se "Bulqiza nuk paraqiti material për këtë festival, ndaj nuk është përzgjedhur për të marrë pjesë".

Të gjitha grupet pjesëmarrëse në Festival, kishin dhënë më parë një shfaqje përpara një jurie të ngritur posaçërisht për festivalin, të cilët në disa raste kanë rekomanduar heqjen e ndonjë materiali për paraqitje në Festivalin e Gjirokastrës.

Ministrja e Kulturës, Elva Margariti, tha në hapje të festivalit, se synohet që Festivali Folklorik i Gjirokastrës të regjistrohet në UNESCO.

"Unë i jam falenderuese çdokujt që na bashkua në këtë rrugëtim, por në veçanti artistëve, jo vetëm atyre 1200 që do të hipin në skenën e kalasë, por të gjithë atyre që përcjellim të bukurën shqiptare jo vetëm në Shqipëri, por në të gjithë botën. Dhe jam e bindur se Festivali i Gjirokastrës është kthyer në një kartolinë të bukur të Shqipërisë në botë", tha ajo në çelje të festivalit.

"Besoj se ne jemi një brez me fat që jetojmë në kohëra kur vazhdojmë të dëgjojmë ninullat e nënave në djep, gra nga Malësia si ato të kësaj mbrëmjeje, por edhe ato gra që vazhdojnë të qëndisin në ar, që endin xhubleta, që kemi ata pasardhës Rilindasish, të cilët na përçojnë brez as brezi këngët dhe traditat, por mbi të gjitha kur shohim se si ndizet festa kur luhen tingujt e muzikës sonë popullore", theksoi Ministrja e Kulturës. "Kjo lidhje kaq natyrore dukej sikur do të cenohej nga zhvillimi i teknologjisë, por teknologjia na ka ndihmuar të ecim përpara. Tabanin e kemi të fortë, kemi rrënjë të thella, jemi një komb që gjithmonë ka frymuar Europë!"

B.Karoshi

ANSAMBLI SHTETËROR I KËNGËVE DHE VALLEVE POPULLORE SHQIPTARE NË MAQEDONINË E VERIUT

Ansambli Shtetëror i Këngëve dhe Valleve Populllore Shqiptare në Maqedoninë e Veriut u paraqit natën e parë të Festivalit Folklorik të Gjirokastrës me një repertor të përmbledhur nga të gjitha trevat shqiptare. Surpriza e paraqitjes ishte në mbyllje, me një këngë polifonike (video më poshtë), që përcolli emocione për spektatorët në Kalanë e Gjirokastrës.

Në repertorin e këtij Ansambli kishte shumë këngë nga Dibra, mes të cilëve mund të përmendim "Fusha e Korabit", "Këngë për Suf Xhelilin", "Na këndojnë pushkët nëpër kulla" etj.

Në repertorin e valleve ra në sy edhe Vallja e Dibrës.

Ansambli Shtetëror i Këngëve dhe Valleve Populllore Shqiptare në Maqedoninë e Veriut është themeluar më 6 mars 2018 si një institucion kombëtar i kulturës shqiptare dhe ka fituar disa çmime në turnetë ndërkombëtarë si në Turqi etj. Ansambli përbëhet nga 37 artistë: 20 valltarë, 9 instrumentistë dhe 8 solistë.

Që nga 13 nëntori 2019, ansambli drejtohet nga tenori i njohur Shkodran Tolaj.

Festivali Folklorik Kombëtar 2023 nisi me 24 qershor në kalanë e qytetit të Gjirokastrës në një skenë të hapur për të gjithë u mbyll me 1 korrik 2023.

Në këtë fëstival u ngjiten në skenë mbi 1200 artistë nga të gjitha trevat shqiptare dhe diaspora.

Në këtë festival mori pjesë edhe Ansambli "Lura" nga Londra.

Qarku i Dibrës e dha shfaqjen e saj më datë 26 qershor në orën 19:00.

